



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2017 – Numri: 204

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E premte, 24 nëntor 2017**

## PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 178, datë 8.11.2017	Mbi miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror”.....	10583
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 179, datë 8.11.2017	Mbi certifikimin e shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror, Albgaz sh.a.....	10591
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 180, datë 8.11.2017	Mbi miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”.....	10640



## VENDIM

Nr. 178, datë 8.11.2017

**MBI MIRATIMIN E “METODOLOGJISË  
SË LLOGARITJES SË TARIFAVE TË  
RRJETIT TË TRANSMETIMIT DHE TË  
SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR”**

Në mbështetje të neneve 16, pika 1 dhe nenit 32, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe në zbatim të nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, për miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror”,

konstatoi se:

- Drejtoritë teknike në bashkëpunim me shoqërinë konsulente BBH kanë hartuar draftin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 142, datë 6.9.2017, vendosi për fillimin e procedurave për miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror”.

- Me shkresën nr. 648 prot., datë 4.10.2017, ERE njoftoi Albغاز sh.a., Albpetrol sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoritetin e Konkurrencës, për fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror” dhe u kërkoi të paraqesin opinionet apo komentet e tyre në lidhje me këtë metodologji.

- Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 394/1 prot., datë 12.10.2017, Albغاز sh.a., me shkresën nr. 129 prot., datë 30.10.2017 dhe ENC në korrespondencë elektronike shprehën opinionin e tyre mbi këtë metodologji. Komentet e palëve sa më sipër që nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi, janë reflektuar në “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

## VENDOSI:

1. Të miratojë “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Autoritetin e Konkurrencës, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, si dhe të gjithë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

**METODOLOGJIA  
PËR LLOGARITJEN E TARIFAVE TË  
PËRDORIMIT TË RRJETIT TË  
TRANSMETIMIT DHE TË SHPËRNDARJES  
SË GAZIT NATYROR**

**PJESA I  
TERMAT E PËRGJITHSHËM**

**1. Autoriteti**

Kjo metodologji e llogaritjes së tarifave të rrjetit të gazit është hartuar në mbështetje të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

**2. Qëllimi dhe fusha e aktivitetit**

Qëllimi i kësaj metodologjie është vendosja e rregullave për llogaritjen e tarifave të aksesit dhe të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit në Shqipëri, si dhe tarifave të shërbimeve të ofruara nga operatori i rrjetit të gazit, siç parashikohet në nenin 32, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” (tarifat e rrjetit). Tarifat e rrjetit do të vendosen nga operatori i rrjetit të gazit në përputhje me këtë metodologji. Kjo metodologji nuk trajton tarifën e aksesit dhe përdorimit të TAP-it (Trans Adriatic Pipeline).

**3. Termat e përdorur në këtë metodologji**

Termat e përgjithshëm të përdorur në këtë metodologji janë marrë nga ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”. Ata kanë kuptimet e mëposhtme:



3.1 “Periudha rregullatore e llogaritjes” do të thotë periudha e aktivitetit të operatorit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror, e cila zgjat 12 muaj dhe përkon me vitin kalendarik.

3.2 “Operator i kombinuar” konsiderohet kur e njëjta shoqëri e gazit natyror licencohet për të kryer veprimtarinë e transmetimit, shpërndarjes, operatorit të impianteve të GNL-së dhe/ose të impianteve të depozitimit, siç përcaktohet në nenin 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

3.3 “Rrjet” është një sistem i ndërlidhur tubacionesh.

3.4 “Operator i rrjetit” do të thotë operator i sistemit të transmetimit dhe/ose operator i sistemit të shpërndarjes së gazit natyror në Shqipëri.

Të gjithë termat e përdorur në këtë metodologji kanë të njëjtin kuptim me përcaktimet e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

4. Parimet bazë të vendosjes së tarifave

4.1 Përcaktimi i tarifave sipas kësaj metodologjie do të bazohet në metodën RoR. Operatorit të rrjetit do t'i lejohet të mbulojë kostot e justifikuar për rrjetin, si dhe një kthim mbi investimin.

4.2 Operatori i kombinuar do të zbatojë rregullat e kësaj metodologjie për qëllim të përcaktimit të tarifave nga ERE. ERE do të miratojë tarifën e rrjetit kur plotësohen kushtet dhe parimet e kësaj metodologjie. Tarifën e përdorimit të rrjetit të aprovuar nga ERE do të jenë të vlefshme për një periudhë ushtrimore (1-vjeçare).

4.3 Shmangia nga çdo parashikim i kësaj metodologjie do të çojë në refuzimin nga ERE të aplikimit për tarifë të operatorit.

4.4 Tarifën e rrjetit do të llogariten dhe do të miratohen nga ERE në bazë të kostove të rrjetit të cilat do të konstatohen dhe trajtohen në përputhje me nenet 7–12 të kësaj metodologjie. Kostot dhe tarifën e rrjetit do të llogariten në bazë të të dhënave të përfituara nga viti i mëparshëm i aktivitetit të operatorit të rrjetit (sipas nenit 80), por mund të merret parasysh edhe informacioni i përfutur në vitin aktual, në rast se vlerësohet i besueshëm.

Kostot e rrjetit do të llogariten si më poshtë:

$$GC_t = C_{t-2} + D_{t-2} + ROC_{t-2} - CRI_{t-2} + OCP_t$$

ku:

$GC_t$  - kostot vjetore të rrjetit për vitin në shqyrtim

$C_{t-2}$  - elementet e kostos të vitit (t-2), si përcaktohet në nenin 8

$D_{t-2}$  - amortizimi i vitit (t-2), si përcaktohet në nenin 9

$ROC_{t-2}$  - kthimi mbi kapitalin e vitit (t-2), si përcaktohet në nenin 10

$CRI_{t-2}$  - të ardhurat e zbritshme të vitit (t-2), si përcaktohet në nenin 11

$OCP_t$  - axhustimet e periudhave të ndryshme në vitin/t, si përcaktohet në nenin 12

4.5 Vendosja e tarifave të rrjetit do të bazohet në këto parime:

1. Tarifën e rrjetit do të pasqyrojnë kostot

2. Tarifën e rrjetit do të llogariten në mënyrë të tillë që, në fund të periudhës rregullatore, diferenca ndërmjet kostove reale të rrjetit (të ardhurave të realizuara) dhe atyre të lejuara nëpërmjet tarifës të jetë sa më e vogël.

3. Nuk lejohen subvencionime ndërmjet klasave të ndryshme të klientëve.

4. Tarifën e rrjetit duhet të pasqyrojnë kostot aktuale të shërbimit për çdo klient dhe duhet të alokohen në mënyrë sa më të drejtë.

5. Tarifën e rrjetit duhet të japin sinjalet e duhura për përdorimin me eficiencë të rrjetit.

6. Shpenzimet e lejuara në tarifë duhet të jenë transparente për të gjithë pjesëmarrësit.

7. Tarifën e rrjetit duhet t'i lejojnë operatorit të rrjetit të përfitojë normën e lejuar të kthimit mbi bazën e rregulluar të aseteve të miratuara nga ERE.

8. Tarifën e rrjetit duhet të mbeten të qëndrueshme në kohë.

5. Periudha rregullatore e llogaritjes

5.1 Metodologjia parashikon një periudhë llogaritjeje afatshkurtër në vend të një periudhe rregullatore afatgjatë. Kjo qasje mundëson aplikimin e tarifave vjetore për operatorët e rrjetit. Kjo siguron që kostot e larta dhe luhatjet e tyre për shkak të rritjes së infrastrukturës së gazit në Shqipëri të mund të përfshihen në llogaritjet e kostove të rrjetit.

5.2 Periudha rregullatore e llogaritjes duhet të jetë e njëjtë si për rrjetet e transmetimit ashtu edhe ato të shpërndarjes, si saktësohet te përkufizimet e kësaj metodologjie.

6. Dokumentet e veçanta për aktivitetin e transmetimit dhe të shpërndarjes

6.1 Operatori i rrjetit që operon në aktivitetet e transmetimit dhe të shpërndarjes duhet të mbajë evidenca të veçanta për asetet, detyrimet, të ardhurat apo kostot e transmetimit dhe të shpërndarjes mbi baza vjetore. Këto evidenca do të



shërbejnë si pjesë e pasqyrave financiare vjetore të shoqërisë.

6.2 Evidencat vjetore të veçanta për aktivitetin e transmetimit duhet të përmbajnë të gjitha asetet, detyrimet, të ardhurat apo kostot e lidhura me aktivitetin e transmetimit.

6.3 Evidencat vjetore të veçanta për aktivitetin e shpërndarjes duhet të përmbajnë të gjitha asetet, detyrimet, të ardhurat apo kostot e lidhura me aktivitetin e shpërndarjes.

6.4 Alokimi i aseteve, detyrimeve, të ardhurave apo kostove duhet të bëhet mbi bazën e një metode të përshtatshme shpërndarjeje.

## PJESA II

### LLOGARITJA E TARIFAVE TË RRJETIT

#### 7. Parimet e llogaritjes së kostove të rrjetit

7.1 Kostot e vërejtura dhe të shfaqura në pasqyrat financiare të operatorit të rrjetit do të merren parasysh deri në masën që ato përkojnë me kostot që do të kishte një operator rrjeti eficient dhe i mirëmenaxhuar dhe që do të shmangte shpenzimet e tepërta. Rregullatori ka të drejtën të shqyrtojë nivelin e kostove të raportuara nga operatori i rrjetit

Kostot e rrjetit do të përcaktohen pasi të bëhen analizat përkatëse, bazuar në llogarinë humbje/fitime të aktivitetit të vitit paraardhës, pas mbylljes së tij. Siç po përmendim në këtë paragraf, kostot e rrjetit do të jenë ato aktuale, sipas nenit 8, ato të amortizimit sipas nenit 9, ato të kthimit mbi kapitalin sipas nenit 10 dhe të ardhurave të zbritshme nga ato të lejuara sipas nenit 11.

7.2 Operatori i rrjetit do të marrë në konsideratë vetëm ato kosto apo komponentë të tyre që kanë të bëjnë me marrjen nga të tretët të shërbimeve të nevojshme për kryerjen e aktivitetit njësoj sikur t'i kryente vetë ato. Operatori i rrjetit duhet që për secilën nga këto kosto të paraqesë dokumente dhe prova.

7.3 Nëse ndodhin shpenzime apo të ardhura të jashtëzakonshme, ato duhet t'i raportohen pa vonesë rregullatorit.

#### 8. Kostot aktuale

Zërat e kostove, të pasqyruara te PASH-i (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve) si për aktivitetin e transmetimit, ashtu edhe atë të shpërndarjes së gazit natyror, do të merren parasysh në përcaktimin e kostove të rrjetit. Me kosto aktuale kuptojmë kostot direkte të operimit

(kostot e personelit dhe ato materiale), kostot indirekte të operimit (mirëmbajtje, shërbime, riparime dhe të tjera), si dhe shpenzime të përgjithshme (qira, sigurime dhe kosto energjie dhe të tjera). Amortizimi dhe interesi mbi borxhet nuk do të pasqyrohet te kostot aktuale të operimit, pasi ato do të pasqyrohen në kostot e aktivitetit sipas neneve 9 dhe 10. ERE do të vlerësojë nëse këto kosto janë të arsyeshme dhe të justifikuara.

#### 9. Amortizimi i lejuar

9.1 Për të mundësuar një operim afatgjatë, të besueshëm dhe të sigurt të rrjetit do të llogarisim rënien në vlerë të aseteve të nevojshme për operimin e rrjetit, si rezultat i vjetërimit (amortizimit) të tyre, si përshkruhet në nenet 2 dhe 4. Prandaj, në llogaritjen e kostove do të përfshijmë edhe kostot e amortizimit të cilat raportohen në PASH (Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve).

9.2 Amortizimi i aseteve do të llogaritet bazuar në koston e tyre historike sipas metodës së amortizimit linear.

9.3 Amortizimi i secilit aset do të llogaritet çdo vit bazuar në jetëgjatësinë e tij. Jetëgjatësia e çdo asemi nuk do të ndryshojë për periudhat e mbetura të llogaritjes së amortizimit. Llogaritja e amortizimit do të bëhet mbi baza vjetore. Për qëllim të llogaritjes së amortizimit, çdo aset i ri do të njihet si shtesë vetëm për periudhën e vitit që është vënë në shfrytëzim. Jetëgjatësitë përkatëse janë të përcaktuara në aneksin 1.

9.4 Pas përfundimit të periudhës së amortizimit të një asemi vlere e tij do të konsiderohet zero. Nuk lejohet rivlerësim i këtij asemi.

10. Kthimi i lejuar mbi bazën e rregulluar të aseteve

10.1 Kthimi mbi bazën e rregulluar të aseteve të operatorit të rrjetit do të llogaritet sipas formulës:

$$R = RAB \times WACC$$

$$RAB_t = RV_{t-2} + CA_{t-2} + Lt_{-2} + AUC_{t-2} - P_{t-2} - AP_{t-2} - TP_{t-2} - OL_{t-2},$$

ku:

$RV_{t-2}$  - vlere e mbetur e aseteve fikse të trupëzuara të nevojshme për operimin e rrjetit të llogaritura me koston historike të blerjes apo prodhimit në fillim të periudhës rregullatore në vitin (t-2) (pas zbritjes së shumës së amortizimit të aseteve)

$CA_{t-2}$  - vlere sipas bilancit e aseteve qarkulluese të nevojshme për operimin e rrjetit në vitin (t-2) (kapitali i punës)



$L_{t-2}$  - vlera e tokës sipas çmimit të blerjes në vitin (t-2)

$AUC_{t-2}$  - parapagimet dhe asetet në ndërtim (investimet në proces) në vitin (t-2)

$P_{t-2}$  - provizionet në vitin (t-2)

$AP_{t-2}$  - pagesat e marra në avancë, si dhe parapagimet (paradhëniet) nga klientët në vitin (t-2)

$TP_{t-2}$  - llogari të pagueshme mbi të cilat nuk paguhet interes në vitin (t-2)

CG - vlera e aseteve të përfituara nëpërmjet dhurimit

$OL_{t-2}$  - të tjera të pagueshme deri në masën e fondeve në dispozicion të operatorit të rrjetit dhe që mbi të cilat nuk llogaritet interes në vitin (t-2)

Në çdo rast do të merret parasysh mesatarja e vlerës në fillim dhe në fund të vitit.

Në kuptim të paragrafit të sipërpërmendur, provizionet janë detyrime të papërcaktuara në vlerë dhe kohë. Zakonisht vlerësohen me vlerën e arsyeshme që një subjekt paguan në mënyrë që të mbyllë një detyrim në fund të periudhës raportuese apo t'ia transferojë atë një pale të tretë. Në vlerësimin e një provizionit merren parasysh risqet dhe pasiguritë.

Në kuptim të paragrafit të sipërpërmendur, aktivet qarkulluese do të llogariten deri në një shumë të nevojshme për operimin e rrjetit. Operatori i rrjetit duhet të paraqesë në ERE një studim për fondet e kërkuara për mbajtjen e një niveli të përshtatshëm të lëndëve të para, materialeve apo mjeteve monetare për përballimin e detyrimeve korrente apo mbajtjen e rezervave minimale. Në rast se një studim i tillë nuk është i mundur, operatori i rrjetit mund të paraqesë një vlerësim të përafërt të aktiveve korrente me një arsyetim me shkrim për këtë vlerësim të përafërt. Në çdo rast, aktivet qarkulluese nuk duhet të tejkalojnë vlerën e 1/12 të shpenzimeve operative (OPEX) për një periudhë të dhënë rregullatore.

10.2 Operatori i rrjetit duhet të paraqesë dokumentet dhe faktet e nevojshme për këtë qëllim.

10.3 Kthimi mbi kapitalin do të llogaritet në bazë të kostos mesatare të ponderuar të kapitalit (WACC). Baza e rregulluar e aseteve (RAB) do të shumëzohet me WACC-në. Llogaritja do të bazohet mbi një strukturë kapitali prej 60% borxh dhe 40% kapitale të vetat. Kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit llogaritet si më poshtë:

$$WACC = [ES * ARoE / (1 - T)] + (DS * CoD)$$

$$ES + DS = 1,$$

ku:

ES - norma që synohet për raportin e kapitalit e vet shoqërisë në RAB (40%)

T - norma e taksës së korporatës

ARoE - kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet (pas taksave)

DS - norma që synohet për raportin e borxhit në RAB (60%)

CoD - kostoja e borxhit

10.4 Kthimi i lejuar mbi kapitalin pas taksave merret norma bazë e interesit, si dhe një premium për riskun specifik të operatorit të rrjetit. Norma bazë e interesit merret vlera mesatare 5-vjeçare e mesatares së ponderuar të obligacioneve qeveritare të publikuara nga Banka e Shqipërisë.

10.5 Për të llogaritur riskun specifik të operatorit të rrjetit, në mënyrë të veçantë duhet të merren parasysh faktet e mëposhtme:

1. Gjendja e tregjeve kombëtare dhe ndërkombëtare të gazit natyror, si dhe vlera e operatorëve të rrjeteve të gazit natyror në këto tregje;

2. Kthimi mesatar mbi kapitalin e operatorëve të rrjeteve të gazit në tregjet e huaja;

3. Risku aktual dhe i matshëm i biznesit.

10.6 Kthimi mbi kapitalin pas taksave do të vendoset nga ERE. Herën e parë, ky vendim duhet të merret dhe të publikohet në fillim të vitit në të cilin operatorët e rrjetit fillojnë aktivitetin dhe në vazhdim, çdo tre vjet.

10.7 Norma mesatare e interesit mbi huan e përdorur për llogaritjen e WACC-së do të merret mesatarja 5-vjeçare e normave mesatare vjetore të interesit të huave të reja në lekë për prona të patundshme të korporatave private jofinanciare të publikuara nga Banka e Shqipërisë.

11. Të ardhura të tjera të zbritshme

Të ardhura të tjera mund t'u zbriten kostove të rrjetit me kusht që këto të ardhura duhet të burojnë nga shfrytëzimi i rrjetit dhe në mënyrë të veçantë t'u referohen këtyre elementeve të fitimit të lidhura me shfrytëzimin e rrjetit:

1. Puna e vetëkapitalizuar (*own work*);

2. Të ardhurat nga interesi dhe investimet;

3. Kostot e lidhjes në rrjet;

4. Të ardhura të tjera të pasqyruara në llogarinë fitim/humbje pasi i janë nënshtruar gjykimit të ERE-s (të ardhura të tjera të lidhura me aktivitetin e licencuar).



12. Axhustimi i periudhave të mëparshme rregullatore

Pas mbylljes së periudhës rregullatore, operatori i rrejtit duhet të llogarisë diferencën ndërmjet:

1. Të ardhurave të fituara nga tarifave e rrejtit gjatë periudhës në fjalë;

2. Të ardhurave të lejuara për të njëjtën periudhë.

Nëse të ardhurat e llogaritura sipas pikës 1 të këtij neni tejkalojnë ato të lejuara sipas pikës 2, kjo diferencë llogaritur me një normë të caktuar interesi mbi mesataren e këtyre diferencave duhet t'u zbritet të ardhurave të realizuara sipas tarifave të miratuara dhe do të reflektohet në ulje të kostove.

Nëse të ardhurat e llogaritura sipas pikës 1 janë më pak se ato të llogaritura sipas pikës 2, kjo diferencë e llogaritur me një normë të caktuar interesi mbi mesataren e këtyre diferencave, norme interesi e cila do të llogaritet sipas parashikimeve të nenit 10, paragrafi 7 dhe do të reflektohet në rritje të kostove.

Kjo diferencë në rritje apo në zbritje do të kompensohet përgjatë tri periudhave të njëpasnjëshme llogaritjeje. Kjo shumë do të llogaritet si mesatare diferencash ndërmjet të ardhurave dhe kostove të periudhave përkatëse.

### PJESA III

#### TARIFAT E RRJETIT TË TRANSMETIMIT

13. Llogaritja e kostove të rrejtit të transmetimit

13.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të llogarisë kostot e rrejtit të transmetimit në përputhje me nenet 7–12 të kësaj metodologjie.

13.2 Llogaritja e kostove të rrejtit të transmetimit duhet të bazohet në llogaritë e ndara të aktivitetit të transmetimit sipas kapitullit 6 të kësaj metodologjie.

13.3 Llogaritja e kostove të rrejtit të transmetimit do të përfshijë, gjithashtu, asetet dhe kostot që lidhen me matjen në sistemin e transmetimit. Kostot e matjes në rrejtin e transmetimit janë kostot e matjes dhe ato administrative të lidhura me matjet në transmetim sipas një metode të përshtatshme alokimi.

14. Rregulla të veçanta për vendosjen e tarifave të transmetimit

14.1 Kostoja e rrejtit të transmetimit do të mbulohet plotësisht nga tarifave e kapacitetit të rrejtit të transmetimit.

14.2 Operatori i rrejtit të transmetimit do të

vendosë çmime të kapacitetit mbi baza vjetore, tremujore, mujore, ditore dhe, nëse është e zbatueshme edhe brenda ditës. Tarifa për një produkt të caktuar do të përfshijë të gjitha shërbimet ndihmëse të lidhura me të.

14.3 Produktet mbi baza kapaciteti do të llogariten sipas një metodologjie me çmim reference. Të njëjtat metoda me çmime reference do të bazohen në të gjitha pikat hyrëse dhe dalëse të rrejtit të transmetimit. Aplikimi i metodave të çmimit të referencës duhet të përputhet me parimet e vendosura në nenin 4.5 të kësaj metodologjie.

14.4 Tarifa për pikat hyrëse dhe dalëse të rrejtit të transmetimit përbëhen nga një tarifë kapaciteti (lekë/kw). Tarifa e kapacitetit do të publikohet si për kapacitetet e qëndrueshme ashtu edhe ato me ndërprerje. Çmimi i kapacitetit me ndërprerje duhet të reflektojë probabilitetin e ndërprerjes.

14.5 Tarifave do të vendosen për çdo pikë hyrjeje dhe daljeje në mënyrë të veçantë në rrejtin e transmetimit.

14.6 Tarifa nuk do të varet nga niveli i presionit apo distance nga pika e hyrjes së gazit deri në pikën e saj dalëse.

14.7 Tarifave e matjes do të vendosen për çdo pikë hyrjeje dhe daljeje të rrejtit të transmetimit. Tarifave e matjes mbulojnë instalimin, mirëmbajtjen dhe ndërrimin e matësve (duke përfshirë kostot kapitale), si dhe leximin dhe përpunimin e të dhënave. Këto tarifa duhet të pasqyrojnë kostot përkatëse.

14.8 Operatori i rrejtit të transmetimit mban të dhëna të detajuara të metodave të llogaritjes së tarifave në mënyrë që ato të jenë të kuptueshme për përdoruesit dhe palët e treta të interesuara, si dhe këto të dhëna paraqiten me kërkesë të ERE-s.

### PJESA IV

#### TARIFAT E RRJETIT TË SHPËRNDARJES

15. Llogaritja e kostove të rrejtit të shpërndarjes

15.1 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të llogarisë kostot e rrejtit të shpërndarjes në përputhje me nenet 7–12 të kësaj metodologjie.

15.2 Llogaritja e kostove të rrejtit të shpërndarjes bazohet në dokumente të mbajtura mbi baza vjetore për këtë qëllim dhe që lidhen me aktivitetin e shpërndarjes sipas kapitullit 6 të kësaj metodologjie.

15.3 Llogaritja e kostove të rrejtit të shpërndarjes do të përfshijë edhe asetet apo kostot



që lidhen me matjen në rrjetin e shpërndarjes. Kostot e matjes në rrjetin e shpërndarjes janë kostot e matjes dhe ato administrative që lidhen me matjen në rrjetin e shpërndarjes mbi bazën e një metode të përshtatshme alokimi.

16. Rregulla të veçanta për vendosjen e tarifave të shpërndarjes

16.1 Kostoja e rrjetit të shpërndarjes do të përballohet plotësisht nga tarifat e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes.

16.2 Tarifat e rrjetit në pikat dalëse të rrjetit të shpërndarjes do të përbëhen nga një komponent vjetor kapaciteti (lekë/kw) dhe një komponent vjetor energjie (lekë/kwh). Komponenti vjetor i kapacitetit përfitohet duke shumëzuar tarifën e kapacitetit me kapacitetin maksimal të shfrytëzimit në pikën dalëse të rrjetit në vitin ushtrimor. Komponenti vjetor i energjisë përfitohet duke shumëzuar tarifën e energjisë me sasinë e energjisë së konsumuar në vitin ushtrimor.

16.3 Për shitjet pa profil ngarkese në rrjetin e shpërndarjes, në vend të një tarife kapaciteti dhe energjie, do të përdoret vetëm një tarifë energjie e matur në lekë/kwh. Derisa të vendoset një tarifë mujore (lekë/muaj), ky çmim bazë dhe tarifa e energjisë duhet të jenë në raporte të arsyeshme me njëra-tjetrën. Tarifa që rezulton nga çmimi bazë dhe tarifa e energjisë duhet të jenë raporte të arsyeshme me tarifën që do të paguajë në rast të një shpërndarjeje mbi bazë të profilit të ngarkesës bazuar në të dhënat e kërkesës për kapacitet dhe energji në përputhje me profilin standard të ngarkesës së përdoruesve të rrjetit.

16.4 30% e kostove të rrjetit të shpërndarjes do të përballohen nga tarifa e energjisë dhe 70% e kostove të rrjetit të shpërndarjes do të përballohen nga tarifa e kapacitetit. Tarifat e kapacitetit do të varen nga ngarkesa maksimale vjetore ndërsa tarifat e energjisë, nga konsumi vjetor i saj.

## PJESA V

### DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

17. Afatet e paraqitjes së aplikimit dhe miratimi

17.1 Bazuar në këtë metodologji, operatori i rrjetit do të paraqesë në ERE një kërkesë për miratimin e tarifave të reja, jo më vonë se 6 muaj para hyrjes së tyre në fuqi (t-1)

17.2 Në aplikim, operatori i rrjetit do të paraqesë në ERE të gjithë të dhënat e nevojshme për kostot e rrjetit dhe tarifat e vitit paraardhës për

të cilin janë mbyllur pasqyrat financiare (t-2)

17.3 Pasi të marrë vendimin, ERE do t'ia njoftojë atë operatorit të rrjetit deri në fund të nëntorit të atij viti. Operatori i rrjetit i publikon këto tarifa në faqen e tij të internetit tri ditë pasi është njoftuar. ERE do të publikojë vendimin e saj në faqen e saj të internetit.

18. Kërkesat për publikim

18.1 Operatori i rrjetit është i detyruar të publikojë tarifat e rrjetit në faqen e tij të internetit, si dhe të japë informacion me shkrim sipas kërkesës.

18.2 Për më tepër, operatori i rrjetit, në datën 1 prill të çdo viti duhet të publikojë këto karakteristika të rrjetit:

1. Gjatësia e gazsjellësit ndarë sipas niveleve të presionit (i ulët, i mesëm, i lartë) më 31 dhjetor të vitit paraardhës;

2. Gjatësia e gazsjellësit në nivel të lartë presioni ndarë sipas llojeve të diametrit të tubacionit;

3. Energjia vjetore (në kwh apo m<sup>3</sup>) livruar shpërndarësve dhe klientëve fundorë në vitin paraardhës;

4. Numri i pikave hyrëse dhe dalëse për çdo nivel presioni;

5. Maksimumi i kërkesës vjetore për të gjitha pikat e livrimit në mw apo m<sup>3</sup> për orë, si dhe koha në të cilën ndodh.

19. Dokumentacioni

19.1 Me vendosjen e tarifave, operatori i rrjetit do të përgatisë një raport në lidhje me këto tarifa. Raporti duhet të përmbajë:

1. Një përshkrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet për të gjithë periudhën e mbyllur ushtrimore;

2. Një pasqyrim të plotë të metodës së llogaritjes së tarifave të rrjetit, si dhe shpjegime të tjera plotësuese në lidhje me këto tarifa;

3. Raporti i plotë i auditimit të pasqyrave financiare, si dhe dokumente të tjera plotësuese.

19.2 Ky raport do të ruhet për një periudhë 10-vjeçare.

20. Monitorimi, vlerësimi dhe të drejtat e ERE-s.

20.1 ERE vazhdimisht monitoron vendosjen e tarifave nga operatori i rrjetit. 5 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj metodologjie, ERE vlerëson përshtatshmërinë dhe funksionimin e metodologjisë dhe publikon një raport në lidhje me statusin e mëtejshëm të kësaj metodologjie. Raporti përmban informacionin e nevojshëm në lidhje me



investimet e operatorit të rrjetit, efektshmërinë, si dhe masat e marra për shmangien e barrierave në lidhje me investimet.

20.2 Në këtë raport ERE mund të propozojë, ndër të tjera:

1. Heqjen e barrierave për investimet;
2. Zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të metodologjisë së tarifave;
3. Zhvillimin e rregullave të mëtejshme në lidhje me transparencën e metodologjisë së tarifave;
4. Hartimin e një metodologjie të re tarifash (p.sh., nëpërmjet mekanizmave nxitës)
5. Hartimin e metodologjive të veçanta për aktivitetet e operimit të rrjeteve të transmetimit dhe të shpërndarjes;

#### 21. Dispozita tranzitore

21.1 Nëse ndodh që tarifat e llogaritura në bazë të kësaj metodologjie tejkalojnë mesataren e tarifave të rrjetit në vendet fqinje dhe si rrjedhojë çmimet e gazit të klientëve fundorë nuk janë konkurruese krahasuar me burimet e tjera të energjisë, llogaritja e tarifave të rrjetit, sipas nenit 14 e 16 mund të bëhet në bazë të analizave krahasuese të operatorëve të rrjetit në vendet fqinje. Operatori i rrjetit mund ta shfrytëzojë këtë opsion vetëm për 5 vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj metodologjie. Operatori i rrjetit do të paraqesë një vëzhgim mbi

tarifat e rrjetit në vendet fqinje, si dhe një vlerësim në lidhje me konkurrueshmërinë e çmimeve të klientëve fundorë që furnizohen me gaz natyror në Shqipëri, me të dhëna të sakta që mbështesin një vlerësim të tillë. Këto materiale duhet të përgatiten çdo vit dhe do t'i bashkohen dosjes së aplikimit për tarifë, sipas nenit 17.1.

ERE, në mënyrë të veçantë, do të miratojë një përjashtim të tillë sipas nenit 17.3.

21.2 Nëse ndodh që mungojnë të dhënat nga vitet paraardhëse sipas nenit 4.4, për periudhën e parë rregullatore pas hyrjes në fuqi të kësaj metodologjie, operatori do të paraqesë një vlerësim me të dhëna të arsyeshme, gjatë aplikimit për tarifë.

21.3 Aplikimi i parë nga shoqëria sipas kësaj metodologjie, do të jetë jo më vonë se data 4 dhjetor 2017.

21.4 Çdo amendim i ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” në lidhje me vendosjen e tarifave të rrjeteve të gazit apo mbulimit të kostove të rrjetit nuk do të ndikohet nga parashikimet e kësaj metodologjie.

#### 22. Dispozita përfundimtare

Metodologjia për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror, u miratua me vendim të bordit të ERE-s nr. 178, datë 8.11.2017.

### ANEKSI 1

	Limiti i poshtëm	Limiti i sipërm
	Vitet	Vitet
Parcela toke	∞	∞
Prona, ndërtesa për transport	25	35
Ndërtesa për shoqërinë	50	60
Ndërtesa për zyra	60	70
Hekurudha dhe vagonë	23	27
Pajisje zyre (pa programet dhe pajisjet shtesë)	8	10
Mjetet e punës/pajisjet	14	18
Magazinat	14	25
Pajisjet kompjuterike	4	8
Programet kompjuterike	3	5
Makineritë e lehta	5	5
Makineritë e rënda	8	8
Depozitat e gazit	45	55
Ambientet e komprimimit të gazit		
Komprimimi i gazit	25	25
Ambientet e pastrimit të gazit	25	25
Tubacionet dhe montimi	25	25





Matja e gazit/ambientet e matjes	25	25
Infrastruktura për sigurinë (ambientet e komprimimit të gazit natyror)	25	25
Teknologjia e kontrollit të energjisë (ambientet e komprimimit të gazit natyror)	25	25
Ambientet ndihmëse (ambientet e komprimimit të gazit natyror)	25	25
Ndërtesat, infrastruktura e transportit (ambientet e komprimimit të gazit natyror)	25	25
Tubacionet/tubat shtëpiakë (tuba çeliku – veshja me polietilen)	45	55
Tubacionet/tubat shtëpiakë (tuba çeliku – mbrojtja katodike)	55	65
Tubacionet/tubat shtëpiakë (tuba çeliku – izoluar me katrama)	45	55
Tubacionet/tubat shtëpiakë (giza gri; diametri nominal > 150)	45	55
Tubacionet/tubat shtëpiakë (forma të derdhura në fonderi)	45	55
Tubacionet/tubat shtëpiakë (polietilen molekular me dendësi të lartë)	45	55
Tubacionet/tubat shtëpiakë (PVC)	30	40
Tubacionet/tubat shtëpiakë (montime/stacione montimi)	45	45
Tubacionet/tubat shtëpiakë (sondat pastruese të tubacioneve)	45	45
Tubacionet/tubat shtëpiakë (pajisjet e sigurisë)	45	45
Matja, sistemi i matjes dhe i kontrollit (matësit e sasisë së gazit)	8	16
Matja, sistemi i matjes dhe i kontrollit (rregullatori i trysnisë së gazit)	15	25
Matja, sistemi i matjes dhe i kontrollit (pajisjet matëse)	45	45
Matja, sistemi i matjes dhe i kontrollit (pajisjet kontrolluese)	45	45
Matja, sistemi i matjes dhe i kontrollit (vendosja e pajisjeve të sigurisë)	20	30
Matja, sistemi i matjes dhe i kontrollit (teknologjia e kontrollit të energjisë)	10	30
Matja, sistemi i matjes dhe i kontrollit (kompresorët në sistemin e përzierjes së gazit në varësi të afatit të përdorimit)	15	30
Matja, sistemi i matjes dhe i kontrollit (sistemet ndihmëse)	15	30
Matja, sistemi i matjes dhe i kontrollit (ndërtesat)	60	60
Sistemet e kontrollit në distancë	15	20



## VENDIM

Nr. 179, datë 8.11.2017

### **MBI CERTIFIKIMIN E SHOQËRISË OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR, ALBGAZ SHA**

Në mbështetje të neneve 37, 50, 59, 68, dhe 80 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; vendimit të Këshillit Ministerial nr. D/2011/02/MC-EnC; Traktatit të Komunitetit të Energjisë, të ratifikuar me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, si dhe neneve 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të “Rregullores për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror”, miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015 të bordit të ERE-s, dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike në lidhje me certifikimin e shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror, AlbgaZ sh.a., që në këtë vendim i referohemi me Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST),

Duke konsideruar se:

- Ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” është përafuar plotësisht me direktivën 2009/73/KE, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 13 korrik 2009, “Mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror”, përfshirë kërkesat e parashikuara për certifikimin e operatorëve të sistemit të transmetimit”;

- Në bazë të nenit 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, operatori i kombinuar ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga veprimtaritë e tjera në sektorin e naftës dhe gazit, si prodhimi, tregtimi dhe furnizimi me gaz natyror, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

- Në nenet 37, 50, 59, 68, dhe 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, përcaktohet se para se të licencohet për kryerjen e veprimtarisë së operimit të sistemit të transmetimit, operatori i kombinuar duhet të certifikohet sipas procedurës së përcaktuar në këto nene. ERE përcakton kërkesat për aplikim për certifikim të operatorit të kombinuar, përfshirë dokumentacionin e nevojshëm që provon përmbushjen e kushteve, sipas neneve 37, 50, 59, 68, dhe 80 të këtij ligji. Aplikimi për certifikim

paraqitet nga operatorit i kombinuar, në përputhje me kërkesat e miratuara nga ERE. Në këto nene përcaktohet, gjithashtu, se:

- ERE merr një vendim lidhur me certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit brenda 4 muajve nga data e aplikimit dhe dorëzimit të të gjithë dokumentacionit dhe informacionit të kërkuar.

- ERE mund të kërkojë nga operatori i kombinuar çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e këtij detyrimi.

- ERE njofton Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për certifikimin paraprak të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe merr vendim final brenda 2 muajve nga data e marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, duke marrë në konsideratë rekomandimet e tij.

- Nëse vendimi përfundimtar i ERE-s është i ndryshëm nga opinioni i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ERE duhet të publikojë dhe të arsyetojë shkaqet e mospranimit të tyre, duke informuar Sekretariatit për këtë vendim.

- ERE monitoron përputhshmërinë e veprimtarisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

- Në bazë të nenit 36, pikat 2, 3, 4, 5, 6, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, përcaktohet se i njëjti person ose të njëjtët persona nuk kanë të drejtë që në të njëjtën kohë:

a) të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një të licencuar, që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo të furnizimit të gazit natyror e të energjisë elektrike, dhe të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen ose ndonjë të drejtë tjetër ndaj Operatorit të Sistemit të Transmetimit apo rrjetit të transmetimit;

b) të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen apo të ushtrojnë ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo të furnizimit të gazit natyror dhe të energjisë elektrike;

c) të emërojnë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht Operatorin e Sistemit të Transmetimit apo rrjetin e transmetimit dhe, në mënyrë të



drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen apo ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo të furnizimit të gazit natyror dhe të energjisë elektrike;

ç) të jenë anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose të furnizimit të energjisë elektrike e të gazit natyror dhe veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të transmetimit.

3. Ndalimet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2, të këtij neni, zbatohen në mënyrë të veçantë për:

a) kompetencën për të ushtruar të drejtën e votës;

b) kompetencën për të emëruar anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë të licencuarin;

c) të drejtën e mbajtjes së një pjese të shumicës së aksioneve.

4. Detyrimi i parashikuar në pikën 2 të këtij neni, konsiderohet se është përmbushur nëse dy ose më shumë shoqëri, të cilat kanë rrjetet e tyre të transmetimit, kanë krijuar një sipërmarrje të përbashkët, e cila vepron si një operator i sistemit të transmetimit në dy ose më shumë shtete. Asnjë shoqëri tjetër nuk mund të jetë pjesë e kësaj sipërmarrjeje të përbashkët, përveç rastit kur shoqëria është përcaktuar si operator i pavarur i sistemit të transmetimit dhe është certifikuar sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

5. Kur personi i përmendur në pikën 2, të këtij neni, është një organ publik që kontrollohet nga shteti, atëherë dy organe të veçanta publike që ushtrojnë kontroll, njëri mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe tjetri mbi të licencuarin që kryen funksionin e prodhimit ose të furnizimit të gazit natyror e të energjisë elektrike, do të konsiderohen sikur nuk janë i njëjti person.

6. Operatori i kombinuar, i cili ka qenë pjesë e një shoqërie të integruar vertikalisht, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, merr masat që të mos përhapë apo të mos transferojë informacione të ndjeshme tregtare të njësitë e tjera të shoqërisë së mëparshme të integruar vertikalisht, që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo të furnizimit të gazit natyror dhe të energjisë elektrike.

- Neni 36 i ligjit. Kur personi i përmendur në paragrafin më sipër, është një organ publik që kontrollohet nga shteti, atëherë dy organe të veçanta publike që ushtrojnë kontroll, njëri mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe tjetri mbi të licencuarin që kryen funksionin e prodhimit ose të furnizimit të gazit natyror, do të konsiderohen sikur nuk janë i njëjti person.

- Neni 35, i ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” kërkon që operatori i kombinuar të funksionojë si person juridik i licencuar për kryerjen e veprimtarisë së transmetimit të gazit natyror, i cili ka në pronësi sistemin e transmetimit dhe respekton parimin e pavarësisë, të përcaktuar në nenin 36 të ligjit, siç është cituar më sipër.

Sa më sipër, përmbush kriteret lidhur me themelimin e operatorit në një nga format ligjore të parashikuara dhe moskrijimin e konfuzionit në lidhje me identitetin e tij, i cili duhet të jetë qartësisht i dallueshëm nga i ndërmarrjeve të tjera,

- Neni 41 i ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ka përcaktuar përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit në përputhje me detyrat e përcaktuara në ligj.

- Në çdo rast, bazuar në nenin 39, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe në përputhje me nenin 4 të rregullores “Rregullat për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”, miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015, dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, ERE monitoron përputhshmërinë e veprimtarisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror dhe rishikon procedurën e certifikimit.

Me vendimin nr. 503, datë 13.9.2017 të Këshillit të Ministrave është vendosur mbi përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së financave.

Në lidhje me fushën e përgjegjësisë së kësaj ministrie është vendosur si më poshtë:

Misioni i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është arritja e stabilitetit ekonomik nëpërmjet drejtimit me efektshmëri, efektivitet dhe transparencë të financave publike. Ajo përgatit dhe zbaton politikat e qeverisë në sferën ekonomike, për bashkërendimin e ndihmës së huaj, të tregtisë, strehimit dhe të sipërmarrjes për ndërtimin e një modeli të ri ekonomik, me synim rritjen ekonomike, të lartë e të qëndrueshme në Shqipëri.



Kjo ministri harton dhe zbaton politika të integruara ekonomike në sektorët parësorë të ekonomisë, konvergimit ekonomiko-social të rajoneve të vendit, përmirësimit të klimës e të shërbimeve për biznesin dhe sipërmarrjen.

Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për arsim dhe formim profesional, punësim të sigurt e të denjë, sigurim shoqëror.

III. Ministria e Financave dhe Ekonomisë e ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie shtetërore në përputhje me legjislacionin përkatës:

1. Politikën makroekonomike dhe fiskale;
  2. Administrimin e të ardhurave;
  3. Administrimin e buxhetit të shtetit;
  4. Menaxhimin e borxhit publik;
  5. Administrimin financiar;
  6. Menaxhimin financiar dhe kontrollin;
  7. Menaxhimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian dhe bashkërendimin e ndihmës së huaj;
  8. Inspektimin financiar publik;
  9. Bashkërendimin e përgjithshëm të auditimit të brendshëm;
  10. Fushën e strehimit;
  11. Fushën e punësimit;
  12. Fushën e arsimit dhe formimit profesional;
  13. Administrimin e fondit të sigurimeve shoqërore;
  14. Marrëveshjet e tregtisë së lirë;
  15. Fushën e mbrojtjes së sipërmarrjes dhe të biznesit vendës;
  16. Nxitjen e investimeve të huaja;
  17. Administrimin e pronës shtetërore;
  18. Mbështetjen e partneritetit publik privat;
  19. Fushën e regjistrimit dhe të licencimit të operatorëve ekonomikë;
  20. Fushën e shërbimit të akreditimit dhe të standardizimit;
  21. Fushën e mirëmbajtjes, kalibrimit dhe të inspektimit të mjeteve matëse;
  22. Fushën e pronësisë industriale;
  23. Fushën e mbrojtjes së pronësisë intelektuale;
  24. Fushën e mbrojtjes së konsumatorëve.
- IV. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, për realizimin e fushës së përgjegjësisë, sipas pikës III, të këtij vendimi, është përgjegjëse, për:

1. Hartimin dhe zbatimin e politikave fiskale, në të cilat përfshihen analizat makroekonomike, parashikimi i të ardhurave, politika e shpenzimeve

publike, politika e taksave, politika e borxhit publik;

2. Mbikëqyrjen dhe ndërmarrjen e nismave dhe hapave ligjorë, me qëllim administrimin e të ardhurave, në të cilat përfshihen, kryesisht, administrimi i taksave dhe administrimi doganor;

3. Hartimin e politikave për miradministrimin e buxhetit, në të cilat përfshihen planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, kontrolli i menaxhimit të investimeve publike, monitorimi i marrëdhënieve financiare ndërqeveritare, kontrolli financiar i transaksioneve publike dhe hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të qeverisë;

4. Menaxhimin e borxhit publik, në të cilin përfshihen menaxhimi i portofolit të huamarrjes së brendshme dhe të huaj, menaxhimi i riskut të huamarrjes, si dhe shërbimi i regjistrimit të borxhit;

5. Ngritjen e një sistemi modern të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në të gjitha njësitë e sektorit publik, nëpërmjet vendosjes së rregullave, standardeve, procedurave dhe monitorimit të zbatimit të tyre;

6. Miradministrimin financiar të fondeve publike, i cili realizohet nëpërmjet ushtrimit të funksionit të thesarit, zbatimit të metodologjisë së kontabilitetit në sektorin publik dhe kontrollit të brendshëm financiar publik;

7. Menaxhimin e ndihmës financiare të Bashkimit Evropian dhe bashkërendimin e ndihmës së huaj. Në funksion të këtij mirëmenaxhimi është sigurimi i bashkëfinancimit, si dhe ndjekja e zbatimit të kontratave. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë është përgjegjëse edhe për legjitimitetin dhe rregullsinë e transaksioneve të ekzekutuara brenda sistemit të menaxhimit të decentralizuar, si dhe për funksionimin e efektshëm të sistemeve të menaxhimit të kontrollit në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA);

8. Inspektimin financiar publik, si funksion i parashikuar me qëllim:

a) mbrojtjen e interesave financiarë të njërive publike kundrejt keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit dhe korrupsionit;

b) rregullshmërinë e transaksioneve e të veprimtarive të tjera të menaxhimit financiar publik;

c) përcaktimin e shkeljeve të akteve normative, si dhe dyshimeve për mashtrimet e kryera;

ç) zbulimin e parregullsive e të dëmeve të shkaktuara në pronën e njërive publike;



d) identifikimin e shkeljeve e të individëve përgjegjës për parregullsitë e zbuluara.

9. Zhvillimin e politikave shtetërore në fushën e punësimit, në fushën e emigracionit dhe imigracionit të punës;

10. Zhvillimin e politikave shtetërore për arsimin dhe formimin profesional;

11. Zhvillimin e politikave në fushën e marrëdhënieve të punës, inspektimit, sigurisë dhe shëndetit në punë;

12. Zhvillimin e politikave dhe monitorimin e politikave, të legjislacionit e të veprimtarive që kanë të bëjnë me sigurimet shoqërore, si dhe procesin e bashkërendimit të punës për skemat e mbrojtjes shoqërore me vendet e tjera;

13. Bashkërendimin institucional të procesit të negociimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet e rajonit dhe më gjerë;

14. Hartimin dhe zbatimin e politikave ekonomike për mbrojtjen e biznesit vendës nga praktika të pandershme të tregtisë ndërkombëtare;

15. Bashkërendimin e programimit, vlerësimit dhe monitorimit të investimeve të huaja, në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit;

16. Ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga të qenit pronar i pronës shtetërore;

17. Krijimin e një klime dhe mjedisi legjislativo-institucional mbështetës për sipërmarrjen, nëpërmjet nxitjes së biznesit dhe liberalizimit të tregut, duke reduktuar pengesat administrative dhe kostot e biznesit për eliminimin e informalitetit dhe korrupsionit, duke u mbështetur në partneritetin e vazhdueshëm publik-privat;

18. Zhvillimin e politikave në favor të biznesit të vogël dhe të mesëm, në përputhje me politikën përkatëse evropiane në bashkëpunim me dhomat e tregtisë, shoqatat e biznesit dhe shoqërinë civile;

19. Ofrimin e shërbimit të regjistrimit dhe të licencimit të operatorëve ekonomikë që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

20. Ofrimin e shërbimit të akreditimit për organizmat e vlerësimit të konformitetit;

21. Përshtatjen e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të biznesit për përfitimet nga zbatimi i standardeve teknike në produktet dhe shërbimet e tyre;

22. Zhvillimin dhe mirëmbajtjen e etaloneve kombëtare të njëjësive të matjes;

23. Kalibrimin dhe verifikimin e mjeteve matëse;

24. Realizimin e inspektimit metrologjik;

25. Propozimin e masave ligjore në fushën e pronësisë industriale;

26. Regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale (patentat e shpikjeve, markat, dizenjot industriale dhe treguesit gjeografikë);

27. Mbrojtjen e pronësisë intelektuale;

28. Mbikëqyrjen dhe bashkërendimin e punës për politikën dhe veprimtaritë e institucioneve të infrastrukturës së cilësisë (standardizimi, akreditimi dhe metrologjia);

29. Mbikëqyrjen efektive të tregut për të garantuar përputhshmërinë e produkteve të konsumatorëve me kërkesat ligjore në lidhje me to, me qëllim që të mos rrezikohen: shëndeti, siguria ose aspekte të tjera të mbrojtjes së interesit publik;

30. Bashkërendimin e punës për harmonizimin e legjislacionit në fushën e ofrimit të shërbimeve dhe të zbatimit të plotë të parimit të trajtimit kombëtar dhe mosdiskriminimit.

V. Ministria e Financave dhe Ekonomisë është institucioni i vetëm që bën bashkërendimin e përgjithshëm të veprimtarisë së auditimit të brendshëm nëpërmjet hartimit dhe miratimit të politikave, manualeve, metodave, procedurave, udhëzimeve dhe rregulloreve të auditit të brendshëm.

VI. Kjo ministri ka rol të përgjithshëm këshillues në interes të politikave qeveritare për promovimin e efektshmërisë, performancës së lartë dhe mirëqeverisjes financiare në të gjithë sektorin publik dhe në ato institucione financiare në të cilat qeveria merr pjesë.

VII. Ministria e Financave dhe Ekonomisë përfaqëson dhe mbron interesat e shtetit brenda fushës së përgjegjësisë, sipas pikës III të këtij vendimi.

VIII. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 841, datë 27.9.2013, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave”, dhe nr. 835, datë 18.9.2013, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”, të ndryshuara, shfuqizohen.

Me vendimin nr. 504, datë 13.9.2017 të Këshillit të Ministrave, është vendosur për përcaktimin e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Në lidhje me fushën e përgjegjësisë së kësaj ministrie është vendosur si më poshtë:



II. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka si industri hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore, në sektorin e planifikimit dhe të zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës dhe transportit, në sektorin e telekomunikacionit e shërbimit postar, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare dhe në sektorin e industrisë.

III. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

1. Fushën e planifikimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm urban.

2. Fushën e standardeve urbane në ndërtim.

3. Fushën e mbetjeve urbane në lidhje me planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve.

4. Hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të infrastrukturës, ku bëjnë pjesë infrastruktura dhe transporti, përfshirë edhe atë me tubacione për ujësjellës-kanalizimet dhe bashkërendimi i politikave të infrastrukturës së mbetjeve urbane në komponentin zbatues të tyre dhe ndjekjen e zbatimit e këtyre politikave.

5. Drejtimin, menaxhimin, supervizimin dhe vendosjen e standardeve teknike të infrastrukturës së rrjeteve rrugore e hekurudhore, tubacioneve, porteve, aeroporteve, ujësjellës-kanalizimeve, venddepozitimeve të mbetjeve dhe digave të mëdha të hidrocentraleve. Përcaktimin dhe vendosjen e standardeve për të gjitha llojet e mjeteve të transportit dhe organizimin e drejtimit të kontrollit shtetëror të sigurisë teknike në sferën e shfrytëzimit.

6. Monitorimin e realizimit të standardeve të përcaktuara në funksion të zhvillimit të infrastrukturës në transport, ujësjellës-kanalizime, si dhe të punimeve të ndërtimit për zbatimin e rregullave për kontrollin e disiplinimin e tyre në aspektin financiar dhe teknik.

7. Zhvillimin e hapësirës së nismës së industrisë private në aktivitetet e shërbimit të llojeve të transportit, si dhe krijimin e kushteve për një konkurrencë të drejtë ndërmjet llojeve të transportit e zhvillimin e konkurrencës në sistemin e licencimit.

8. Drejtimin, përmirësimin, zgjerimin dhe zhvillimin e shërbimeve të informacionit në transport dhe infrastrukturë për sigurimin e burimit të të dhënave të gjithanshme e të vazhdueshme, për

krijimin e kushteve lehtësuese të të gjithë përdoruesve dhe operuesve vendës e të huaj, si dhe të përshtatshme për t'u inkuadruar në sistemet evropiane të informacionit.

9. Sektorin e energjisë, burimeve energjetike, përfshirë edhe burimet e rinovueshme të energjisë, eficiencën e energjisë dhe ndryshimet klimatike.

10. Sektorin e hidrokarbureve (naftë dhe gaz).

11. Sektorin e minierave dhe gjeologjisë.

12. Sektorin e industrisë joushqimore.

13. Telekomunikacionin dhe shërbimin postar.

IV. Vendimet nr. 833, datë 18.9.2013, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë", të ndryshuar, nr. 954, datë 16.10.2013, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës", nr. 944, datë 9.10.2013, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Urban", të ndryshuar, dhe nr. 943, datë 9.10.2013, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike", të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

Në zbatim të VKM-së nr. 503 dhe VKM-së nr. 504, datë 13.9.2017, në këtë vendim çdo referencë pas datës 13.9.2017 e në vijim do të kuptohet:

2. Në vendimet nr. 841, datë 27.9.2013 dhe nr. 835, datë 18.9.2013, do të lexohet VKM-ja nr. 503, datë 13.9.2017.

1. Në vendimet nr. 833, datë 18.9.2013 dhe nr. 944, datë 9.10.2013 do të lexohet VKM-ja nr. 504, datë 13.9.2017.

Duke konsideruar se:

- Në përputhje me sa përcaktuar në nenin 2, 5, 6, dhe 7 të rregullores miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015, dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, ku përcaktohet se ndër kriteret që duhet të përmbushen nga aplikuesi për të mundësuar vendimmarrjen dhe certifikimin e tij nga rregullatori, konsiston në:

- Personi juridik që ka pronësinë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror nuk duhet të ketë të drejta kontrolli të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në aktivitetet e tjera;

- Në nenin 7 të rregullores së sipërcituar, përcaktohet se, në vijim të zbatimit të të gjitha kërkesave për ndarjen e aktivitetit të operatorit të sistemit të transmetimit të gazit natyror, shoqëria



aplikuese duhet të njoftojë ERE-n me shkrim dhe duhet të paraqesë:

- kërkesën me shkrim për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të gazit natyror;

- dokumentet, të dhënat dhe informacionet e përmendura në kapitullin III të rregullores; dhe

- pyetësozin e plotësuar për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të gazit natyror, sipas modelit të dhënë në shtojcën e kësaj rregulloreje, përveç rasteve kur kompania që ka paraqitur kërkesën është e përgjatur, vendimi i përgjaturit të të cilit parashikon kushtet dhe kërkesat për ndarjen e aktivitetit. Kërkesa për certifikim si operator i sistemit të transmetimit duhet të paraqitet dhe po ashtu procedurat përkatëse të certifikimit duhet të kryhen në mënyrë të pavarur nga licencimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

- Certifikimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror kryhet vetëm një herë ose në të kundërt rishikohet nëse janë kryer ndryshime thelbësore në lidhje me kontrollin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror ose zotëruesin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror të certifikuar më parë apo nëse kanë ndodhur apo parashikohet të ndodhin ndryshime të cilat cenojnë përmbushjen e kritereve të përcaktuara në këto rregulla.

- Në nenin 8 të “Rregullave për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”, miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015, dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, janë përcaktuar të dhënat, dokumentet, dhe informacionin mbështetës që të përmbushen nga aplikuesi për të mundësuar vendimmarrjen dhe certifikimin. Në nenin 11, përcaktohet se ERE do të certifikojë Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror, bazuar në procedurat e vendosura në këtë rregullore.

Referuar “Rregullave për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”, miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015, dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, pjesa shtojca, aplikuesi duhet të plotësojë pyetësozin për certifikimin e Operatorit të Kombinuar për Gazin Natyror, sipas modelit të dhënë në shtojcën e kësaj rregulloreje.

- Paraqitja e aplikimit

- Siç cituar më sipër, shoqëria operatori i kombinuar i gazit natyror Albgaz sh.a., me shkresën nr. 3 prot., datë 20.2.2017, regjistruar në ERE me nr. 166 prot., datë 20.2.2017, ka paraqitur kërkesën, për certifikimin në aktivitetin si operator i kombinuar, bazuar në nenet 37, 50, 59, 68, dhe 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

- Kjo kërkesë është shoqëruar me informacionin e nevojshëm, të përcaktuar në “Rregullat për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”, miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015, dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, si dhe pikës 7, të VKM-së nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të shoqërive të sektorit të gazit natyror”, e cila përcakton se: “menjëherë mbas hyrjes në fuqi të këtij vendimi Albgaz sh.a., aplikon në ERE për certifikim në bazë të neneve 37, 50, 59, 68, dhe 80 të ligjit nr. 102/2015”.

- Për qëllime të këtij aplikimi, Albgaz sh.a., ka depozituar në ERE, dokumentacionin e listuar sa më poshtë:

- Formularin ku identifikohen dokumentet e kërkuara në aktet nënligjore të ERE-s.

- Deklarata e administratorit të Albgaz sh.a. dhe Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse, sipas nenit 8 të rregullores së miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015, dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015.

- Ky aplikim është shoqëruar me dokumentacionin e parashikuar në nenin 8 dhe pjesën “Shtojca të rregullave”, miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015, dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015.

- Aplikuesi ka dhënë informacion të plotë mbi emrin e kompanisë, regjistrimin si person juridik, si dhe të dhënat në lidhje me identifikimin e tij si subjekt juridik pranë organeve tatimore (NUIS), të dhëna mbi kapitalin dhe aksionarin e vetëm të saj, vlerën nominale, të dhënat e kontaktit, adresa, përfaqësuesin e kompanisë në marrëdhëniet me të tretë etj. Referuar sa më sipër, rezulton i paraqitur në përputhje me rregulloren, informacioni i përgjithshëm i kërkuar.

- Referuar pikës II, në pjesën shtojca, aplikuesi ka plotësuar formularin e ndarjes së pronësisë (*Ownership Unbundling*).



Në bazë të neneve 37, 50, 59, 68, dhe 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, operatori i kombinuar ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga veprimtaritë e tjera në sektorin e gazit natyror, që nuk lidhen me operimin e sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes të impianteve të GNL-së dhe impianteve të depozitimit.

Për sa përcahtuar në pikën 3, të VKM-së nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të shoqërive të sektorit të gazit natyror”, tanimë rezulton aksionar i vetëm i Albgaz sh.a. me kapital 100% shtetëror MZHETS (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes).

Gjithashtu, në pikën 5 të VKM-së nr. 848, datë 7.12.2016, është përcaktuar se:

Autoriteti publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërisë Albpetrol sh.a. është Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

Në vijim, në pikën 6 të VKM-së nr. 848, datë 7.12.2016, është përcaktuar se:

“Ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes emërojnë anëtarët e këshillave mbikëqyrës të shoqërive të Albgaz sh.a. dhe Albpetrol sh.a. brenda tridhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi duke zbatuar kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

VKM-ja nr. 848, datë 7.12.2016, parashikon se fusha e të drejtave që Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka mbi shoqërinë Albgaz sh.a. shtrihet për aq sa përputhet me parashikimet e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” Albgaz sh.a. dhe fushën e saj të përgjegjesisë shtetërore.

Pra, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ushtron kontroll të drejtpërdrejtë në cilësinë e pronarit për Albgaz sh.a.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë ushtron kontroll të drejtpërdrejtë në cilësinë e pronarit për Albpetrol sh.a. Nga sa më sipër, si dhe duke qenë se aktivitetet e prodhimit dhe transmetimit të gazit natyror zhvillohen nga subjekte të organizuara në formën e shoqërive tregtare (shoqëri aksionare shtetërore), autoritetet e përmendura me lart, kryejnë funksionin e Asamblesë së Aksionarëve për shoqëritë respektive, duke marrë çdo vendim që ka në kompetencë Asambleja e Aksionarëve në një shoqëri anonime sipas parashikimeve të ligjit nr.

9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes janë dy organe të larta të administratës shtetërore të organizuara sipas ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Ligji nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” rregullon organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, nëpërmjet përcaktimit të kriterëve për krijimin dhe funksionimin e institucioneve shtetërore.

Në nenin 4, “Organet dhe institucionet e administratës shtetërore”, është përcaktuar se:

1. Kryeministri dhe ministrat janë organet e larta të administratës shtetërore. Ata drejtojnë dhe mbikëqyrin administratën shtetërore brenda fushës përkatëse të veprimtarisë shtetërore.

2. Administrata shtetërore përbëhet nga këto institucione:

a) Kryeministria;

b) Ministrinë;

c) institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave;

ç) njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve;

d) agjencitë autonome;

dh) administrata e prefektit.

Marrëdhëniet midis ministrive dhe Këshillit të Ministrave, përcaktohen në nenin 5, ministrinë si më poshtë:

1. Çdo ministri drejtohet dhe përfaqësohet nga ministri, në vazhdim ministri përgjegjës. Ministri është përgjegjës përpara Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit për tërësinë e veprimtarisë së ministrisë, institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome, më poshtë “sistem ministror”, brenda fushës përkatëse të veprimtarisë shtetërore.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, përcakton fushën e veprimtarisë shtetërore në përgjegjësinë e çdo ministrie, në vazhdim “fusha e përgjegjesisë shtetërore”.

3. Ministria kryen të gjitha funksionet administrative brenda fushës përkatëse të përgjegjesisë shtetërore, përveç atyre që u delegohen shprehimisht institucioneve të varësisë apo u ngarkohen me ligj agjencive autonome.





Pra, sa më sipër, secila prej ministrive kryen të gjitha funksionet administrative brenda fushës përkatëse të përgjegjësive shtetërore. Fusha përkatëse e përgjegjësive për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë është përcaktuar në vendimin nr. 833, datë 18.9.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë” dhe, konkretisht:

II. Ministria e Energjisë dhe Industrisë harton dhe zbaton politika që synojnë garantimin e furnizimit me energji të vendit, shfrytëzimin e burimeve energjetike e minerare në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe dobishmërisë publike, si dhe nxitjen e zhvillimit industrial me standarde sa më miqësore për mjedisin.

III. Ministria e Energjisë dhe Industrisë ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

1. Sektorin e gazit natyror;
2. Sektorin e hidrokarbureve (naftë dhe gaz);
3. Sektorin e minierave dhe gjeologjisë;
4. Sektorin e industrisë joushqimore.

Legjislacioni përkatës, në bazë të të cilit ushtron veprimtarinë e saj Ministria e Energjisë dhe Industrisë në sektorin e gazit natyror, është ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Konkretisht, roli i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë në raport me Albgaz sh.a. është i përcaktuar në nenet si më poshtë të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Në nenin 5 “Politikat e sektorit të gazit natyror”

1. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për politikat e përgjithshme të zhvillimit të sektorit të gazit natyror të Shqipërisë, në përputhje me politikat e zhvillimit ekonomik dhe sektorët e tjerë të vendit.

2. Ministria përgjegjëse për energjinë:

a) është institucioni përgjegjës për hartimin e politikave të zhvillimit të sektorit të gazit natyror;

b) harton dhe përditëson Strategjinë Kombëtare të Energjisë, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave;

c) grumbullon dhe përpunon të dhënat dhe informacionet mbi bilancin e energjisë në nivel kombëtar, përfshirë edhe sektorin e gazit.

Në kryerjen e përgjegjësive, sipas këtij ligji, ministria këshillohet me autoritetet e tjera

shtetërore të sektorit të energjisë, ERE-n, pjesëmarrësit në sektorin e gazit natyror, si dhe me grupet e interesit.

Ministria zhvillon politika dhe programe, për:

a) zbatimin e objektivave dhe të politikave energjetike në sektorin e gazit natyror;

b) nxitjen e investimeve në sektorin e gazit natyror, përfshirë edhe lehtësitë e mundshme fiskale;

c) marrjen e masave të mbrojtjes së mjedisit në sektorin e gazit natyror;

ç) garantimin e zhvillimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve e të instalimeve të tjera të infrastrukturës së gazit natyror;

d) harmonizimin me standardet dhe rregulloret e Bashkimit Evropian në këtë sektor dhe sigurimin e ndërveprimit të sistemeve të gazit natyror të Republikës së Shqipërisë me sistemet rajonale dhe ato evropiane;

dh) zhvillimin e programeve për mbrojtjen e klientëve në nevojë, në bashkëpunim me autoritetet dhe institucionet e tjera shtetërore;

e) sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm e të sigurt të sektorit të gazit natyror.

Ministri, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, jep certifikatat profesionale për specialistët që kryejnë veprimtari studimore-projektuese dhe zbatuese në fushat e përcaktuara me këtë ligj, si dhe në fushat e kërkimit, të prodhimit, të përpunimit, të transportimit, të depozitimit e të tregtimit të hidrokarbureve në tërësi. Për të ushtruar veprimtarinë studimore-projektuese, personat fizikë ose juridikë, duhet të pajisen me licencë në kategorinë IV.4.B, sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

Në nenin 6, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, “Siguria e furnizimit me gaz natyror”, parashikohet se:

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton planin e emergjencës, në të cilin përcaktohen standardet minimale të sigurisë së furnizimit me gaz natyror, si dhe rregullat për të garantuar furnizim të sigurt dhe të efektshëm. Plani i emergjencës, ndër të tjera, përmban:

a) instrumentet dhe masat që garantojnë në mënyrë të saktë e të qartë furnizimin e klientëve të mbrojtur, në rastet:



i) e një ndërprerjeje të pjesshme të furnizimit;  
 ii) e kushteve atmosferike ekstremisht të ftohta në periudhën e ngarkesës maksimale;

iii) kur ka kërkesë shumë të lartë për gaz gjatë periudhës më të ftohtë të dimrit;

b) programin për reduktimin ose ndërprerjen e furnizimit me gaz natyror të kategorive të veçanta të klientëve në rast krize;

c) rolin dhe përgjegjësitë e shoqërive të gazit natyror e të klientëve jofamiljarë, duke mbajtur parasysh shkallën, në të cilën ata mund të jenë dëmtuar nga një krizë e mundshme në sektorin e gazit natyror;

ç) kërkesat për impiantet e depozitimit, me qëllim realizimin e standardeve të sigurisë së furnizimit, si dhe kontributin e mundshëm të depozitës, kur kjo e fundit është në Shqipëri apo në ndonjë vend anëtar të Komunitetit të Energjisë;

d) masa dhe veprime të tjera, të cilat ndërmerren në mënyrë që të heqin ose të pakësojnë pasojat e ndërprerjes së furnizimit me gaz natyror, në varësi të shkallës së krizës.

2. Pjesëmarrësit në tregun e gazit natyror planifikojnë dhe marrin masat për një furnizim të sigurt me gaz natyror, në përputhje me standardet, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të këtij neni, si dhe janë përgjegjës për furnizimin me gaz natyror, brenda qëllimit të veprimtarisë.

3. ERE është autoriteti përgjegjës për monitorimin e sigurisë së furnizimit.

4. Plani i emergjencës nuk duhet të jetë diskriminues apo të parashikojë detyrime të paarsyeshme ndaj pjesëmarrësve ekzistues apo të rinj të tregut.

5. Plani i emergjencës i vihet në dispozicion Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

6. Kur vendi ka një nivel të përshtatshëm të interkoneksionit, ministria ose shoqëria përgjegjëse e gazit natyror mund të marrë masat e duhura në mënyrë që të arrihen standardet e sigurisë së furnizimit, duke përdorur impiantet e depozitimit të vendosura në territorin e palës tjetër kontraktuese. Për këtë qëllim, mund të bashkëpunohet me autoritetet dhe/ose shoqëritë e gazit natyror të një vendi të BE-së ose të një pale tjetër të Komunitetit të Energjisë, përfshirë këtu lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe. Aplikimi i këtyre masave nuk duhet të pengojë funksionimin normal të tregut vendës.

Në nenin 7, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, “Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e sigurisë së furnizimit”, parashikohet se:

Ministria është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e sigurisë së furnizimit me gaz natyror dhe, konkretisht për:

a) zbatimin e duhur të standardeve minimale të sigurisë së furnizimit, siç përcaktohet në nenin 6 të këtij ligji;

b) balancimin e kërkesës e të ofertës në tregun e gazit natyror të Shqipërisë;

c) kontratat afatgjata të furnizimit me gaz, të importuar nga vendet e treta;

ç) aftësinë paguese të mjaftueshme të furnizimit me gaz;

d) nivelin e gazit të përdorshëm dhe të kapacitetit të tërheqjes nga depozitat e gazit;

dh) nivelin e interkoneksioneve të sistemit të gazit natyror të Shqipërisë me sistemet fqinje të palëve të saj të Komunitetit të Energjisë;

e) nivelin e kërkesës në të ardhmen dhe nivelin e furnizimit të disponueshëm për situatën e parashikuar të furnizimit me gaz, në funksion të kërkesës, pavarësisë së ofertës dhe burimeve të furnizimit në dispozicion;

ë) kapacitetet shtesë të planifikuara ose në proces planifikimi;

f) cilësinë dhe nivelin e mirëmbajtjes së rrjeteve;

g) masat për të mbuluar kërkesën maksimale dhe mungesat e një ose më shumë furnizuesve.

2. Deri më 31 korrik të çdo viti, ministria, në bashkëpunim me ERE-n, përgatit dhe publikon një raport për rezultatet e monitorimit, në lidhje me çështjet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, si dhe masat e marra ose të parashikuara për trajtimin e tyre.

3. Raporti i përmendur në pikën 2, të këtij neni, përfshin çështjet e mëposhtme:

a) gjendja e konkurrencës në tregun e gazit natyror dhe ndikimi që krijon zbatimi i masave të marra në zbatim të nenit 6, të këtij ligji, për të gjithë pjesëmarrësit në tregun e gazit natyror;

b) nivelet e kapacitetit të depozitimit;

c) shtrirjen e kontratave afatgjata të furnizimit me gaz, të lidhura nga kompanitë e themeluara e të regjistruara në Shqipëri dhe, në veçanti, afatin e mbetur nga momenti i lidhjes së kontratave, bazuar në informacionin e siguruar nga kompanitë e përfshira, duke përjashtuar informacionin



konfidencial, shkallën e likuiditetit të tregut të gazit;

ç) kuadrin ligjor për të nxitur investime të reja në kërkimin, prodhimin, depozitimin, GNL-në dhe transportin e gazit, duke marrë parasysh nenin 78 të këtij ligji.

4. Raporti i përgatitur dhe i publikuar nga ministria i njoftohet Këshillit të Ministrave, si dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Në nenin 8, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, “Masat mbrojtëse për sigurinë e furnizimit”, parashikohet se:

Në rast të një krize të menjëhershme në tregun e energjisë ose kur siguria fizike e personave, pajisjeve a instalimeve apo e integritetit të sistemit kërcënohet, ministria, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse, merr masat mbrojtëse të përkohshme, të nevojshme. Këto masa duhet të jenë të kufizuara qartë dhe të jenë të aplikueshme për një periudhë të caktuar kohore, të nevojshme për të trajtuar situatën emergjente dhe për të zbutur pasojat që mund të vijnë prej saj.

2. Masat e marra në rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, aplikohen dhe koordinohen me planin e emergjencës, siç parashikohet në nenin 6, të këtij ligji, në mënyrë që të sjellin efekte negative sa më të vogla të mundshme për funksionimin e tregut të brendshëm dhe merren vetëm kur janë të nevojshme për shmangien e vështirësive të menjëhershme, që mund të jenë krijuar. Këto masa duhet të aplikohen në mënyrë të barabartë, transparente dhe jodiskriminuese. Ministri njofton menjëherë Këshillin e Ministrave dhe, kur e shihet të nevojshme, edhe vendet e tjera të Komunitetit të Energjisë, me të cilat ka marrëdhënie bashkëpunimi në sektorin e gazit natyror për masat mbrojtëse të marra sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Ministri, pa vonesë, njofton Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në lidhje me masat mbrojtëse të marra në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

5. Në rastet kur kriza në sektorin e gazit natyror nuk mund të menaxhohet në mënyrë të përshtatshme nëpërmjet masave kombëtare, ministri njofton kryetarin e grupit koordinues të sigurisë së furnizimit të Komunitetit të Energjisë, i cili mbledh menjëherë grupin *ad hoc* të koordinimit të sigurisë së furnizimit për shqyrtimin e situatës dhe, kur gjykohet e arsyeshme, mund të ndihmojë Shqipërinë dhe/ose palët e tjera të Komunitetit të

Energjisë, të përfshira në koordinimin e masave të marra në nivel kombëtar, për të përballuar situatën e krizës në sektorin e gazit natyror.

Në nenin 10, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, “Rregullat teknike dhe të sigurisë në sektorin e gazit natyror”, parashikohet se:

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat teknike dhe kriteret e sigurisë, ku përcaktohen kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit, të linjave direkte, si edhe çdo impianti ose instalimi tjetër që përfshihet në sektorin e gazit për operimin e sigurt të sistemeve.

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat teknike për kryerjen e operacioneve të depozitimit të gazit natyror në vendburimet hidrokarbure ose në hapësirat e tjera nëntokësore.

2. Deri në miratimin nga Këshilli i Ministrave të rregullave, sipas pikës 1, të këtij neni, ministri përcakton rregullat teknike, që do të zbatohen gjatë periudhës së ndërmjetme, të cilat duhet të jenë në përputhje me normativat e vendeve të Evropës.

3. Kontrolli i zbatimit dhe mbikëqyrja e rregullave teknike, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, kryhen nga inspektorati shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit natyror, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Subjektet, që ushtrojnë veprimtari, sipas dispozitave të këtij ligji, janë përgjegjëse për kryerjen e veprimtarive përkatëse, në përputhje me rregullat teknike, standardet, si edhe kushtet për mbrojtjen e mjedisit, të përcaktuara në këtë ligj, si edhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Në nenin 11, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, “Ndërtimi dhe përdorimi i tubacioneve dhe i infrastrukturës së gazit natyror”, parashikohet se:

1. Ndërtimi dhe përdorimi i tubacioneve për transmetimin e shpërndarjen e gazit natyror, instalimeve të GNL-së, depozitave të gazit natyror, linjave direkte, lidhjes së sistemit shqiptar të gazit natyror me sistemet fqinje, si edhe çdo impianti, pajisjeje ose instalimi tjetër që përfshihet në sektorin e gazit natyror, bëhen me miratim nga Këshilli i Ministrave. 12 2. Këshilli i Ministrave, me



propozimin e ministrit, miraton kushtet e procedurat për dhënien e miratimit për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së gazit natyror mbi baza transparente e jodiskriminuese. Marrëveshja e lidhur mes ministrisë dhe investitorit duhet të përfshijë të paktën kushtet si më poshtë:

- a) funksionimin e sigurt të sistemit të gazit;
- b) kushtet për përcaktimin e vendndodhjes dhe përdorimit të tokës;
- c) eficiencën e energjisë;
- ç) kushtet për përdorimin e burimeve parësore të energjisë;
- d) mbrojtjen në punë dhe sigurinë e njerëzve e të pasurisë;
- dh) mbrojtjen e mjedisit;
- e) aftësinë financiare të aplikantit për të përballuar ndërtimin e objektit të gazit natyror, e vërtetuar nga dokumente bankare ose dokumente të ngjashme që vërtetojnë aftësinë financiare të aplikantit;
- ë) kontributin e kapaciteteve për transport ose depozitim të gazit natyror për të rritur sigurinë e furnizimit;
- f) kushtet e përgjithshme të marrëveshjes që arrihet ndërmjet ministrisë përgjegjëse dhe investitorit, që do të ndërtojë dhe do të përdorë infrastrukturën e gazit;
- g) kushtet mbi llojin e dokumentacionit që provon marrëdhënien e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, ku është planifikuar ndërtimi i objektit të gazit natyror;
- gj) listën e dokumenteve të kërkuara për marrjen e miratimit;
- h) tarifat e aplikueshme për dhënien e miratimit për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve dhe infrastrukturës së gazit natyror;
- i) kushtet për refuzimin e miratimit.

3. Miratimi jepet për një afat deri në 30 vjet, me të drejtë përsëritjeje. Në rastet kur miratimi nuk përsëritet pas përfundimit të afatit të tij, infrastruktura do të çmontohet në përputhje me standardet mjedisore, të parashikuara nga ligji ose të drejtat e pronësisë mbi infrastrukturën do t'i transferohen shtetit apo një investitori tjetër, sipas kritereve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen e përcaktuar në pikën 2, shkronja “F”, të këtij neni. Vendimi i refuzimit për përsëritjen e miratimit duhet të arsyetohet. Në rast të transferimit të të drejtave të pronësisë ndaj shtetit,

marrëveshja ndërmjet palëve të përfshira duhet të përcaktojë afatet dhe kushtet për një transferim të tillë.

4. Këshilli i Ministrave, përveç rasteve të refuzimit, të përcaktuara në pikën 2, shkronja “I”, të këtij neni, me qëllim shfrytëzimin efikas të infrastrukturës së gazit, ka të drejtë të refuzojë dhënien e miratimit për ndërtimin dhe përdorimin e sistemit të tubacionit të shpërndarjes në një zonë të caktuar, në rast se për të njëjtën zonë është paraqitur më parë një propozim për investim ose nëse kapaciteti i infrastrukturës ekzistuese të gazit në atë zonë mbulon kapacitetin e kërkuar.

5. Refuzimi për dhënien e një miratimi, si dhe për përsëritjen e miratimit, mund të ankimohet nga kërkuesi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Miratimi i dhënë, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk përjashton marrjen e autorizimeve, lejeve, deklaratave, licencave apo autorizimeve të tjera, të cilat mund të kërkojnë sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për ndërtimin e infrastrukturës së gazit, të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, si dhe mbrojtjen e mjedisit e respektimin e rregullave teknike e të sigurisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Modifikimi i miratimit të dhënë bëhet me kërkesë të mbajtësit të miratimit, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. Modifikimet e miratimit nuk duhet të ndryshojnë objektin për të cilin është dhënë ky miratim.

8. Miratimi i dhënë sipas këtij neni nuk transferohet.

Në nenin 46, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, “Zhvillimi i rrjetit dhe vendimet e investimeve”, parashikohet se:

1. Operatori i kombinuar, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, paraqet në ERE një plan dhjetëvjeçar zhvillimi të rrjetit të transmetimit, në bazë të kërkesës e të ofertës, i cili rishikohet deri më 31 tetor të çdo viti, pasi të jetë konsultuar me të gjitha palët e interesuara dhe të jenë mbajtur parasysh parashikimi ekzistues dhe i planifikuar i kërkesë-ofertës. Plani i zhvillimit të rrjetit të transmetimit përmban masa efektive, në mënyrë që të garantojë përshtatshmërinë e rrjetit dhe sigurinë e furnizimit.

2. Plani i zhvillimit të rrjetit duhet:

a) të marrë në konsideratë informacionin për pjesëmarrësit e tregut të gazit natyror, si dhe informacionet për infrastrukturën kryesore të



transmetimit që duhet të ndërtohet ose të përmirësohet gjatë 10 viteve të ardhshme;

b) të përmbajë të dhëna për të gjitha investimet e miratuara dhe të identifikojë investimet e reja, të cilat duhet të ekzekutohen në tri vitet e ardhshme;

c) të përcaktojë një afat kohor për të gjitha projektet e investimeve.

3. Në hartimin e planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit, Albgaz sh.a. bën parashikime në lidhje me prodhimin, furnizimin, konsumin dhe shkëmbimin e gazit natyror me vendet e tjera, duke marrë parasysh planet e investimeve për rrjetet në vendet përreth, si dhe planet e investimeve për impiantet e depozitimit dhe rigazifikimit të GNL-së.

4. ERE konsultohet në mënyrë të hapur dhe transparente me të gjithë përdoruesit aktualë apo të mundshëm të sistemit lidhur me planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit. ERE boton rezultatin e procesit të konsultimit, veçanërisht nevojat e mundshme për investime.

5. ERE shqyrton planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit dhe, në rast se vëren se nuk janë përmbushur të gjitha nevojat e zhvillimit për investime të identifikuara gjatë procesit të konsultimit, kërkon nga operatori i kombinuar të plotësojë dhe/ose të ndryshojë planin e tij dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit.

6. ERE miraton, monitoron, si dhe vlerëson zbatimin e planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit.

7. Kur ERE konstaton se operatori i kombinuar nuk ka realizuar për tri vite një investim të parashikuar, sipas planit dhjetëvjeçar, dhe gjykon se investimi është i nevojshëm e mund të financohet pa penguar operimin normal të rrjetit, i kërkon atij të marrë një nga këto masa:

a) të realizojë investimin në fjalë;

b) të organizojë një procedurë konkurruese për realizimin e investimit në fjalë, të hapur ndaj çdo investitori;

c) të pranojë rritjen e kapitalit, me qëllim financimin e investimeve të nevojshme dhe të lejojë investitorët e pavarur për të marrë pjesë në kapitalin e shoqërisë.

8. Kur ERE merr masa, sipas shkronjës “b”, të pikës 7, të këtij neni, mund ta detyrojë Operatorin e Sistemit të Transmetimit të zbatojë një ose më shumë nga alternativat e mëposhtme:

a) të sigurojë financimin nga ndonjë palë e tretë;

b) të kërkojë ndërtimin nga ndonjë palë e tretë;

c) të ndërtojë vetë asetet e reja përkatëse brenda një afati të arsyeshëm;

ç) t'i operojë asetet e reja pas ndërtimit.

9. Albgaz sh.a. u siguron investitorëve të gjitha informacionet e nevojshme për të realizuar investimet dhe bën përpjekjet maksimale për të lehtësuar zbatimin e projektit të investimit. Marrëveshjet përkatëse financiare do t'i nënshtrohen miratimit nga ERE.

10. ERE, në ushtrimin e kompetencave të saj, sipas pikave 7 dhe 8, të këtij neni, merr mendimin nga ministria përgjegjëse për energjinë.

11. ERE merr masa që kostot e investimeve të mbulohen nga tarifat përkatëse dhe që investimet e përfunduara të merren në konsideratë gjatë miratimit të tarifave të vitit pasardhës.

12. ERE harton dhe miraton një rregullore për procedurat e paraqitjes e të miratimit të planeve të investimit.

Së fundmi, në nenin 84, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, “Tregu i gazit natyror”, parashikohet se:

Tregu i gazit natyror përfshin tregun me pakicë dhe tregun me shumicë të tij.

2. Marrëdhëniet ndërmjet klientëve fundorë dhe furnizuesve të tyre organizohen në tregun me pakicë të gazit natyror.

3. Tregu me shumicë i gazit natyror përfshin:

a) marrëveshjet dypalëshe të gazit natyror, me përjashtim të marrëveshjeve të lidhura ndërmjet palëve, sipas pikës 2, të këtij neni;

b) tregun e ditës së nesërme, për livrimin e gazit natyror;

c) balancimin e tregut të gazit natyror.

4. Shitjet dhe blerjet në tregun me shumicë të gazit natyror kontrahohen sipas marrëveshjeve dypalëshe, si edhe në tregjet e organizuara të gazit natyror, që janë tregje të gazit natyror të ditës së nesërme, për dorëzimin e sasisë së gazit natyror dhe të balancimit të tregut të tij.

5. Albgaz sh.a. siguron shërbimet balancuese, në përputhje me rregullat e balancimit, të cilat miratohen nga ERE.

6. Rregullat e balancimit përcaktojnë detyrimet dhe kushtet në lidhje me balancimin, përfshirë rregullat për ofruesit e shërbimeve të balancimit, prokurimin e shërbimeve balancuese dhe përcaktimin e sasive e kritereve financiare të rakorduara me ofruesit e shërbimeve të balancimit.



7. Albgaz sh.a. bashkëpunon me operatorët e sistemit të transmetimit të vendeve të tjera për lehtësimin e tregut balancues në nivel rajonal, për të garantuar sigurinë operationale dhe funksionimin efikas të balancimit të tregut, bazuar në konkurrencën efektive, mosdiskriminimin dhe transparencën.

Fusha përkatëse e përgjegjësisë së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është përcaktuar në vendimin nr. 835, datë 18.9.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”, të ndryshuar.

Për sa i përket rolit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në raport me Albgaz sh.a., shpjegojmë si më poshtë:

Rezulton se Albgaz sh.a. është e organizuar në formën e një shoqërie aksionare me kapital 100% shtetëror. Kjo gjë është në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ku në nenin 80 është përcaktuar se:

Operator i kombinuar konsiderohet kur e njëjta shoqëri e gazit natyror mund të licencohet për të kryer veprimtarinë e transmetimit, shpërndarjes, operatorit të impianteve të GNL-së dhe/ose të impianteve të depozitimit, me kusht që të respektojë kërkesat për ndarjen për çdo operator sistemi, sikurse parashikohet nga ky ligj, dhe të jetë i pavarur nga shoqëritë që kryejnë ndonjë nga funksionet e prodhimit, furnizimit apo tregtimit.

3. Operatori i kombinuar i sistemit, që përfaqëson një pjesë të një shoqërie vertikalisht të integruar, organizon veprimtaritë e tij si person juridik i pavarur, i ndarë nga veprimtaritë e prodhimit, tregtimit dhe furnizimit me gaz.

Këshilli i Ministrave përcakton autoritetin publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të operatorit të kombinuar, i cili duhet të jetë i pavarur nga aktivitetet e prodhimit apo të furnizimit, në kuptim të nenit 80 të ligjit.

Në zbatim të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” është miratuar VKM-ja nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Albpetrol sh.a. dhe Albgaz sh.a.”, e cila ka përcaktuar si më poshtë:

Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Albpetrol sh.a. është Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Albgaz sh.a. është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministri i Energjisë dhe Industrisë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndjekin procedurat e nevojshme, për:

a) regjistrimin e zvogëlimit të kapitalit të shoqërisë Albpetrol sh.a., transferimin e vlerës së kapitalit të zvogëluar te shoqëria Albgaz sh.a., si dhe përmbylljen e procedurave për regjistrimin e shoqërisë Albgaz sh.a., në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

b) emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërive Albgaz sh.a. dhe Albpetrol sh.a., duke respektuar kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

- Po kështu, në nenin 1, të ligjit nr. 08/2016, “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, është përcaktuar se:

Ushtrimi i së drejtës së përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, përfshirë edhe të drejtën e emërimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës, në shoqëritë elektroenergjetike, bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Në lidhje me këtë shqetësim të Sekretariatit, ERE shtjellon se për sa i takon rolit të Këshillit të Ministrave dhe të Kryeministrit në raport me Ministrinë e Ekonomisë dhe Energetikës, si dhe marrëdhëniet e Kryeministrit me ministrinë, këto elemente janë përcaktuar në ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i cili rregullon organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave. Ky ligj përcakton kriteret për krijimin dhe funksionimin e institucioneve shtetërore.

Në nenin 4, të këtij ligji, të titulluar “Organet dhe institucionet e administratës shtetërore”, përcaktohet se:



1. Kryeministri dhe ministrat janë organet e larta të administratës shtetërore. Ata drejtojnë dhe mbikëqyrin administratën shtetërore brenda fushës përkatëse të veprimtarisë shtetërore.

2. Administrata shtetërore përbëhet nga këto institucione:

- a) Kryeministria;
- b) Ministrinë;
- c) Institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave;
- ç) Njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve;
- d) Agjencitë autonome;
- dh) Administrata e prefektit.

3. Ministrinë dhe institucionet e varësisë mund të kenë degë territoriale në përputhje me këtë ligj.

Ndërkohë që përgjegjësitë e Kryeministrit janë të përcaktuara në nenin 102 të Kushtetutës. Konkretisht, neni 102 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcakton se Kryeministri ka këto përgjegjësi:

- a) Përfaqëson Këshillin e Ministrave dhe kryeson mbledhjet e tij;
- b) Koncepton dhe paraqet drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për to;
- c) Siguron zbatimin e legjislacionit dhe të politikave të miratuara nga Këshilli i Ministrave;
- d) Koordinon dhe kontrollon punën e anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe të institucioneve të tjera të administratës qendrore të shtetit;
- e) Kryen detyra të tjera të parashikuara në Kushtetutë e në ligje.

2. Kryeministri zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet ministrave.

3. Kryeministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra.

4. Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij, veprimet për të cilat ai ka kompetenca. Ministri, në ushtrimin e kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime.

Sipas dispozitave të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të përmendura më lart, nuk vërehet asnjë boshllëk ligjor në rolin e Kryeministrit që do t’i lejonte atij për të ndikuar në autoritetin e ministrave të tjera.

Nga ana tjetër, marrëdhëniet midis ministrave dhe Këshillit të Ministrave përcaktohen në nenin 5

të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”. Ky nen përcakton se:

1. Çdo ministri drejtohet dhe përfaqësohet nga ministri, në vazhdim “ministri përgjegjës”. Ministri është përgjegjës përpara Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit për tërësinë e veprimtarisë së ministrisë, institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome, më poshtë “sistem ministror”, brenda fushës përkatëse të veprimtarisë shtetërore.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, përcakton fushën e veprimtarisë shtetërore në përgjegjësinë e çdo ministrie, në vazhdim “fusha e përgjegjësisë shtetërore”.

3. Ministria kryen të gjitha funksionet administrative brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, përveç atyre që u delegohen shprehimisht institucioneve të varësisë apo u ngarkohen me ligj agjencive autonome.

4. Ministria është, gjithashtu, përgjegjëse për koordinimin dhe, në bazë të delegimit të ministrit, për mbikëqyrjen e veprimtarisë së institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë ministrore.

5. Organizimi i ministrisë përfshin aparatit e ministrisë, si dhe degët e saj territoriale, nëse është rasti.

Siç shihet nga këto dispozita, ministri është përgjegjës përpara Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit për aktivitetin e ministrisë, institucionet nën administrimin e tij dhe agjencitë autonome brenda zonës përkatëse të veprimtarisë shtetërore.

Ndërkohë, sa i takon fushës së përgjegjësisë së ministrit, është Këshilli i Ministrave, i cili me propozimin e Kryeministrit përcakton fushën e veprimtarisë shtetërore nën përgjegjësinë e çdo ministrie ose, siç quhet ndryshe “fusha e përgjegjësisë shtetërore”. Në këtë mënyrë, çdo ministri kryen të gjitha funksionet administrative në fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, përveç atyre që u delegohen shprehimisht institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë ministrore.

Nga gjithçka u përmend më lart, konkludohet se çdo ministri kryen funksionet administrative në fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore.

Ndërkohë, për sa i takon rolit të Këshillit të Ministrave në lidhje me Operatorin e Sistemit të Transmetimit po u referohemi dispozitave të ligjit.



Fillimisht, referuar nenit 5 të këtij ligji, ku përcaktohet se: “Këshilli i Ministrave është përgjegjës për politikat e përgjithshme të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Republikën e Shqipërisë, si dhe për përcaktimin e stimujve që aplikohen ndaj operatorëve të sektorit të gazit natyror, në përputhje me politikat e zhvillimit ekonomik dhe sektorët e tjerë të vendit.

Gjithashtu, në nenin 1 të ligjit nr. 08/2016, “Për një shtesë dhe një ndryshim në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e kompanive shtetërore”, të ndryshuar, përcaktohen shprehimisht se:

Ushtrimi i së drejtës së përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, përfshirë edhe të drejtën e emërimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës, në shoqëritë elektroenergjetike, bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe në shoqëritë e gazit natyror bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Pra, nga të gjitha dispozitat që janë parashtruar më sipër, vërehet që secila nga ministrinë e përmendura, do të kryejë funksionin e pronarit të aksioneve në kompanitë përkatëse.

Siç e theksuam më lart, është Këshilli i Ministrave, i cili me propozimin e Kryeministrit, përcakton zonën e veprimtarisë shtetërore nën përgjegjësinë e çdo ministrie, pra “zonën e administratës shtetërore”. Ndërkohë që ministria kryen funksionet administrative në fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, me përjashtim të atyre të deleguara për institucionet vartëse ose që janë të ngarkuar me ligj për agjencitë autonome. Nga ana tjetër, raporti i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes, dhe Ministrisë së Financave, duhet të trajtohet nën përgjegjësinë e “administrimit shtetëror”, që u është dhënë organeve përkatëse administrative.

Në bazë të nenit 41, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, “Të drejtat dhe përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit”, janë përcaktuar në mënyrë të qartë dhe si të tilla të gjitha operacionet e OST-së do të bëhen nën kufizimin e këtij ligji.

Gjejmë me vend të rihesojmë, se neni 35 i këtij ligji përcakton se Operatori i Sistemit të Transmetimit do të jetë një person juridik i licencuar nga ERE për të kryer veprimtarinë e vepron si një sistem i transmetimit të gazit natyror, i cili zotëron

sistemin e transmetimit dhe që respekton kriteret e pavarësisë sipas nenit 36 të këtij ligji.

Po kështu, vlen të përmendet, se roli i Këshillit të Ministrave për sa u përket planeve të investimeve të OST sh.a., është i kufizuar në kompetencën e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të miratimit të linjave të reja të interkoneksionit. ERE, në miratimin e zhvillimit të planit dhjetëvjeçar do të marrë në konsideratë vendimin e mundshëm të Këshillit të Ministrave në lidhje me këtë çështje.

Për efekt të vlerësimit të autonomisë ligjore dhe funksionale të ministrit, mund të konsiderohen aspektet praktike që kanë të bëjnë me procedurën e emërimit dhe të shkarkimit të një ministri, si dhe me anë të një analize të vendimmarrjeve të një ministri.

Për qëllime të kësaj analize të mëtejshme, është marrë në konsideratë dokumentacioni ligjor i mëposhtëm:

i) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (më tej “Kushtetuta”);

ii) Ligji nr. 90/2012, datë 27.9.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së shtetit” (më tej “Ligji për administratën shtetërore”);

iii) Ligji nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” (më tej “Ligji i Këshillit të Ministrave”);

iv) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 833, datë 18.9.2013, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë”, i ndryshuar (më tej “VKM-ja nr. 833”);

v) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 835, datë 18.9.2013, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”, i ndryshuar (tani e tutje “VKM-ja nr. 835”); si edhe

vi) Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë.

Sa i takon procedurës dhe mënyrës se si ministri emërohet në detyrë dhe procedurën përmes së cilës ai lirohet nga detyra vërehet se: neni 98 i Kushtetutës parashikon se një ministër, “emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit, brenda 7 ditëve.





Dekreti shqyrtohet nga Kuvendi brenda 10 ditëve”.

Kjo dispozitë përcakton qartë, se në procesin e emërimit dhe shkarkimit të ministrit do të marrin pjesë tri trupa vendimmarrëse: a) Kryeministri; b) Presidenti i Republikës; dhe c) Kuvendi. Në mënyrë të veçantë, vërehet se ministri “emërohet dhe shkarkohet” nga Presidenti i Republikës, por propozimi duhet të vijë nga Kryeministri, i cili mund në çdo kohë të ndërmarrë nisma për emërimin, si dhe shkarkimin e një ministri. Megjithatë, duhet theksuar se Kuvendi luan një rol të rëndësishëm në këtë proces, për shkak se “dekretet” e Presidentit duhet të shqyrtohen nga Kuvendi brenda 10 ditëve.

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, me vendimin e saj nr. 6, datë 18.1.2002 ka analizuar dhe ka shprehur mendimin e saj pikërisht në lidhje me konceptin për procesin e “rishikimit” që i takon Kuvendit. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese deklaroi se me fjalën “shqyrtim”, në bazë të nenit 98, paragrafi 2 të Kushtetutës, është kuptuar drejt dhe është detyrë e Kuvendit për të diskutuar dhe debatuar dekretin e Presidentit, dhe për të marrë një vendim në lidhje me miratimin e tij ose mosmiratimin e tij. Rishikimi i dekretit të Presidentit të Republikës, të lëshuar në përputhje me paragrafin 2, të nenit 98, të Kushtetutës, nuk është i kufizuar në një rishikim formal, por në një shqyrtim thelbësor.

Kjo do të thotë se në një Republikë Parlamentare, është Kuvendi që në fund të fundit vendos me votë për emërimin ose shkarkimin e ministrit. Për më tepër, në këtë vendim Gjykata Kushtetuese ka analizuar natyrën e dekretit të Presidentit të Republikës në lidhje me emërimin ose shkarkimin e ministrit, efektin ligjor dhe kushtet e nevojshme për hyrjen në fuqi apo revokimin e saj. Nga kjo analizë, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se dekreti presidencial, “si një akt individual i lëshuar nga organi kompetent, hyn në fuqi ose shfuqizohet pasi Kuvendi merr vendim për miratimin e tij ose mosmiratimit në fund të procesit të shqyrtimit”.

Kështu, edhe pse Kryeministri ka iniciativën për të emëruar ose për të shkarkuar një ministër dhe e bën një propozim të tillë për Presidentin, është Presidenti i cili vlerëson një propozim të tillë, ndërsa efekti ligjor i dekretit si i tillë fillon vetëm pas shqyrtimit të Kuvendit të shprehur nëpërmjet votës së tij.

Prandaj, vërehet se, në praktikë ekzistojnë kufizime në pushtetin diskrecional të Kryeministrit për të emëruar apo për të shkarkuar një ministër. Nisma e Kryeministrit nuk është e mjaftueshme, pasi Kushtetuta kërkon nxjerrjen e një dekreti nga Presidenti dhe votimin në favor të tij nga Kuvendi.

Megjithatë, një vështrim i historisë politike të demokracisë në Shqipëri, tregon se situatat e “bllokimit kushtetues” mund të ndodhë shumë rrallë. Edhe në ato raste kur emërimi është propozuar nga një Kryeministër që i përket një partie politike që është e kundërt me partinë e Presidentit, Presidenti i Republikës nuk ka refuzuar deri më tani të miratojë propozimet e tij. Në anën tjetër, në mënyrë që propozimi i Kryeministrit dhe dekreti presidencial për emërimin apo shkarkimin, të refuzohet në Kuvend, duhet të gjendemi në kushtet e konfliktit me vullnetin e mazhorancës qeverisëse dhe Kuvendit.

Por, duke pasur parasysh se Kryeministri emërohet nga shumica qeverisëse, një situatë e tillë në praktikë është shumë e rrallë dhe mund të shfaqet në rastet kur shkarkimi prek një ministër të veçantë që gëzon një mbështetje të gjerë në Kuvend ose një ministër që i takon një partie në koalicionin qeverisës, pa votat e të cilit dekreti i shkarkimit të saj nuk mund të aprovohen.

Në historinë postkomuniste të Shqipërisë, një rast i ngjashëm ka ndodhur vetëm në vitin 2002. Në atë kohë, për shkak të konflikteve brenda mazhorancës, Kuvendi ka tejkalluar afatin kohor prej 10 ditësh, të përcaktuar nga Kushtetuta, duke refuzuar të shqyrtojë për një kohë të gjatë dekretet presidenciale të emërimit të disa ministrave të rinj. Ndërsa kjo krizë politike priste të zgjidhej politikisht, vendi u qeveris për disa muaj rresht nga zëvendësministrat përkatës.

Megjithatë, për të vlerësuar shkallën e autonomisë së një ministri, përveç procedurës dhe mënyrës së emërimit dhe shkarkimit të ministrit, janë analizuar edhe kompetencat e ministrit dhe autoriteti i tij vendimmarrës.

Siç dihet është Kushtetuta e Shqipërisë që përcakton përgjegjësitë e Këshillit të Ministrave dhe Kryeministrit. Neni 100 i Kushtetutës thotë se “Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore”. Për më tepër, neni 95, paragrafi 2 parashikon për Këshillin e Ministrave një vendimmarrje të gjerë dhe diskrecionale autoriteti. Kështu, Kushtetuta



përcakton se: “Këshilli i Ministrave ushtron çdo funksion shtetëror, i cili nuk u është dhënë organeve të tjera të pushtetit shtetëror ose të qeverisjes vendore”.

Në të njëjtën kohë, Këshilli i Ministrave është organ kolegjal i cili përfaqësohet dhe kryesohet nga Kryeministri, i cili, sipas paragrafit 1, të nenit 102 të Kushtetutës: “Koncepton dhe paraqet drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për ato; siguron zbatimin e legjislacionit dhe të politikave të miratuara nga Këshilli i Ministrave; bashkërendon dhe kontrollon punën e anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe institucionet e tjera të administratës qendrore të shtetit”. Për më tepër, Kryeministri ka autoritetin për të “zgjdhur mosmarrëveshjet ndërmjet ministrave”.

Roli i ministrit është përcaktuar në paragrafin 4, të nenit 102 të Kushtetutës, duke qenë kështu i mirëpërcaktuar në lidhje me rolin e Këshillit të Ministrave dhe Kryeministrit. Sipas kësaj dispozite, “ministri, brenda drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë. Ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime”. Pra, siç mund të shihet nga dispozitat e mësipërme, Kushtetuta ka vendosur Këshillin e Ministrave në pozicionin më të lartë ekzekutiv. Megjithatë është, gjithashtu, e qartë dhe e padiskutueshme se Kryeministri ka një rol qendror ekzekutiv, i cili ushtrohet edhe nëpërmjet formulimit të politikave të qeverisë që janë objekt i miratimit në Këshillin e Ministrave.

Megjithatë, përveç sa është përcaktuar në Kushtetutë, në funksion të vlerësimit të pavarësisë së vendimarrjeve të një ministri, kjo pavarësi duhet analizuar edhe në kuadër të fushës së përgjegjësisë së ministrisë që ai drejton.

Kështu, neni 4 i ligjit “Për administratën shtetërore”, përcakton se “Kryeministri dhe ministrat janë organet më të larta të administratës shtetërore. Ata drejtojnë dhe mbikëqyrin administratën shtetërore brenda fushës përkatëse të veprimtarisë shtetërore”. Ndërkohë që, neni 3(5) thekson “parimin e ndarjes së qartë në përcaktimin e përgjegjësitë”, në mënyrë që ndarja dhe caktimi i funksioneve administrative dhe detyrave, ndërmjet organeve, institucioneve dhe njësisë administrative të jenë transparente dhe të bëhen publike.

Në bazë të nenit 5 të këtij ligji, është Këshilli i Ministrave që me propozimin e Kryeministrit përcakton fushën e veprimtarisë shtetërore e përgjegjësitë e çdo ministrie. Më tej, në këtë ligj përcaktohet se “çdo ministri drejtohet dhe përfaqësohet nga ministri, i cili është përgjegjës para Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit për tërësinë e veprimtarisë së Ministrisë”. Po kështu, në nenin 22 të këtij ligji theksohet edhe një herë se çdo ministër është përgjegjës për mbikëqyrjen e aktivitetit të ministrisë, institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore.

Nga përmbledhja e mësipërme vërehet një ndarje e qartë e kuadrit ligjor të hierarkisë dhe përgjegjësisë të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave dhe Ministrave.

Konkretisht, Kryeministri propozon fushën e veprimtarisë, kompetencat dhe përgjegjësitë për një ministri në përputhje me vizionin e tij për politikën e përgjithshme të shtetit. Megjithatë, propozimi i Kryeministrit duhet të shqyrtohet dhe të vendoset nga Këshilli i Ministrave. Kjo do të thotë se fusha e përgjegjësisë së çdo ministri, nuk përcaktohet vetëm nga Kryeministri, por në fund të fundit përcaktohet nga një organ kolegjal, i tillë si Këshilli i Ministrave, i cili vendos me shumicën e votave të anëtarëve, duke njohur të drejtën e ministrave për të shprehur mendimet e tyre dhe për të votuar. Pasi fusha e përgjegjësisë miratohet nga Këshilli i Ministrave, drejtimi dhe përfaqësimi i ministrisë si institucion bëhet vetëm nga ministri përgjegjës.

Përveç ligjit për administratën shtetërore, është e rëndësishme të analizohet edhe ligji i Këshillit të Ministrave, i cili siguron organizimin dhe funksionimin e këtij organi ekzekutiv.

Ligji për Këshillin e Ministrave, sipas nenit 1 të tij, rregullon organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, Kryeministrit, zëvendës-kryeministrit, ministrit, [...], marrëdhëniet e tyre dypalëshe, si dhe e aktet nënligjore. Ky ligj në mënyrë të ngjashme me ligjin për administratën Shtetërore, parashikon se Kryeministri, ministri dhe Këshilli i Ministrave janë organe të ndara dhe të dallueshme nga njëri-tjetri.

Ndërkohë që detyrat e Kryeministrit janë të listuara në nenin 2 të këtij ligji. Sipas këtij ligji, Kryeministri: a) përfaqëson dhe udhëheq kryeministrinë; b) kërkon raporte shpjegime dhe verifikime administrative nga ministrat përgjegjës



për çështjet që ata mbulojnë; c) me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, Kryeministri pezullon zbatimin e akteve të ministrave, drejtuesve të institucionit qendror nën mbikëqyrjen e tij ose të ministrave, kur konstaton shkelje të Kushtetutës, ligjeve, ose të akteve të Këshillit të Ministrave.

Kjo dispozitë përcakton si kompetencë të Kryeministrit, mundësinë që ai mund t'u kërkojë shpjegime ministrave, si dhe mundësinë për të pezulluar zbatimin e akteve të ministrave, kur ka shkelje ligjore. Vlen të theksohet, se Kryeministrit nuk i është njohur në mënyrë eksplicite e drejta për të ndryshuar, të hequr, revokuar ose shfuqizuar një akt të ministrit, por e drejta e pezullimit të aktit të ministrit nga ana e Kryeministrit është megjithatë një e drejtë e rëndësishme që e siguron atë me kompetencën për të ndikuar në veprimtarinë e një ministri.

Gjithashtu vlen të theksohet se pezullimi në vetvete është një ndërprerje e përkohshme e efekteve juridike të një akti, i cili pas pezullimit do të vazhdojë të prodhojë të gjitha efektet ndërsa revokimi i një akti do të thotë ndërprerje e efekteve ligjore, që si të tillë do të thotë një kompetencë më e madhe që ligji nuk ia ka atribuar Kryeministrit. Po kështu, duhet thënë se pezullimi i një akti të një ministri, duhet të bazohet në konstatimin se akti në fjalë ka shkaktuar shkelje të Kushtetutës, ligjeve dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave, që do të thotë se pezullimi i një akti të ministrit mbetet relativisht i kufizuar.

Në përfundim të kësaj analize konkludohet se:

1. Në lidhje me emërimin dhe shkarkimin e ministrit, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, parashikon një procedurë, e cila kërkon jo vetëm iniciativën e Kryeministrit, por edhe marrëveshjen e Presidentit dhe votën miratuese të Kuvendit. Një procedurë e tillë, në teori jep një garanci për ministrin në lidhje me stabilitetin e tij në ushtrimin e detyrës, në rast konflikti me Kryeministrin.

2. Kushtetuta u ka dhënë edhe ministrave një shkallë autonomie në marrjen e vendimeve në proceset vendimarrëse për çështjet nën përgjegjësinë e tyre dhe që ndërmerren në kuadër të politikave të brendshme shtetërore të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

3. Pamundësia ligjore e Kryeministrit për të shfuqizuar një akt të ministrit rezulton edhe nga dispozitat e ligjit për Këshillin e Ministrave, i cili i

atribuon Kryeministrit vetëm të drejtën për të pezulluar një akt të një ministri, nëse ministri vepron në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e vendit.

4. Nga analizat dhe përfundimet e mësipërme, vlerësohet se kuadri kushtetues dhe ligjor në Shqipëri, lejon një nivel të caktuar të autonomisë për ministrat gjatë ushtrimit të detyrave dhe kompetencave të tyre.

5. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh rolin politik të lidhshimit të Kryeministrit në formimin e Këshillit të Ministrave, fuqia e tij në formimin e përgjithshëm të politikave të përgjithshme, e drejta e tij për të pezulluar përkohësisht një akt të një ministri dhe autoritetin për të zgjidhur mosmarrëveshjet ndërmjet ministrave, dhe duke e krahasuar atë me përvojën aktuale të politikës në Shqipëri, konsiderohet se do të ishte e pazakontë që në një rast të natyrës teknike të çojë në një konflikt në mes të një ministri dhe Kryeministrit, në rast se ky i fundit do të shprehë vullnetin për të rregulluar në një formë specifike një çështje, e cila është objekt i diskutimit.

Përveç sa më sipër, duhet të theksojmë se niveli aktual i autonomisë së aktiviteteve të një ministri nga autoriteti i Kryeministrit varet nga një seri faktorësh të tjerë, të tilla si niveli i demokracisë në vend, shkalla e demokracisë brenda partive politike, shkalla e kontrollit dhe autoritetit që ushtron Kryeministri ndaj ministrave të tij, rrugën politike e të karrierës, peshën dhe rëndësinë politike të një ministri, si dhe emancipimi i shoqërisë në përgjithësi.

Pra, nga përcaktimet e përmendura këtu më lart, rezulton se secila nga ministratë e përmendura duhet të kryejnë funksionin e pronarit të aksioneve në shoqëritë përkatëse. Përpara këtij ndryshimi, ishte Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ajo që ushtronte funksionin e pronarit të aksioneve (autoritetin publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve) në të tria aktivitetet e shoqërisë Albpetrol sh.a.

Për më tepër sqarojmë se organizimi i tërë veprimtarisë ekonomike në Shqipëri rregullohet nga ligji nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Ky ligj përcakton dhe rregullon statusin e tregtarit, themelimin dhe administrimin e shoqërive tregtare, të drejtat dhe detyrimet e themeluesve, të ortakëve dhe aksionarëve,



riorganizimin dhe likuidimin e shoqërive tregtare. Ky ligj është i detyrueshëm edhe për shoqëritë shtetërore.

Albgaz sh.a. në këndvështrimin e organizimit juridik i është nënshtruar ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Pra, me konkretisht, roli i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve, në raport me Albgaz sh.a. është ai i pronarit të 100% të aksioneve. Kjo ministri sillet ndaj shoqërisë Albgaz sh.a. dhe ushtron ato të drejta dhe ka ato detyrime njëjloj si çdo pronar tjetër privat sillet ndaj aksioneve që ka në një shoqëri aksionare që në Shqipëri është ndërtuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Pra, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes luan rolin e aksionarit të vetëm duke marrë çdo vendim që ka në kompetencë Asambleja e Përgjithshme në një shoqëri aksionare, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

Këtë rol për Albpetyl sh.a. në bazë të nenit 5, të VKM-së nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Albpetyl sh.a. dhe Albgaz sh.a.”, e luan Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

Rezulton tashmë se Albpetyl sh.a. dhe Albgaz sh.a. kanë kryer të gjitha procedurat për përmbushjen e këtij detyrimi, duke përmbushur në këtë mënyrë dhe detyrimin e pavarësisë së Albgaz sh.a., nga aktivitetet e prodhimit apo të furnizimit, në kuptim të nenit 36, të ligjit 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Për sa i përket Këshillit Mbikëqyrës, në nenin 135, “Të drejtat dhe detyrimet”, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, është përcaktuar se:

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshime të statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit (sistemi me një nivel) dhe (në sistemin me dy nivele) të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

Në statutin e Albgaz sh.a. (neni 17 i Këshillit Mbikëqyrës) është përcaktuar, se:

Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Pra Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes emëron anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Albgaz sh.a. Rezulton se Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të Albgaz sh.a. dhe në zbatim të pikës 6(b), të VKM-së nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Albpetyl sh.a. dhe Albgaz sh.a.” në të cilën është përcaktuar se:

Ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, emërojnë anëtarët e këshillave mbikëqyrës të shoqërive Albpetyl sh.a. dhe Albgaz sh.a., duke zbatuar kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ka miratuar me vendimin nr. 56, datë 5.1.2017, Këshillin Mbikëqyrës të Albgaz sh.a.

Po kështu, Ministria e Energjisë dhe Industrisë në cilësinë e pronarit për Albpetyl sh.a. në zbatim të pikës 6 (b), të VKM-së nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a. dhe përcaktimin e Autoritetit Publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Albpetyl sh.a. dhe Albgaz sh.a.”, ka miratuar me urdhrin nr. 448 prot., datë 29.12.2016, dhe vendimin e Këshillit Mbikëqyrës, nr. 33, datë 21.12.2016, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Albpetyl sh.a.

Për sa më sipër, konkludojmë se anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Albgaz sh.a., janë emëruar nga MZHE'TIS-ja, duke respektuar kufizimet e imponuara nga neni 54 i ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

- Në bazë të nenit 36, në pikat 2, 3, 4, 5, 6 përcaktohet, se:

2. Për të siguruar pavarësinë e Albgaz sh.a., i njëjti person ose të njëjtët persona nuk kanë të drejtën që njëkohësisht:

- a) Të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një të licencuar, që kryen ndonjë nga veprimtaritë e



prodhimit apo të furnizimit të gazit natyror e të energjisë elektrike, dhe të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen ose ndonjë të drejtë tjetër ndaj Operatorit të Sistemit të Transmetimit apo rrjetit të transmetimit.

b) Të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen apo të ushtrojnë ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo të furnizimit të gazit natyror dhe të energjisë elektrike.

c) Të emërojnë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht Operatorin e Sistemit të Transmetimit apo rrjetin e transmetimit dhe, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen apo ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo të furnizimit të gazit natyror dhe të energjisë elektrike.

ç) Të jenë anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose furnizimit të energjisë elektrike e të gazit natyror dhe veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të transmetimit.

3. Ndalimet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2, të këtij neni, zbatohen në mënyrë të veçantë, për:

a) kompetencën për të ushtruar të drejtën e votës;

b) kompetencën për të emëruar anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë të licencuarin;

c) të drejtën e mbajtjes së një pjese të shumicës së aksioneve.

4. Detyrimi i parashikuar në pikën 2 të këtij neni, konsiderohet se është përmbushur nëse dy ose më shumë shoqëri, të cilat kanë rrjetet e tyre të transmetimit, kanë krijuar një sipërmarrje të përbashkët, e cila vepron si një Operator i Sistemit të Transmetimit në dy ose më shumë shtete. Asnjë shoqëri tjetër nuk mund të jetë pjesë e kësaj sipërmarrjeje të përbashkët, përveç rastit kur shoqëria është përcaktuar si operator i pavarur i sistemit të transmetimit dhe është certifikuar sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

5. Kur personi i përmendur në pikën 2 të këtij neni, është një organ publik që kontrollohet nga shteti, atëherë dy organe të veçanta publike që ushtrojnë kontroll, njëri mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe tjetri mbi të licencuarin që kryen funksionin e prodhimit ose të furnizimit të gazit natyror e të energjisë elektrike, do të konsiderohen sikur nuk janë i njëjti person.

6. Operatorit të kombinuar, i cili ka qenë pjesë e një shoqërie të integruar vertikalisht, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, merr masat që të mos përhapë apo të mos transferojë informacione të ndjeshme tregtare te njësitë e tjera të shoqërisë së mëparshme të integruar vertikalisht, që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo të furnizimit të gazit natyror dhe të energjisë elektrike.

Siç evidentohet më lart në bazë të VKM-së nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Albpetrol sh.a. dhe Albgaz sh.a.”, rezulton se Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është mbajtëse e 100% të aksioneve të Albgaz sh.a., ndërkohë që MEI është 100% aksionare e Albpetrol sh.a. të cilat ushtrojnë respektivisht aktivitetin e prodhimit dhe atë të operatorit të gazit natyror.

Në këtë mënyrë, për qëllime të ndarjes së pronësisë së Albgaz sh.a., rezulton e kryer kjo ndarje sipas parashikimeve të nenit 36, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe në përputhje me sa përcaktuar në nenin 8, germa “a”, të rregullave të miratuara me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015, dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, ku përcaktohet se, ndër kriteret që duhet të përmbushen nga aplikuesi për të mundësuar vendimmarrjen dhe certifikimin nga rregullatori është: a) personi juridik që ka pronësinë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror nuk duhet të ketë të drejta kontrolli të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në aktivitetet e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit apo anasjelltas;

Në formularin e ndarjes së pronësisë të rregullores së ERE-s, përcaktohet se: Personi juridik që ka pronësinë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror nuk emëron, kontrollon apo është anëtar i bordeve apo i strukturave drejtuese në aktivitetet e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit apo anasjelltas, si dhe nuk



ushtron të drejtën e votës apo të drejtën e maxhorancës së aksioneve;

Kjo kërkesë e rregullores, ka gjetur zgjidhje në kuadër të parashikimeve të VKM-së nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Albpetrol sh.a. dhe Albgaz sh.a.”, shpjeguar në mënyrë të detajuar më lart.

Në germën “q”, të pikës 2, të nenit 8, të rregullores miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 100, datë 5.8.2015, dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, kërkohet të parandalohet nxjerrja e informacionit të ndjeshëm tregtar të kompanive të energjisë.

Referuar akteve të brendshme të kompanisë (Kodi i Sjelljes i Albgaz sh.a., pika 16.3, rezulton se çdo punonjës i Albgaz sh.a. duhet të respektojë ndër të tjera ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit edhe pas largimit nga shoqëria. Në mënyrë të veçantë në nenin 16.3 të Kodit të Etikës është përcaktuar sa vijon:

Punonjësit e Albgaz sh.a. duhet të zbatojnë me rigorozitet parimin e konfidencialitetit ndaj të gjithë klientëve të saj.

Albgaz sh.a. duhet të sigurojë kushtet e duhura për ruajtjen dhe mbrojtjen e informacionit të klientit. Vetëm klienti apo personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të kërkojnë dhe trajtojnë informacionin që i përket atij.

Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, punonjësit mund të kenë akses në informacion, që zakonisht nuk është i hapur për publikun ose që konsiderohet konfidencial. Këtu mund të përfshihet informacioni, që ka lidhje me furnizuesit, punonjësit, me të cilët Albgaz sh.a. është e lidhur ose ka qenë e lidhur në të kaluarën. Është e rëndësishme që kurrë të mos diskutohen informacione të tilla me persona jashtë Albgaz sh.a., me mediat e shkruara ose elektronike ose me pjesëtarë të tjerë të stafit, që nuk kanë nevojë të jenë në dijeni, përveç rasteve të autorizuar nga eprori i tyre. Ju nuk mund të përdorni informacione konfidenciale për qëllime të tjera, veç atyre të punës.

Informacioni konfidencial (në formë elektronike, të shkruar, të folur, ose ndonjë formë tjetër) nuk duhet të dalë jashtë ambienteve të Albgaz sh.a. Përgjatë mund të bëhen vetëm në rastet e mëposhtme:

- Pas aprovimit paraprak nga eprori, nëse punonjësi dëshiron të punojë me informacionin jashtë ambienteve të Albgaz sh.a., por vetëm në interes të punës. Në raste të tilla, punonjësi duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, që asnjë person i tretë të mos ketë akses në këtë informacion;

- Në raste të tjera, vetëm pas miratimit paraprak me shkrim nga një menaxher i Albgaz sh.a.

Kur një punonjës largohet nga vendi i tij/saj i punës në fund të ditës ose largohet gjatë ditës, ai/ajo duhet të sigurohet që asnjë informacion konfidencial të mos lihet në vendin e punës ose në një vend tjetër të aksesueshëm lehtë. Të gjitha dokumentet që përmbajnë informacion konfidencial, duhet të mbyllet me çelës dhe kompjuteri duhet të fiket ose të jetë i mbrojtur me kod. Gjithashtu, gjatë bisedave me klientë në vendin e punës, gjithë informacioni konfidencial, duke përfshirë informacionin në kompjuter, nuk duhet të jetë i dukshëm. Informacioni konfidencial mund t’u jepet palëve të treta vetëm pas aprovimit paraprak nga një menaxher i Albgaz sh.a. Punonjësit mund t’u japin informacion konfidencial kolegëve të tyre të punës vetëm kur kjo është në interes të kompanisë.

Përgjegjësia për mosdhënie të informacionit konfidencial është e vlefshme edhe pas largimit të punonjësit nga puna.

Nxjerrja e informacionit konfidencial nga punonjësi do të shoqërohet me marrjen e masave disiplinore, që mund të sjellin edhe largimin nga puna.

Gjithashtu, në kontratën individuale të punës, në nenin 16, është parashikuar se:

16.1 Punëmarrësi ndalohet të nxjerrë dokumentacion konfidencial nga institucioni ku ai punon normalisht apo ku shkon përkohësisht, pa autorizim paraprak me shkrim nga eprori i tij.

16.2 Punëmarrësi ndalohet të nxjerrë informacione të cilat do të mund të dëmtojnë interesat e Albgaz sh.a., apo të ndonjë shoqërie a personi tjetër, për të cilat ka rënë në dijeni gjatë ushtrimit të detyrës apo për shkak të saj.

16.3 Në ato raste ku e gjykon të përshtatshme, punëdhënësi mund të kërkojë nga një apo disa punëmarrës të nënshkruajnë një kontratë konfidencialiteti. Punëmarrësi është i detyruar të nënshkruajë kontratën e konfidencialitetit kur i kërkohet nga punëdhënësi.



16.4 Në ato raste kur e gjykon të përshtatshme, punëdhënësi mund të kërkojë nga një apo disa punëmarrës të nënshkruajnë një deklaratë konflikti interesi, nëpërmjet së cilës punëmarrësi të shprehet se nuk ka asnjë interes, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të vërtetë apo në dukje dhe që vjen apo mund të vijë në konflikt me pozicionin e tij në shoqërinë Albgaz sh.a. dhe me interesat e kësaj të fundit. Punëmarrësi është i detyruar të nënshkruajë deklaratën e konfliktit të interesit kur i kërkohet nga punëdhënësi.

Po ashtu, në referencë të nenit 41, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, Albgaz sh.a. ka detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit të ndjeshëm tregtar. Në këtë nen përcaktohet se OST-ja:

“Ruan konfidencialitetin e çdo informacioni të ndjeshëm tregtar.”

Sa më sipër kërkuar nga ligji është pasqyruar në aktet e brendshme të Albgaz sh.a., shpjeguar në mënyrë të detajuar në paragrafin më sipër.

- Në nenin 80, pika 4, germa “c”, kërkohet pasja në dispozicion të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror të burimeve të nevojshme financiare, teknike, fizike dhe njerëzore për të realizuar aktivitetin e tij. Lidhur me këtë kriter të ligjit në analizë të dokumentacionit të dorëzuar nga aplikuesi rezulton, se:

Megjithëse kemi të bëjmë me kompani të sapokrijuar, Albgaz sh.a. ka filluar menjëherë punë për certifikim dhe licencim. Në pritje të vendimit të ERE-s për tarifën e transmetimit, Albgaz sh.a. ka gjetur klientë me të cilët ka përgatitur kontratat e bashkëpunimit. Me miratimin e tarifës nga ERE, Albgaz sh.a. do të jetë në gjendje të fillojë të transmetojë gaz dhe realizojë mbulimin e shpenzimeve për vitin 2017. Parlamenti Shqiptar, miratoi ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i cili shënon një hap shumë të rëndësishëm për gjithë legjislacionin shqiptar në përgjithësi si një dëshmi e përafrimit të tij me legjislacionin evropian, por ka rëndësi të veçantë për sektorin e gazit natyror, për sa u përket organizimit dhe funksionimit të tij. Ky ligj reflekton parashikimet e paketës së tretë legjislative evropiane në fushën e energjisë dhe, si rrjedhojë vendos kritere të reja për organizimin dhe funksionimin e shoqërive të sektorit elektroenergetik dhe tregut të gazit natyror. Një vend të veçantë në këto parashikime ligjore, zë Albgaz sh.a., si shoqëria e

sektorit të gazit natyror që ka detyrimin për të garantuar sigurinë e gjithë sistemit të gazit natyror shqiptar. Për këtë, Albgaz sh.a. duhet të sigurojë pavarësinë e saj nga kompanitë e tjera të sistemit të gazit natyror nëpërmjet procesit të certifikimit, transparencës në procesin e alokimit të kapaciteteve të transmetimit, sigurimit të gazit për humbjet dhe shërbimet ndihmëse në tregun e gazit nëpërmjet procedurave konkurruese dhe transparente, sigurimit të balancimit të sistemit nëpërmjet organizimit dhe operimit të tregut të disbalancave, sigurimit të tarifave transparente për aksesin në rrjetin e transmetimit, pjesëmarrje aktive në organizimin dhe funksionimin e tregut të gazit natyror. Duket qartë që ligji i ri, ashtu sikurse edhe synimi për anëtarësimin me të drejta të plota në ENTSO-G, e vendos Albgaz sh.a. përballë shumë detyrimeve dhe, si rrjedhojë para një perspektive të re, e cila kërkon përshtatjen e Albgaz sh.a. me një kompani evropiane transmetimi të gazit, që do të thotë, zhvillimin e Albgaz sh.a., jo vetëm si një kompani që përmbush të gjitha kriteret teknike dhe ligjore evropiane, por edhe si një tërësi burimesh njerëzore që e bëjnë të mundur përmbushjen e këtyre kriterëve. Edhe struktura organizative e Albgaz sh.a. është konceptuar duke pasur parasysh pikërisht gjithë sa më sipër, me disa drejtori që kryejnë funksione administrative me varësi nga administratori i shoqërisë dhe tri departamentet, që lidhen drejtpërdrejtë me përmbushjen e objektivave ligjorë të sipërpërmendur dhe, konkretisht:

Referuar organogramës së miratuar të shoqërisë Albgaz sh.a. rezulton se janë 550 punëmarrës të kontraktuar, mbështetur në kontratën individuale të punës, nga shoqëria Albgaz sh.a.

#### I. DREJTORI TREGTAR

Drejtori i cili ka për detyrë, që të:

- përpilojë dhe parashtojë planet operationale, financiare dhe strategjike që lidhen me aktivitetin tregtar të Albgaz sh.a.;
- komunikojë me administratorin në lidhje me çështje të administrimit tregtar të shoqërisë;
- mbikëqyrë aktivitetin tregtar të shoqërisë;
- ndjekë tregun e gazit natyror në Shqipëri, rajon dhe Bashkimin Evropian;
- propozojë masa dhe ndërhyrje konkrete për rregullat e tregut të gazit natyror;
- komunikojë dhe propozon ndryshime për planin tregtar të shoqërisë;



- raportoje aktivitetin e tij pranë administratorit të shoqërisë; si dhe

- çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga administratori.

## II. DREJTORIA TEKNIKE

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

- Duke pasur në fokus bilancet e gazit në rrjetet e transmetimit dhe të shpërndarjes apo në depozitat, llogarit humbjet teknike respektive duke krijuar një tablo të qartë dhe transparente për situatën e humbjeve teknike në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes apo depozitimit të kompanisë Albgaz sh.a.

- Jep kontributin për zhvillimin në mënyrë të plotë nga ana teknike por edhe nga ana menaxheriale duke pasur në fokus jo vetëm zvogëlimin e humbjeve teknike, por edhe leverdinë ekonomike dhe rikthyeshmërinë e këtyre investimeve. Kështu, me anën kësaj mënyre menaxhimi, do t'i shërbejë administratorit të shoqërisë për ta orientuar atë sa më saktë mbi prioritetet teknike dhe eficiencën ekonomike të të gjitha investimeve që do të duhen në rrjetin e transmetimit, shpërndarjes dhe depozitimit të Albgaz sh.a.

- Ndjek, zbaton, kontrollon dhe evidenton vendimet e administratorit dhe të Këshillit shkencor dhe merr masat e nevojshme tekniko-organizative për implementimin e tyre.

- Do të kontribuojë në mënyrë të vazhdueshme në miratimin dhe kontrollin e standardeve dhe miratimin e specifikimeve teknike të pajisjeve dhe materialeve që do të futen në rrjetin e Albgaz sh.a., duke rritur efikasitetin e tij dhe ulur kostot operacionale.

- Kontribuon në standardizimin për të krijuar lehtësime në përmirësime në operacionet e transmetimit, shpërndarjes apo depozitimit të gazit natyror dhe ofrimin e shërbimeve, duke siguruar masat e performancës, që do të:

- ndihmojnë menaxherët e Albgaz sh.a. për të kuptuar më mirë pikat e forta të kompanisë së tyre dhe dobësitë, përpjekjet për përmirësime të drejtpërdrejta;

- ndihmojë zyrtarët publikë, investitorët, institucionet e kreditimit dhe organizatat donatore për të zhvilluar shpenzime kapitale dhe programe të asistencës teknike për Albgaz sh.a. që janë të lidhura me performancën;

- kontribuojë për projektimin, planifikimin dhe zhvillimin e aseteve të Albgaz sh.a.

- Nëpërmjet sektorit të shërbimeve teknike e të mirëmbajtjes së rrjetit të transmetimit të cilin e ka në varësi, do të kontribuojë që veprimet operacionale të kryerjes së mirëmbajtjes së rrjetit dhe të shfrytëzimit të tij të realizohen jo vetëm sipas rregullave teknike të gazit, por edhe me eficiencë ekonomike, pra me kosto sa më të ulët.

- Menaxhimin e ndërprerjeve të paplanifikuara për arsye teknike apo abuzive.

- Menaxhimin e bazës materiale edhe në nivele të ulëta në terren si grup operativ dhe operacional.

- Menaxhon tërësinë e veprimeve të investimit, rikonstruktimit të rrjetit, remonteve kapitale, si edhe veprimet operacionale.

- Menaxhimin e situatave emergjente që mund të krijohen në rrjet si pasojë e forcave madhore, fatkeqësive natyrore apo ndërhyrjeve abuzive të personave fizikë, subjekteve të ndryshme shtetërore ose private.

- Menaxhon procesin e optimizimit të regjimit teknik të rrjetit, e kryerjes së bilancit të gazit në rrjetin shpërndarës dhe llogaritë humbjet.

- Konkordon për objektivat me administratorin e kompanisë dhe preokupohet për shpërndarjen pranë drejtorive që ai mbulon, si dhe për më tepër me ndjekjen dhe realizimin e tyre.

- Përcakton dhe ndjek objektivat teknikë për zhvillimin e aktiviteteve që ai ka nëpërmjet programimit dhe planifikimit, për sa u përket shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit.

- Ndjek efikasitetin dhe eficiencën organizative sipas objektivave strategjike me anën e iniciativave të përshtatshme lidhur me organizimin e punës, me koordinimin dhe kontrollin e tyre.

- Analizon avaritë e rënda dhe aksidentet në punë, nxjerr konkluzionet teknike në lidhje me to, si dhe i propozon administratorit marrjen e masave të nevojshme për minimizimin dhe mosndodhjen e tyre në të ardhmen.

- Përgjigjet në shkallën më të lartë për zbatimin e rregullave teknike e të sigurisë në punë të jetës së punonjësve, të qytetarëve të komunitetit ku Albgaz sh.a. ushtron aktivitetin.

- Propozon masat e nevojshme për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji për mbrojtjen e mjedisit.





### III. DREJTORIA E FINANCËS KONTABILITETIT DHE PROGRAMIMIT

Qëllimi i Drejtorisë Ekonomike të Albgaz sh.a. (DEK) ose arritja e efektivitetit në menaxhimin e funksioneve financiare.

Funksionet financiare të Albgaz sh.a. përfshijnë:

- politikat e kontabilitetit dhe procedurat;
- llogarimbajtjen dhe raportimin e sistemeve;
- planifikimin dhe parashikimin;
- praktikrat dhe procedurat buxhetore dhe financiare, si dhe:
- përgjegjësitë mbikëqyrëse.

Qëllimi i menaxhimit të mirë financiar është për të siguruar që shoqëria të operojë si një ndërmarrje financiarisht e qëndrueshme.

### IV. DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËVESHJEVE

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

- Njëpërmjet përmbledhjes së një numri detyrash dhe procesesh synon zhvillimin dhe oportunitetet e rritjes së aktiviteteve të biznesit të kompanive brenda dhe jashtë organizatës;

- Krijimi i vlerave afatgjata të kompanisë me konsumatorët, marrëdhëniet me grupe të interesit dhe me tregjet;

- Zhvillimi i detyrave dhe proceseve lidhur me përgatitjet analitike të oportuniteteve të rritjes potenciale të bizneseve të shoqërisë;

- Mbështetja dhe monitorimi i implementimit të oportuniteteve të rritjes;

- Ngritja, ndërtimi i menaxhimit të marrëdhënieve strategjike;

- Bashkëpunimi dhe ndarja me të tjerët të ekspertizës, teknologjisë etj., që të zgjerohen kapacitetet për të identifikuar, kërkuar (kërkim shkencor), analizuar dhe për të sjellë në tregje biznese efektive dhe produkte të reja;

- Fokusimi në zhvillimin e projekteve njëpërmjet financimeve, teknologjisë, produkteve;

- Menaxhon të gjitha projektet që ndërmerr kompania me qëllim arritjen e strategjisë së saj;

- Analizon rezultatet e projekteve dhe jep konkluzionet dhe rekomandimet respektive për administratorin dhe menaxhimin e kompanisë;

- Ndërmerr iniciativa dhe propozon projekte të reja për kompaninë, me qëllim arritjen e objektivave strategjike të kompanisë;

- Analizon dhe vlerëson raportet e përgatitura dhe raporton rezultatet në mënyrë periodike tek eprorët;

- Përgjigjet për zbatimin e detyrave dhe angazhimeve që kanë strukturat e Albgaz sh.a. në kuadër të zbatimit të projekteve;

- Programon, implementon, monitoron dhe ndjek zbatimin në kohë dhe me cilësi të veprimtarive të lidhura me menaxhimin e projekteve;

Monitoron zbatimin e projekteve me qëllim përdorimin me efektivitet të tyre;

- Përcakton punët që duhet të kompletohen gjatë ciklit të jetës së projektit;

- Gjatë procesit të planifikimit, njëpërmjet *output*-ve kërkohet caktimi i punëve të nevojshme për ta përmbyllur projektin;

- Njëpërmjet procesit të kontrollit dhe monitorimit mundësohet menaxhimi i “zvarritjes së fushëveprimit (scope creep)”, dokumentimit, ndjekjes, dhe aprovimit/disaprovimit të ndryshimeve të projektit;

- Njëpërmjet procesit të mbylljes, përmes auditit konkludohet në gjetjet e projektit dhe vlerësohen rezultatet kundër planit origjinal;

- Përcaktohen qartë fushat e produktit dhe të projektit;

- Përcaktimi i fushës së projektit të lidhur me kërkesat e biznesit/kompanisë, kërkesat e projektit dhe kërkesat e gjetjeve;

- Përcaktimi i fushës së produktit lidhur me kërkesat teknologjike, kërkesa të sigurisë dhe të performancës.

### V. DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

- Menaxhon shërbimet që janë në mbështetje të realizimit të aktiviteteve të shoqërisë;

- Mbështet strukturat e shoqërisë me opinione ligjore, ndjek dhe realizon përfaqësimin në gjyq të proceseve gjyqësore në të cilat përfshihet shoqëria;

- Mbështet strukturat e tjera me shërbimet mbështetëse (automjete, shërbimet e mirëmbajtjes, IT, shërbime operationale etj.);

- Menaxhon dhe planifikon burimet njerëzore të shoqërisë;

- Menaxhon proceset e prokurimit sipas legjislacionit në fuqi;

- Autorizon lëvizjen e bazës materiale duke kontrolluar eficiencën e përdorimit të saj nga strukturat përkatëse.

Përveç ndarjes, sa u përket burimeve njerëzore të Albgaz sh.a. dhe Albgaz sh.a., rezulton se kjo



ndarje është konkretizuar edhe në strukturat fizike, financiare dhe në nivel teknik. Sa më sipër, selia e shoqërisë Albgaz sh.a., referuar nenit 2 të statutit të shoqërisë, ndodhet në Tiranë në adresën: Njësia Bashkiake nr. 2, bulevardi “Zhan’Dark”, nr. 3, mbrapa Ministrisë së Jashtme dhe nuk ka asnjë lidhje me zyrat e Albpetrol sh.a.

Faqja zyrtare e shoqërisë Albgaz sh.a. është: [www.Albgaz.al](http://www.Albgaz.al) edhe serveri ndodhet në godinën INSTAT, Njësia Bashkiake nr. 2, bulevardi “Zhan’Dark”, nr. 3, mbrapa Ministrisë së Jashtme.

Llogaritë bankare janë, gjithashtu, të ndara nga Albpetrol sh.a. referuar edhe kopjes së dokumentit

bankar IBAN pranë Bankës Credins depozituar në ERE.

Ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ka bërë disa parashikime të cilat përfshijnë dhe përbëjnë detyrimin e Albgaz sh.a. në lidhje me hartimin e një plani 10-vjeçar zhvillimor, që duhet të përmbajë, procedurën e miratimit, procedurën e rishikimit, detyrimin e raportimit në lidhje me këto plane në ERE.

Albgaz sh.a. zotëron asetet sipas dokumenteve bashkëngjitur, nga të cilat veçojmë rrjetin e transmetimit si vijon:

Nr.	Magjistralet	Gjatësi km	Diametri $\Phi$ inc	Presioni i projektuar bar	Presioni i pranuar bar	Presioni faktik bar	Debiti i projektuar Nm <sup>3</sup> /ditë	Debiti i pranuar Nm <sup>3</sup> /ditë	Debiti faktik Nm <sup>3</sup> /ditë
1	Divjakë - Bubullimë	23	12-8-4	40	8	4-4.5	2300000	87000	5000
2	Bubullimë-Fier	14	12	40	8	4.5	2300000	87000	5000
3	Povelçe - Fier	17.3	9.1	40	10	4.5	1200000	11500	3000
4	Frakull -Fier	7	6	40	10	3-4.5	760000	17700	5000
5	Cakran-Ballsh	5.5	10	40	15	3-4.5	300000	40000	5000
6	Delvinë-Ballsh	101	6	40	15	6.5	110000	63000	18000-20000
7	Ballsh-Fier	24	12	40	10	4	2900000	28000	12000
8	Ballsh – Elbasan	84	12	40	20	-	1700000	-	Dëmtuar

- Me krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a. asetet e transmetimit të gazit kaluan nga shoqëria Albpetrol sh.a. te shoqëria Albgaz sh.a. Vlera e këtyre asetëve është vlerësuar në shumën 359 068 000 (treqind e pesëdhjetë e nëntë milionë e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë. Lëvizja e asetëve është bërë bazuar në VKM-në nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Albpetrol sh.a. dhe Albgaz sh.a.”

Vlerësimi i asetëve të transferuara në Albgaz sh.a. është kryer nga ekspertë kontabël të pavarur të cilët kanë kryer të gjitha veprimet e nevojshme sipas librave dhe regjistrave të vënë në dispozicion nga shoqëria Albpetrol sh.a. Këto asete tashmë figurojnë të kontabilizuara në regjistrat e shoqërisë Albgaz sh.a.

Shoqëria Albgaz sh.a. ka një interes thelbësor që

të kryejë evidentimin faktik të asetëve në terren dhe të kryejë regjistrimin e asetëve të paregjistruara në zyrat hipotekore përkatëse, pasi duke kryer këtë proces shoqëria Albgaz sh.a. do të rrisë vlerën e saj dhe do të pastrojë regjistrat nga asetet e panevojshme për operacionet e saj.

Për sa më sipër, administratori i shoqërisë Albgaz sh.a. ka lëshuar një urdhër të brendshëm nr. 02, datë 28.2.2017 ku kërkohet:

1. Të fillojë menjëherë procedura e evidentimit faktik të asetëve të shoqërisë Albgaz sh.a. dhe regjistrimin e tyre në zyrat hipotekore.

2. Të ngrihet grupi i punës me 8 punonjës të niveleve të larta drejtuese për menaxhimin e procesit.

3. Grupi i punës është ngarkuar me detyrat si më poshtë:

a) Në bashkëpunim me drejtorinë teknike, Drejtorinë e Projekteve dhe të Marrëveshjeve dhe



Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, të evidentojnë në bazë të të dhënave që disponojnë dhe këqyrjes faktike në terren, gjatësinë e linjave të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror, asete të Albgaz sh.a. dhe statusin e regjistrimit të tyre në regjistrat hipotekorë.

b) Në bazë të të dhënave të marra nga aktiviteti i përshkruar në pikën “a”, të përcaktojnë numrin e ditëve të punës dhe punonjësve që nevojiten për verifikimin faktik të aseteve në terren sipas linjave të transmetimit dhe të shpërndarjes dhe të përgatisë një plan konkret për regjistrimin e aseteve të hipotekuar në regjistrat përkatës hipotekorë.

4. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Ekonomike, në bashkëpunim me grupin e punës të llogarisë nevojat për mjete logjistike dhe të mbulojë kostot për verifikimin faktik të aseteve në terren dhe regjistrimin e tyre në regjistrat përkatës hipotekorë.

Afati final për përfundimin e procesit të evidentimit faktik të aseteve në terren është vënë data 30 shtator 2017.

Rrjeti i tanishëm në zotërim nga Albgaz sh.a. përfshin këto sisteme të amortizuara të transmetimit. Albgaz sh.a. ka ngritur grup pune për vlerësimin e këtij sistemi dhe përmirësimin e tij. Rezultatet e këtyre grupeve të punës dhe parashikime të tjera në masterplanin e gazit dhe projekteve specifike të këtij masterplani do të përbëjnë bazën për planin 10-vjeçar zhvillimor të Albgaz sh.a., neni 46, i ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, “Zhvillimi i rrjetit dhe vendimet e investimeve”.

1. Operatori i kombinuar, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, paraqet në ERE një plan dhjetëvjeçar zhvillimi të rrjetit të transmetimit, në bazë të kërkesës e të ofertës, i cili rishikohet deri më 31 Tetor të çdo viti, pasi të jetë konsultuar me të gjitha palët e interesuara dhe të jenë mbajtur parasysh parashikimi ekzistues dhe i planifikuar i kërkesë-ofertës. Plani i zhvillimit të rrjetit të transmetimit përmban masa efikase, në mënyrë që të garantojë përshtatshmërinë e rrjetit dhe sigurinë e furnizimit.

2. Plani i zhvillimit të rrjetit duhet:

a) të marrë në konsideratë informacionin për pjesëmarrësit e tregut të gazit natyror, si dhe informacionet për infrastrukturën kryesore të transmetimit që duhet të ndërtohet ose të përmirësohet gjatë 10 viteve të ardhshme;

b) të përmbajë të dhëna për të gjitha investimet e miratuara dhe të identifikojë investimet e reja, të cilat duhet të ekzekutohen në tri vitet e ardhshme;

c) të përcaktojë një afat kohor për të gjitha projektet e investimeve.

3. Në hartimin e planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit, Albgaz sh.a. bën parashikime në lidhje me prodhimin, furnizimin, konsumin dhe shkëmbimin e gazit natyror me vendet e tjera, duke marrë parasysh planet e investimeve për rrjetet në vendet përreth, si dhe planet e investimeve për impiantet e depozitimit dhe rigazifikimit të GNL-së.

4. ERE konsultohet në mënyrë të hapur dhe transparente me të gjithë përdoruesit aktualë apo të mundshëm të sistemit lidhur me planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit. ERE boton rezultatin e procesit të konsultimit, veçanërisht nevojat e mundshme për investime.

5. ERE shqyrton planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit dhe, në rast se vëren se nuk janë përmbushur të gjitha nevojat e zhvillimit për investime të identifikuar gjatë procesit të konsultimit, kërkon nga operatorit i kombinuar të plotësojë dhe/ose të ndryshojë planin e tij dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit.

6. ERE miraton, monitoron, si dhe vlerëson zbatimin e planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit.

7. Kur ERE konstaton se operatori i kombinuar nuk ka realizuar për tri vite një investim të parashikuar, sipas planit dhjetëvjeçar, dhe gjykon se investimi është i nevojshëm e mund të financohet pa penguar operimin normal të rrjetit, i kërkon atij të marrë një nga këto masa:

a) të realizojë investimin në fjalë;

b) të organizojë një procedurë konkurruese për realizimin e investimit në fjalë, të hapur ndaj çdo investitori;

c) të pranojë rritjen e kapitalit, me qëllim financimin e investimeve të nevojshme dhe të lejojë investitorët e pavarur për të marrë pjesë në kapitalin e shoqërisë.

8. Kur ERE merr masa, sipas shkronjës “b”, të pikës 7, të këtij neni, mund ta detyrojë Operatorin e Sistemit të Transmetimit të zbatojë një ose më shumë nga alternativat e mëposhtme:

a) të sigurojë financimin nga ndonjë palë e tretë;

b) të kërkojë ndërtimin nga ndonjë palë e tretë;

c) të ndërtojë vetë asetet e reja përkatëse brenda një afati të arsyeshëm;

ç) t'i operojë asetet e reja pas ndërtimit.



9. Albgaz sh.a. u siguron investitorëve të gjitha informacionet e nevojshme për të realizuar investimet dhe bën përpjekjet maksimale për të lehtësuar zbatimin e projektit të investimit. Marrëveshjet përkatëse financiare do t'i nënshtrohen miratimit nga ERE.

10. ERE, në ushtrimin e kompetencave të saj, sipas pikave 7 dhe 8, të këtij neni, merr mendimin nga ministria përgjegjëse për energjinë.

11. ERE merr masa që kostot e investimeve të mbulohen nga tarifat përkatëse dhe që investimet e parrealizuara të merren në konsideratë gjatë miratimit të tarifave të vitit pasardhës.

12. ERE harton dhe miraton një rregullore për procedurat e paraqitjes e të miratimit të planeve të investimit.

Detyrat e operatorit të kombinuar janë ato që përcaktohen në nenet 41, 53, 61 dhe 69.

Specifikisht, neni 41 parashikon:

1. Albgaz sh.a. ka këto përgjegjësi kryesore:

a) Ndërton, zotëron, operon, mirëmban dhe zhvillon në varësi të kushteve ekonomike një sistem të sigurt nga rreziqet dhe eficient të transmetimit të gazit natyror dhe siguron një treg konkurrent, si edhe kapacitete të mjaftueshme për të plotësuar kërkesën e arsyeshme për transmetim të gazit natyror në një territor të caktuar dhe mjete të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e shërbimit. Albgaz sh.a., gjatë përmbushjes së detyrave të tij, respekton kërkesat e mbrojtjes në punë në sistemin e transportit, si dhe mbrojtjes së mjedisit, sipas legjislacionit në fuqi.

b) Siguron shërbimin e transmetimit të gazit natyror, në përputhje me kushtet e licencës dhe me rregullat e ERE-s.

c) Kryen balancimin e sistemit, mbështetur në parime objektive, transparente e jodiskriminuese, në përputhje me rregullat balancuese. Çmimet për ofrimin e shërbimeve të lidhura me balancimin do të përcaktohen në bazë të metodologjisë së miratuar nga ERE.

ç) Siguron ofrimin e shërbimeve të sistemit në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese, në bazë të parimit të kostos më të ulët dhe ndikimit mjedisor më të ulët.

d) Ndërton kapacitete të mjaftueshme ndërkufitare për të integruar sistemin e transmetimit të gazit natyror të Shqipërisë me sistemin analog të vendeve anëtare të BE-së dhe palëve kontraktuese të Komunitetit të Energjisë,

duke përmbushur të gjitha kërkesat e nevojshme ekonomike dhe teknike të realizueshme për kapacitetin, si dhe duke marrë parasysh sigurinë e furnizimit me gaz.

dh) U siguron çdo operatori tjetër të sistemit të transmetimit, OSSH-së, operatorit të impiantit të depozitave, operatorit të impiantit të GNL-së, OST-së fqinje ose shoqërive të tjera të licencuara të gazit natyror informacion të mjaftueshëm, në mënyrë që transporti dhe depozitimi i gazit natyror të jenë në përputhje me mundësinë për të siguruar ndërveprimin e sigurt dhe eficient të sistemeve të ndërlidhura.

e) U siguron përdoruesve të sistemit informacion të hollësishëm, të kuptueshëm dhe të arritshëm për shërbimet e ofruara, kushtet e shërbimit dhe informacionin e nevojshëm teknik për përdoruesit e rrjetit, për t'u mundësuar një akses efektiv në rrjet, përfshirë, por pa kufizuar, kapacitetet teknike të kontraktuara dhe të disponueshme, në përputhje me informacionin konfidencial të përjashtimeve, të miratuar nga ERE.

ë) Prokuron energji për kryerjen e funksioneve të tij, sipas procedurave transparente, jodiskriminuese dhe në përputhje me tregun.

f) Ruan dhe vendos në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse të gjithë informacionin e përmendur në nenin 48, të këtij ligji, për një periudhë pesëvjeçare. Ky informacion duhet të vendoset në dispozicion edhe të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

g) Ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm që të drejtat e kapaciteteve të jenë lirish të tregtueshme, duke marrë masa që ky proces të kryhet në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese. Albgaz sh.a. harton kontrata të harmonizuara të transportit dhe procedurat për tregun primar, me qëllim lehtësimin e tregut sekondar të kapaciteteve dhe pranimin e transferimit të të drejtave të kapaciteteve fillestare të njoftuara nga përdoruesit e sistemit. Këto kontrata të harmonizuara dhe procedura i njoftohen ERE-s;

gj) ruan konfidencialitetin e çdo informacioni të ndjeshëm tregtar.

2. Albgaz sh.a. ushtron veprimtarinë në përputhje me standardet minimale teknike të miratuara nga ministria, për mirëmbajtjen, zhvillimin, inspektimin teknik të sistemit të transmetimit të gazit natyror dhe kapacitetin ndërlidhës.



Në analizë të kompetencave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror për dhënien dhe menaxhimin e aksesit të palëve të treta, si dhe operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit, me qëllim përmbushjen afatgjatë të kërkesës nëpërmjet planifikimit të investimeve, ndërtimin dhe komisionimin e infrastrukturës përfshirë dhe procedurën e autorizimit vërehet se:

Në nenin 42, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të sigurojë lidhjen me rrjetin e transmetimit mbi kushte jodiskriminuese.

1. OST-ja do të sigurojë akses të pakufizuar në sistemin e transmetimit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit. Në këtë drejtim, OST-ja:

a) Ofron shërbimet e saj në mënyrë jodiskriminuese për të gjithë përdoruesit e rrjetit.

b) Siguron shërbime të qëndrueshme dhe të pandërprera në hyrje të palëve të treta. Çmimi i kapacitetit në ndërprerje pasqyron dhe mundësinë e ndërprerjes.

c) U ofron përdoruesve të rrjetit shërbime afatgjata dhe afatshkurtra.

2. Në lidhje me germën “a”, të pikës 1, të këtij neni, kur OST-ja u ofron të njëjtin shërbim enteve të ndryshme, atëherë duhet ta bëjë këtë sipas kriterëve dhe kushteve të njëjta kontraktuese, qoftë duke përdorur kontratat e harmonizuara të transportit dhe/ose në pajtim me Kodin e Rrjetit të Transmetimit, të miratuara nga ERE.

3. OST-ja publikon kushtet dhe detyrat e miratuara nga ERE, përfshirë rregullat dhe tarifatat për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit. Këto kushte dhe detyrime zbatohen në mënyrë jodiskriminuese për të gjithë klientët.

4. Aksesit i shërbimeve të palëve të treta mund të jepet përkundërt garancive të përshtatshme nga përdoruesit e rrjetit, në lidhje me aftësinë kreditore të shfrytëzuesve. Të tilla garanci nuk duhet të përbëjnë pengesa të panevojshme për hyrjen në treg dhe do të jenë jodiskriminuese, transparente dhe proporcionale.

5. Kontratat e transportit të nënshkruara me data jostandarde fillimi ose me një kohëzgjatje më të shkurtër se një kontratë standarde vjetore e transportit, nuk do të rezultojnë në tarifa arbitrarisht më të larta apo më të ulëta dhe nuk do të pasqyrojnë vlerën e tregut të shërbimit, sipas

parimeve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 33, të këtij ligji.

6. Lidhja e kontratave afatgjata lejohet për atë që ato janë në përputhje me legjislacionin e konkurrencës, në përputhje me parashikimet e traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë.

7. OST-ja me qëllim përmbushjen e funksioneve të saj, nëse është e nevojshme, hyn në marrëveshje dhe/ose kushte të tjera bashkëpunimi për pasjen e aksesit në sistemet e transmetimit të vendeve fqinje.

Lidhur me mbështetjen dhe informacionin nga pronari i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të gazit natyror për përmbushjen e detyrave; financimin ose miratimin e financimeve të investimeve të miratuara nga rregullatori; mbulimin e detyrimeve për asetet e rrjetit; sigurimin e garancive për të lehtësuar/mundësuar financimin e zgjerimit të rrjetit; rezultojnë se sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, neni 135, pika 2, geramat “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”...

Asambleja e përgjithshme e shoqërisë merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;

ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;

f) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;

g) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;

Në përputhje me parashikimet e statutit të Albgaz sh.a., neni 13, Asambleja e Përgjithshme (pra, pronari i Albgaz sh.a.), merr çdo vendim që ka në kompetencë sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Miratimet e mësipërme rezultojnë të jenë marrë sipas:

- Letrës nr. 536/1 prot., datë 5.2.2016, të ministrit të MZHETIS-së, “Miratim i programit ekonomik të shoqërisë për vitin 2016”.

Siç është shpjeguar deri më tani rezultojnë që Albgaz sh.a. ka të gjithë mbështetjen e nevojshme nga pronari i saj për të përmbushur detyrimet; financimin dhe miratimin e financimit të investimeve të miratuara nga rregullatori; mbulimin e përgjegjësisë për asetet e rrjetit; duke siguruar garancitë për të lehtësuar /mundësuar financimin e shtimit të rrjetit.



- Shkresës zyrtare e përmendur më lart është dokument që e vërteton këtë mbështetje.

Sipas pyetësorit përfshirë në rregulloren e sipërcituar të miratuar nga ERE, me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015, dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, “Rregullat për certifikimin e operatorit të kombinuar për gazin natyror”, kërkohet pasja e asetëve të nevojshme në pronësinë

e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror, pajisjeve, stafit të punësuar, si dhe të një identiteti komercial të qartë dhe të dallueshëm nga operatorët e tjerë.

Lidhur me këtë kërkesë të rregullores në përputhje me sa depozituar nga Albgaz sh.a., në aplikimin për certifikim rezulton se Albgaz sh.a. ka në pronësi të gjitha tubacionet si vijon:

Nr.	Magjistralet	Gjatësi km	Diametri $\Phi$ inc	Presioni i projektuar bar	Presioni i pranuar bar	Presioni faktik bar	Debiti projektuar Nm <sup>3</sup> /ditë	Debiti Pranuar Nm <sup>3</sup> /ditë	Debiti Faktik Nm <sup>3</sup> /ditë
1	Divjakë – Bubullimë	23	12-8-4	40	8	4-4.5	2300000	87000	5000
2	Bubullimë-Fier	14	12	40	8	4.5	2300000	87000	5000
3	Povelçe - Fier	17.3	9.1	40	10	4.5	1200000	11500	3000
4	Frakull -Fier	7	6	40	10	3-4.5	760000	17700	5000
5	Cakran-Ballsh	5.5	10	40	15	3-4.5	300000	40000	5000
6	Delvinë-Ballsh	101	6	40	15	6.5	110000	63000	18000-20000
7	Ballsh-Fier	24	12	40	10	4	2900000	28000	12000
8	Ballsh – Elbasan	84	12	40	20	-	1700000	-	Dëmtuar

dhe asetet sipas VKM-së 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Albpetrol sh.a. dhe Albgaz sh.a.”.

Kapitali fillestar për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a. të jetë 359 068 000 (treqind e pesëdhjetë e nëntë milionë e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë. Kjo vlerë e kapitalit fillestar përfaqëson vlerën me të cilën do të zvogëlohet kapitali i shoqërisë Albpetrol sh.a., pas shkëputjes së njësisë së gazit, në përputhje me urdhrin nr. 550/3, datë 5.5.2016, të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, “Për sistemimin e kapitalit të Albpetrol sh.a.”.

Albgaz sh.a. ushtron veprimtarinë në kuadër të rregulloreve, udhëzuesit, manualeve që lidhen me organizimin, operimin, aktivitetin apo nënkontraktimin e shërbimeve, të cilat përfshijnë: a) statutin; b) rregulloren e funksionimit Albgaz sh.a.; c) Kodin e Etikës; d) përshkrimet e punës; e) kontratat e punësimit; f) kontratat tregtare; g) rregullat teknike të gazit.

Rezulton se Albgaz sh.a. dhe Albpetrol sh.a. kanë logot dhe emërtimet të ndara dhe qartësisht të dallueshme nga njëra-tjetra. Secila prej kompanive ka, gjithashtu, numrin unik të identifikimit (VAT & NUIS number) në sistem.

Organizimi sipas formave ligjore të përcaktuara nga neni 1 i direktivës 68/151/EEC dhe kuadrit ligjor në fuqi.

Emri i kompanisë: Albgaz sh.a., NIPT-i përkatës L71306034U, me kapital 100% shtetëror me aksionar të vetëm Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Kapitali është 359 068 000 (treqind e pesëdhjetë e nëntë milionë e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë, numri i aksioneve 359,068, vlera nominale 1 000.

Sistemet IT, godinat ku ushtrohet aktiviteti i Albgaz sh.a., sistemeve të sigurisë dhe aksesit, nuk mund të bashkëshfrytëzohen me ndërmarrje/sipërmarrje të prodhimit apo të furnizimit të integruara vertikalisht apo të kontraktobjë të njëjtët ofrues të këtyre shërbimeve.

Sipas pyetësorit në rregulloren e miratuar me vendimin e ERE-s nr. 100, datë 5.8.2015, dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015,



“Rregullat për certifikimin e operatorit të kombinuar për gazin natyror”.

Përbërja dhe kompetencat e Bordit Mbikëqyrës;

Në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar sipas nenit 17 të statutit të Albgaz sh.a.:

1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Lista e anëtarëve të organeve kolegjiale të subjektit (bordit mbikëqyrës dhe/ose bordit drejtues) aplikues dhe të aktiviteteve të energjisë rezultojnë: Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Albgaz sh.a., sipas urdhrat të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë, reflektuar në ekstraktin QKB janë përcaktuar anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

Në përputhje me parashikimet e nenit 17 të statutit të Albgaz sh.a., Këshilli Mbikëqyrës i Albgaz sh.a. ka këto kompetenca: Këshilli Mbikëqyrës emëron administratorin e shoqërisë.

Këshilli mbikëqyrës në cilësinë e organit mbikëqyrës, këqyr vënien në zbatim të politikave tregtare të shoqërisë dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin. Ai ka në kompetencë:

1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme.

17.2 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës e mbajnë këtë pozicion për një periudhë prej tre vjetësh, në përfundim të së cilës ata mund të rrimërohen.

17.3 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë individë të cilët duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë, administratorët e shoqërive të tjera të të njëjtit grup, si dhe personat e lidhur me personat e mësipërm. Anëtarë të pavarur të Këshillit Mbikëqyrës vlerësohen personat të cilët nuk kanë konflikt interesash apo anëtarësie, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 13 dhe të pikës 3, të nenit 167, të ligjit “Për shoqëritë tregtare”. Çdo emërim, i bërë në kundërshtim me këto parashikime, është absolutisht i pavlefshëm. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës detyrohen të informojnë menjëherë shoqërinë për çdo konflikt interesi e anëtarësie në këshillat e shoqërive të tjera.

17.4 Çdo vend i mbetur vakant në Këshillin Mbikëqyrës si pasojë e dorëheqjes, shkarkimit, paafësisë apo vdekjes, do të plotësohet nga një anëtar i ri i emëruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Anëtar i ri do të mbetet në detyrë

deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të zëvendësuar.

17.5 Këshilli Mbikëqyrës zgjedh Kryetarin ndërmjet anëtarëve të tij, si dhe sekretarin e Këshillit Mbikëqyrës.

17.6 Përveç sa përcaktohet në këtë nen, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të plotësojnë kushtet, detyrimet, përgjegjësitë dhe kriteret e parashikuara në nenet 163 nga (1) në (3) dhe 167, i ligjit “Për shoqëritë tregtare”.

Në përputhje me parashikimet e nenit 16 të statutit të Albgaz sh.a., Këshilli Mbikëqyrës i Albgaz sh.a. ka kompetenca të:

a) thërrasë Asamblenë e Përgjithshme sa herë kjo konsiderohet e nevojshme për interesat e shoqërisë dhe menjëherë pas verifikimit të rrethanave të parashikuara nga pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 136 të ligjit “Për shoqëritë tregtare”;

b) sigurojë që shoqëria zbaton ligjet dhe standardet e zbatueshme të kontabilitetit;

c) shqyrtojë librat e shoqërisë, dokumentet dhe asetet;

d) sigurojë që pasqyrat vjetore të kontabilitetit dhe raportit i performancës së shoqërisë të përgatiten në mënyrë të rregullt nga administratori, dhe që ky i fundit të përmbushë çdo detyrim tjetër ligjor apo statutor për raportim apo publikim. Këto dokumente duhen miratuar e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, për t’i paraqitur në Asamblenë e Përgjithshme së bashku me një raport të Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me arsyet e miratimit dhe një përshkrim të mënyrave se si është monitoruar administrimi gjatë vitit financiar; dhe

e) sigurojë që auditimi i librave dhe i regjistrave të kryhet të paktën çdo vit nga një ekspert kontabël i pavarur dhe që raportit i auditorit drejtuar Asamblesë së Përgjithshme t’i jetë vënë në dispozicion çdo anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës. Raporti i Këshillit sipas germës së mëparshme (d) duhet të përmbajë, gjithashtu, mendimin e Këshillit mbi raportin e auditimit;

f) krijojë komitete të përhershme apo të posaçme, për çështje të ndryshme operationale të shoqërisë;

g) krijojë komitetin e posaçëm të auditimit të brendshëm, në të cilin bëjnë pjesë jo më pak se 3 anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës;



h) kërkojë informacion dhe të iniciojë procese llogaridhënie për çdo rast që e shih të arsyeshëm lidhur me vendimet e marra nga administratori ose aktivitetin e shoqërisë apo divizioneve e departamenteve të tjera të saj;

i) miratojë strukturën organizative dhe strukturën e personelit të shoqërisë, si dhe ndryshimin e tyre;

j) emërojë dhe të lirojë nga detyra administratorin e shoqërisë;

k) miratojë strukturën e drejtorisë së auditit të brendshëm, të shoqërisë dhe të emërojë drejtorin e anëtarët e saj;

l) miratojë planin vjetor të investimeve, përfshirë marrëveshjet në lidhje me kapacitetet e interkoneksionit ndërkufitar, shërbimet e transmetimit, depozitimit dhe të impianteve apo të shpërndarjes së gazit natyror;

m) miratojë hyrjen në një marrëveshjeje huaje apo kredie (të marra apo të dhëna) ose krijime të tjera (apo marrëveshje për krijim) të një borxhi të shoqërisë deri në shumën prej 10.000.000 eurosh;

n) japë miratimin paraprak për blerjen e aseteve të paluajtshme mbi vlerën 100.000 euro;

o) miratojë paraprakisht shitjen apo çdo formë disponimi të aseteve të paluajtshme të shoqërisë me vlerë nga 50.000 deri 100.000 euro, dhe të kërkojë paraprakisht miratimin e Asamblesë për vlera më të mëdha se 100.000 euro;

p) miratojë paraprakisht shitjen e aseteve të luajtshme në rast se vlera e një kontrate është nga 50.000 deri 100.000 euro ose nëse vlera kumulative e këtyre kontratave është nga 250.000 deri 500.000 euro brenda një viti financiar;

q) miratojë paraprakisht ndryshimet në planin financiar të shoqërisë me kërkesë nga administratori dhe të marrë aprovimin nga Asambleja për ndryshimet që janë më të larta se 25% (njëzet e pesë për qind) e vlerës fillestare të planit financiar të vitit ushtrimor;

r) miratojë paraprakisht ndryshimet në planin financiar të shoqërisë me kërkesë nga administratori kur ka ndryshim të vlerës fillestare më pak se 25% (njëzet e pesë për qind);

s) miratojë paraprakisht propozimet e administratorit për donacione, sponsorizime, financimin e projekteve sociale, kulturore dhe bamirësie.

Sipas pyetësorit në rregulloren e miratuar me vendimin e ERE-s nr. 100, datë 5.8.2015, dhe

ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, “Rregullat për certifikimin e operatorit të kombinuar për gazin natyror”.

Pavarësia e menaxhimit dhe stafit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror bazuar në kompetencat e Bordit Mbikëqyrës të Albgaz sh.a. në lidhje me rekrutimin, kompensimin dhe përfundimin e marrëdhënieve për drejtuesit ekzekutivë apo administratën pasi ka njoftuar rregullatorin mbi procedurat që rregullojnë çështjet e mësipërme dhe nëse ky i fundit nuk ka paraqitur objeksione.

Në përputhje me parashikimet e statutit të Albgaz sh.a. (neni 16, germa “j”), Këshilli Mbikëqyrës i Albgaz sh.a. emëron administratorin e shoqërisë. Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, VKM-ja nr. 642, datë 11.10.2005, “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, udhëzimit nr. 318, datë 8.4.2009, “Për emërimin, funksionimin dhe shpërbimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, lidhet midis Këshillit Mbikëqyrës dhe administratorit kontrata e administrimit të shoqërisë.

Aktualisht si rezultat i ndryshimit të bërë me ligjin nr. 8/2016, “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, neni 1, në fund të fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje, në të cilën është parashikuar se: “Ushtrimi i së drejtës së përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, përfshirë edhe të drejtën e emërimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës, në shoqëritë e gazit natyror bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Shoqëria ka depozituar në ERE deklaratat e anëtarëve të zgjedhur të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë, nënshkruar në datë 18.2.2017, në të cilat shprehen qartësisht në lidhje me mungesën e plotë të çfarëdo lloji forme lidhjeje, interesi apo ndikimi me shoqëri të tjera tregtare të cilat ushtrojnë aktivitet prodhimin, shpërndarjen dhe/ose furnizimin me gaz natyror.

Me vendimin nr. 2, datë 5.1.2017, të Këshillit Mbikëqyrës të Albgaz sh.a., “Për emërimin e administratorit të Albgaz sh.a.” dhe marrëdhëniet





financiare është emëruar administratori dhe është lidhur kontrata e administrimit të shoqërisë.

Nëpërmjet deklaratës së depozituar për procesin e certifikimit është deklaruar nga administratori se është në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në nenin 36 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe neneve 8 dhe 9, të rregullores së miratuar me vendimin e ERE-s nr. 100, datë 5.8.2015, dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, “Rregullat për certifikimin e operatorit të kombinuar për gazin natyror”, dhe në përputhje me to, deklaroi se nuk merr pjesë në aktivitetet e shoqërive elektroenergjetike dhe hidrokarbure që kanë lidhje me prodhimin, shpërndarjen dhe ose/ose furnizimin me gaz natyror dhe energji elektrike. Kjo deklaratë është plotësuar edhe nga punonjësit në nivel drejtorësh në shoqëri, ku të gjithë kanë deklaruar se nuk marrin pjesë në aktivitetet e shoqërive elektroenergjetike që kanë lidhje me prodhimin, shpërndarjen dhe/ose furnizimin me gaz natyror.

Për sa i përket përfundimit të marrëdhënieve të punës, në kontratë janë parashikuar rrethanat e përfundimit të punës. Për sa u përket të gjithë punonjësve të shoqërisë Albgaz sh.a. rezultoi se marrja në punë bëhet sipas kriterëve të punësimit në Albgaz sh.a., kriterë këto të propozuara nga administratori i shoqërisë dhe të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i saj.

Kontrata “tip” e punës ka si bazë ligjore ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, legjislacionin për sigurimet shoqërore, legjislacionin për tatimin mbi të ardhurat, aktet e funksionimit të shoqërisë ku hyjnë, rregulloren e funksionimit të shoqërisë, rregullat e punës dhe sigurimit teknik dhe Kodin e Etikës. Përcaktimi i pagave bëhet sipas strukturës së pagave dhe udhëzimit mbi aplikimin e tyre në Albgaz sh.a., e propozuar nga administratori i shoqërisë dhe miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e aksionarëve të shoqërisë. Punëmarrësi duhet të kryejë në mënyrë të ndërgjegjshme, me cilësi dhe efektivitet, të gjitha detyrat që i jepen nga eprorët, të zhvillojë dhe mbrojë interesat e punëdhënësit dhe të shmangë gjithçka që mund t'i vërë ato në rrezik. Disa nga të drejtat dhe detyrat e punonjësve janë: Duhet të mbajë një disiplinë të lartë në punë në çdo drejtim, duhet të mbajë dhe të ruajë konfidencialitetin për çdo informacion mbi ose në lidhje me

punëdhënësin, është plotësisht në dijeni dhe bie dakord që gjatë punësimit të tij duhet të mbajë parasysh dhe të zbatojë të gjitha standardet, politikat, procedurat dhe rregullat e funksionimit apo të brendshme që janë në fuqi apo mund të vendosen nga punëdhënësi kohë pas kohe etj.

Për sa i përket përfundimit të marrëdhënieve të punës në kontratën individuale “tip” janë parashikuar rrethanat dhe procedurat përkatëse mbi, “Masat disiplinore dhe zgjidhja e kontratës”. Këto procedura garantojnë që për zgjidhjen e kontratës së punës, punëdhënësi respekton dhe zbaton të gjitha rregullat dhe procedurat e parashikuara në legjislacionin shqiptar të punës. Në kodin e etikës qartësisht janë të përcaktuara parimet e ushtrimit të detyrës nga punonjësi i Albgaz sh.a., i cili përfshin ndër të tjera, detyrimin e punonjësit për të mbrojtur me besnikëri interesat e ligjshëm të shoqërisë Albgaz sh.a.; në kryerjen e detyrave duhet të jetë i ndershëm, efikas, duke pasur parasysh vetëm interesin e shoqërisë, respektimin e drejtuesve, punonjësve të tjerë, shëndetin dhe sigurinë në punë; të mos përfitojë në mënyrë të padrejtë nëpërmjet manipulimit, fshehjes dhe abuzimit të informacionit që ka në dëm të një personi ose shoqërie tjetër; të mos kërkojë e as të mos pranojë nga askush si shpërblim para ose sende me vlerë për kryerjen e detyrave të tij; të ruajë konfidencialitetin e informacionit edhe pas largimit nga shoqëria, sipas përcaktimeve ligjore.

Po ashtu janë përcaktuar edhe rrethanat e konfliktit të interesit nga punonjësi i Albgaz sh.a., veprimtarive të jashtme të punonjësit të Albgaz sh.a., përdorimit dhe përhapjes së informacioneve konfidenciale.

Për sa i përket konfliktit të interesave të punonjësve neni 1.8, “Konflikti i interesit”, të Kodit të Sjelljes së Albgaz sh.a., është parashikuar se kush do të konsiderohet konflikt, cilat janë rastet dhe si do të trajtohen ato. Për më tepër:

Punonjësit e Albgaz sh.a. nuk duhet të krijojnë situata të tilla ku shërbimi ndaj një klienti është në konflikt me shërbimin që i ofrohet një klienti tjetër apo kur interesi i vetë punonjësit është në konflikt me shërbimin ndaj klientit.

Punonjësit e Albgaz sh.a. duhet të sigurohen se interesat e tyre personale nuk bien në konflikt me detyrat ndaj Albgaz sh.a. ose detyrimeve të Albgaz sh.a. ndaj klientëve. Nëse ka dyshime mbi një rrethanë që mund të sjellë konflikt interesi, duhet të



këshillohen me drejtuesin apo me Drejtorin e Departamentit para se të ndërmerren veprime të mëtejshme.

Punonjësit duhet të deklarojnë me shkrim në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore natyrën dhe shkallën e interesit material dhe marrëdhënieve të përfitimit material kur:

a) ai është palë në një kontratë të propozuar apo të përfunduar ose një marrëdhënie përfitimi material; dhe

b) ai ka përfitim material ose është në një marrëdhënie përfitimi me çdo person që është palë në një kontratë të mbyllur apo të propozuar me Albgaz sh.a.

Nëse punonjësi ka marrëdhënie private biznesi dhe lidhje personale me klientët e Albgaz sh.a., furnitorë të tjerë, që bëjnë biznes me Albgaz sh.a., ai nuk duhet të kërkojë favore të veçanta duke iu referuar marrëdhënieve të tij me Albgaz sh.a.

- Për të shmangur konfliktin e interesit dhe rrezikun e përdorimit të gabuar të informacionit është e nevojshme që punonjësit të këshillohen me drejtuesit e shoqërisë dhe autoritetin përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave të Albgaz sh.a.

- Këto raste do të trajtohen sipas ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (i ndryshuar); ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (i ndryshuar), akteve nënligjore përkatëse dalë në zbatim të tyre, si dhe rregullores së brendshme të shoqërisë.

Këto përcaktime janë parashikuar në nenin 16.8, “Konflikti i interesave”, të Kodit të Sjelljes së Albgaz sh.a.

Po kështu për sa u përket veprimtarive të jashtme të punonjësit të Albgaz sh.a., në nenin 16.20, të Kodit të Etikës, është parashikuar se:

Një punonjës i Albgaz sh.a. mund të ndërmarrë një shërbim publik, që nuk vë në dyshim karakterin e pavarur të Albgaz sh.a., si për shembull shërbim në një këshill arsimor, bashkiak, organizatë bamirëse, ose këshill drejtues të një universiteti.

Për sa i përket përfitimit financiar, direkt apo indirekt nga shoqëritë e integruara vertikalisht, deri në këtë moment, të vetmet parashikime janë ato të përcaktuara në kontratën “tip” të punës dhe Kodin e Sjelljes në Albgaz sh.a. Për më tepër, ish-shoqëritë

e integruara vertikalisht në sistemin hidrokarbur shqiptar janë shoqëri shtetërore, ku 100% e pronësisë është e shtetit, pra mundësia e përfitimit si rezultat i pronësisë është zero. Po kështu, edhe për sa i përket përfitimit prej mundësisë së punësimit edhe ajo është e pamundur në kushtet aktuale, edhe kjo si rezultat i faktit që janë shoqëri shtetërore, mënyra e organizimit të punës, oraret e punës të cilat duke iu referuar përcaktimeve në Kodin e Punës, rrjedhimisht e bëjnë të pamundur dypunësimin e punonjësve.

Referuar ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, neni 4, përkufizime, aplikuesi nuk rezulton të jetë një kompani e organizuar vertikalisht. Specifikisht, “Shoqëri e integruar vertikalisht” është një shoqëri ose grup shoqërisht të licencuara në sektorin e gazit natyror, ku i njëjti person ose personat ushtrojnë kontroll mbi këto shoqëri në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe ku shoqëria ose grupi i shoqërive kryejnë të paktën një prej veprimtarive të transmetimit ose shpërndarjes, si dhe të paktën një prej veprimtarive të prodhimit ose furnizimit me gaz natyror, kërkesa e nenit 36 për ndarjen e pronësisë së Albgaz sh.a. është realizuar nëpërmjet VKM-së nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të shoqërive të sektorit të gazit natyror”.

- Për efekt të këtij aplikimi nga Albgaz sh.a., bashkë me kërkesën me shkrim për certifikim janë depozituar dokumentet e parashikuara në nenet 8 dhe 9 të rregullave miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 100, datë 5.8.2015, dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015.

- Të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacioni i kërkuar sipas nenit 9 të rregullores janë paraqitur në ERE në gjuhën shqipe dhe atë angleze, me shkrim dhe në mënyrë elektronike.

ERE ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, por mund të kërkojë nga Albgaz sh.a. çdo informacion të nevojshëm për qëllim të certifikimit, sipas nenit 17 ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

- Neni 9 i vendimit të Këshillit Ministerial nr. D/2011/02/MC-EnC, neni 58, pika 6, e ligjit 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, parashikon që ERE duhet të vërë në dijeni Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për vendimin e shprehur apo të pashprehur me fjalë



për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

Referuar kërkesës për certifikim, si dhe analizës dhe vlerësimit të dokumentacionit të depozituar, për këtë qëllim nga Albgaz sh.a. në ERE, bordi në mbështetje të neneve: 16, 37, 50, 59, 68, dhe 80 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, vendimit të Këshillit Ministerial nr. direktive 2009-73-EC, Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Rregullores EC nr. 715/2009, si dhe neneve 5, 6, 7, 8, 9, 10 të “Rregullave për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror”, miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015, dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, të ERE-s, vendimit të Këshillit Ministerial nr. D/2011/02/MC-EnC, Traktatit të Komunitetit të Energjisë, të ratifikuar me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, nenit 19, pika 1, germa “b”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, në mbledhjen e tij të datës 2.3.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi aplikimin e Albgaz sh.a., për certifikimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, bordi ka marrë vendimin nr. 35, datë 2.3.2017, dhe ka vendosur të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit për certifikimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror të Albgaz sh.a.

- Në nenin 80 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ka përcaktuar se operatori i kombinuar i gazit natyror ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e gazit natyror, si prodhimi, tregtimi dhe furnizimi me gaz natyror, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë ligj. Në përmbushje të këtij detyrimi, shoqëria Albgaz sh.a. ka depozituar në ERE kopje të statutit të shoqërisë, në të cilin në nenin 3, pikat 3.1.5, 3.1.8, 3.2, ka parashikuar aktivitetet e lejuara për t’u ushtruar në funksion të licencës. Objekti kryesor i aktivitetit të shoqërisë është të ofrojë gaz natyror nëpërmjet rrjetit të transmetimit, shpërndarjes, depozitimit dhe të impiantit të gazit natyror. Shoqëria realizon objektin e veprimtarisë së saj sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, me konkretisht kryerja e veprimtarive të nevojshme dhe të drejtpërdrejta të lidhura me operimin dhe funksionimin e rrjetit të transmetimit, rrjetit të shpërndarjes, hapësirave të depozitimit në

përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licencën e akorduar.

Shoqëria aplikuese, Albgaz sh.a., në vijim të zbatimit të të gjitha kërkesave për ndarjen e aktivitetit të gazit natyror, ka paraqitur në ERE listën e dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve që duhet të paraqiten nga një shoqëri, e cila aplikon për t’u caktuar dhe certifikuar si operator i kombinuar në Shqipëri. Për efekt të këtij aplikimi janë depozituar dokumentet si vijon:

- a) Kërkesa me shkrim për certifikimin e operatorit të kombinuar për gazin natyror;
- b) Dokumentet, të dhënat dhe informacionet e përmendura në nenet 8 dhe 9, kapitullin III të rregullores.

Në përputhje me ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, OST-ja krijon një program të përputhshmërisë, në të cilin përcaktohen masat e nevojshme për garantimin e sjelljes jodiskriminuese, i cili miratohet nga ERE, si dhe metodën për monitorimin e përputhshmërisë me këtë program. Programi i përputhshmërisë përcakton detyrimet e veçanta për të punësuarit e OST-së, me qëllim plotësimin e këtyre objektivave. Përputhshmëria me programin monitorohet në mënyrë të pavarur nga një zyrtar i përputhshmërisë.

2. Zyrtari i përputhshmërisë emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës ose, nëse një organ i tillë nuk është formuar, nga organi kolektiv i menaxhimit të OST-së, pas miratimit paraprak nga ERE. ERE mund të refuzojë miratimin e zyrtarit të përputhshmërisë vetëm për arsye të mungesës së pavarësisë apo kapaciteteve profesionale. Zyrtari i përputhshmërisë mund të jetë një person fizik ose juridik, i pavarur në punën dhe veprimet e tij ose të saj.

3. ERE miraton kriteret dhe detyrat për pozicionin e zyrtarit të përputhshmërisë, si dhe afatin e qëndrimit në detyrë. Me vendimet e bordit të ERE-s nr. 78, datë 26.5.2017, u miratua kontrata për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të përputhshmërisë në sektorin e gazit natyror dhe nr. 77, datë 26.5.2017, miratoi Programin e përputhshmërisë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 82, datë 26.5.2017, “Mbi certifikimin paraprak të shoqërisë “Operatori i kombinuar i gazit natyror, Albgaz sh.a.”, vendosi:



1. Miratimin paraprak të certifikimit të operatorit të kombinuar të gazit natyror, Albgaz sh.a. në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68 dhe 80 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 73/2009 EC.

2. Brenda 3 muajve pas miratimit të vendimit të certifikimit, Albgaz sh.a. të caktojë Zyrtarin e Përputhshmërisë subjekt i miratimit nga ERE, si dhe duhet që të hartojë dhe t’i dorëzojë ERE-s raportin e përcaktuar sipas programit të përputhshmërisë rregullatore jo më vonë se 12 muaj nga miratimi i vendimit të certifikimit të Albgaz sh.a., konform përcaktimeve të nenit 21 të direktivës nr. 73/2009 të Komisionit Evropian “Mbi rregullat për tregun e gazit natyror” dhe nenit 47 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

3. T’i përcjellë këtë vendim Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, për opinion, ashtu siç përcaktohet në nenin 37, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

4. T’i përcjellë këtë vendim Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Autoritetit të Konkurrencës.

Në datën 2 qershor 2017, Autoriteti Rregullator i Energjisë në Shqipëri (këtu dhe më poshtë ERE) informoi Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë (këtu dhe më poshtë Sekretariatit) mbi vendimin paraprak për certifikimin e Albgaz sh.a. (këtu dhe më poshtë Albgaz sh.a.), Operatori i Sistemit të Transmetimit (këtu dhe më poshtë OST) për gazin natyror në Shqipëri (këtu dhe më poshtë vendimi paraprak). Vendimi paraprak është miratuar në datën 26 maj 2017 bazuar në nenet 37, 50, 59, 68 dhe 80 të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, nenet 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të Rregullave të ERE-s për certifikimin e operatorit të kombinuar për gazin natyror (këtu dhe më poshtë “Rregullat e ERE-s mbi certifikimin”), dhe neni 15 i “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”.

Sipas nenit 10 të direktivës 2009/73/KE (këtu dhe më poshtë direktiva e gazit) dhe nenit 3 të rregullores (KE) nr. 715/2009 (këtu dhe më poshtë rregullorja e gazit), Sekretariatit i kërkohet të shqyrtojë vendimin paraprak dhe t’i japë ERE opinionin e tij në lidhje me pajtueshmërinë e këtij vendimi me nenet 9 dhe 10(2) të direktivës së gazit.

Në datën 11 korrik 2017 u zhvillua një seancë

dëgjimore për ndarjen e Albgaz sh.a. te zyrat e Sekretariatit në Vjenë me pjesëmarrjen e palëve të interesuara. Pas seancës dëgjimore, ERE paraqiti në Sekretariat dokumentet shtesë për të mbështetur vendimin paraprak.

Në datën 29 shtator 2017, Sekretariati mori një opinion për vendimin paraprak nga bordi rregullator i Komunitetit të Energjisë (këtu dhe më poshtë ECRB), siç kërkohet sipas nenit 3(1) të rregullores së gazit. Gjetjet dhe rekomandimet e Sekretariatit në opinionin e tij konsistojnë:

#### GJETJET DHE REKOMANDIMET E SEKRETARIATIT

Në këtë opinion Sekretariati ka theksuar se në vlerësimin e përputhshmërisë së vendimit paraprak të certifikimit me modelin e ndarjes sipas përcaktimeve në direktivën për të eliminuar një konflikt të mundshëm interesi midis transmetimit dhe aktiviteteve të tjera të kryera nga shoqëri të integruara vertikalisht është plotësuar më së miri me zbatimin e modelit të ndarjes të pronësisë sipas nenit 9 të direktivës së gazit, i cili është transpozuar në Shqipëri me nenin 36 të ligjit për sektorin e gazit natyror. Në opinionin e tij sekretariati konsideron se:

Mbi Aplikimin e dispozitave të ndarjes së pronësisë tek Albgaz sh.a.:

Kur vlerësohet pajtueshmëria e vendimit paraprak me modelin e ndarjes të vendosur në nenin 9 në direktivën e gazit, çështjet e mëposhtme kanë rëndësi në mënyrë të veçantë:

a) shoqëria që do të certifikohet, duhet të jetë zotëruese e asetëve të transmetimit, siç kërkohet nga neni 9(1)(a) i direktivës së gazit;

b) shoqëria që do të certifikohet, duhet të kryejë funksionet dhe detyrat e OST-së, siç kërkohet nga neni 9(1)(a) i direktivës së gazit; dhe

c) kontrolli dhe ushtrimi i të drejtave të shoqëria që do të certifikohet duhet të ndahet nga kontrolli mbi të drejtat e ushtruara në kompani të përfshira në aktivitetin e prodhimit ose furnizimit të gazit natyror dhe energjisë elektrike, siç kërkohet nga neni 9(1)-(3),(6),(7) dhe (12) i direktivës së gazit.

a) Zotërim i sistemit të transmetimit të gazit natyror

Neni 9(1)(a) i direktivës së gazit (transpozuar me nenin 36(1) të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”), kërkon që “çdo kompani e cila zotëron një sistem transmetimi të veprorë si Operator i Sistemit të Transmetimit”. Në parim, kjo nënkupton që



shoqëria e cila po aplikon për t'u certifikuar është zotërues i aseteve të transmetimit të gazit natyror, siç është sistemi i transmetimit të gazit natyror. Vetëm në raste të veçanta, Komisioni Evropian ka pranuar që në rastet kur OST-ja nuk e zotëron sistemin e transmetimit të drejtat për të menaxhuar sistemin i jepen OST-së përmes një kontrate qiradhënieje ose koncesionare, siç ndodh nëse këta tituj juridikë mund të shihen si dhënie e OST-së drejta ekuivalente me ato të zotëruesit.

Deri në datën e këtij opinioni nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar që Albgaz sh.a. është pronar *de jure* i të gjitha aseteve të transmetimit. Te vendimi paraprak, ERE doli në përfundimin se asetet e sistemit të transmetimit, më parë në zotërim të Albpetrol sh.a., iu transferuan Albgaz sh.a. sipas vendimit nr. 848. Megjithatë, afati përfundimtar për evidentimin e regjistrimit të aseteve u caktua data 30 shtator 2017. Në seancën dëgjimore, datë 11 korrik 2017, shoqëria Albgaz sh.a. shpjegoi që regjistrimi i pronësisë së aseteve të sistemit të transmetimit në emër të Albgaz sh.a. ishte në vazhdim dhe që nuk ishin marrë akoma certifikatat nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (kadastra) në emër të Albgaz sh.a. Në të njëjtën mënyrë te vendimi për fillimin e procedurave për licencimin e Albgaz sh.a., ERE theksoi që një pjesë e pronës që do t'i transferohej Albgaz sh.a., akoma “i përket Albpetrol sh.a. dhe pritet të regjistrohet në emër të Albgaz sh.a.”. Sekretariati u informua që certifikatat të cilat vërtetonin regjistrimin e zotërimit të aseteve të transmetimit të gazit natyror në emër të Albgaz sh.a. janë dhënë nga kadastra në muajin gusht 2017, pa dhënë akoma kopje të këtyre certifikatave siç iu është kërkuar.

Në të njëjtën kohë, Albgaz sh.a. konfirmoi në seancën dëgjimore që të gjitha asetet e sistemit të transmetimit janë të pasqyruara në bilanc si pronë e tij dhe parimisht shoqëria është e lejuar që të garantojë këtë të prirur për të kërkuar financim në kapitalin tregtar. Po kështu, kjo ndiqet edhe nga vendimet e MZHETTS-së se tubacionet e transmetimit, si dhe objektet dhe pajisjet që kanë të bëjnë me (siç janë stacionet e kompresimit dhe pajisjet e matjes), si dhe tokat dhe ndërtesat e tjera janë zbritur nga kapitali i shoqërisë Albpetrol sh.a. dhe u transferuan në kapitalin e autorizuar për shoqërinë Albgaz sh.a.

Duke marrë parasysh sa më sipër, Sekretariati

nuk ka arsye të dyshojë që asetet e sistemit të transmetimit të gazit menaxhohen dhe operohen nga shoqëria Albgaz sh.a. Po ashtu, Sekretariati kujton opinionin 3/17, ku u përmend që: “në rastet kur OST-ja ka marrë të gjithë hapat e nevojshëm për të regjistruar në mënyrë formale në kohë dhe sipas rregullave asetet që përbëjnë sistemin e transmetimit, plotësohet kërkesa e OST-së për të zotëruar sistemin e transmetimit”. Sekretariati bie dakord me ERE-n që në parim Albgaz sh.a. e përmbush kërkesën për zotërim të aseteve. Megjithatë, Sekretariati kërkon që ERE në vendimin përfundimtar të përfshijë detyrimin e shoqërisë Albgaz sh.a. për t'i raportuar çdo muaj ERE-s ecurinë e procedurës për regjistrimin e aseteve të transmetimit dhe ta përfundojë procedurën brenda gjashtë muajsh pas certifikimit.

b) Shoqëria që po aplikon, kryen detyrat kryesore të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

Neni 9(1)(a) i direktivës së gazit kërkon që kompania në fjalë “të veprojë si Operator i Sistemit të Transmetimit”. Koncepti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit përcaktohet nga nenet 2 dhe 4 të direktivës së gazit. Nga ky përkufizim kuptohet se elementet kryesore që një kompani të konsiderohet OST janë: funksionimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i rrjetit të transmetimit. Në këtë drejtim, Rregullatori duhet të vendosë në mënyrë të veçantë nëse shoqëria është në përputhje me ligjin dhe faktikisht po kryen detyrat kryesore të një OST-je dhe nëse ajo ka në dispozicion të saj burimet e nevojshme (njerëzore, teknike, financiare) për këtë qëllim.

Sekretariati nuk ka arsye për të dyshuar që Albgaz sh.a., përveçse është krijuar kohët e fundit, *de jure* dhe *de facto*, kryen detyrat kryesore të OST-së dhe ka në dispozicion burimet e nevojshme njerëzore, teknike dhe financiare për t'i kryer këto detyra.

Së pari, detyrat dhe përgjegjësitë e OST-së janë përcaktuar në nenin 41 të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, në përputhje me nenin 13 të direktivës së gazit. Për më tepër nga vendimi paraprak dhe dokumentet mbështetëse të Albgaz sh.a. kuptohet se Albgaz sh.a. është krijuar që në mënyrë të veçantë të kryejë aktivitetet e transmetimit të gazit natyror dhe që aktet sekondare të shoqërisë të mbulojnë elementet kryesore të performancës së tij si OST, duke përfshirë operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit.

Së dyti, Sekretariati e kupton që të gjitha



burimet teknike dhe shërbimet për të kryer aktivitetet e transmetimit të gazit janë transferuar nga Albpetrol sh.a. tek Albgaz sh.a. Në seancën dëgjimore të datës 11 korrik 2017, Albgaz sh.a. theksoi që ai ka 114 punonjës, të cilët Sekretariati i konsideron të mjaftueshëm për të kryer aktivitetet e transmetimit, në këtë fazë zhvillimi. Sekretariati bie dakord me ECRB-në që organigrami e shoqërisë Albgaz sh.a. mbulon të gjitha fushat funksionale që i jepen OST-së dhe që struktura e saj e kapitalit është e fortë.

Megjithatë, një funksion kryesor i OST-së konsiston në dhënie dhe mosdiskriminimin e aksesit të palëve të treta të përdoruesit e sistemit, përfshirë arkëtimin e tarifave të aksesit dhe tarifave të kongestionit. Ndërkohë që ky detyrim është transpozuar me nenin 42 të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, aktualisht shoqëria Albgaz sh.a. ka vetëm një klient për shërbimet e transmetimit, Albpetrol sh.a. Siç u bë e qartë në seancën dëgjimore, shërbimet nuk jepen sipas afateve kontraktuale dhe aktualisht nuk paguhen nga një tarifë rrjeti, pasi tarifa e përkohshme e transmetimit e vendosur nga ERE ka skaduar në datën 20 shtator 2017. Procedura për miratimin e metodologjisë së tarifave të transmetimit, e cila është parakusht për vendosjen e tarifave të reja, ka filluar nga ERE në datën 6 shtator 2017 dhe është miratuar me vendimin e bordit, nr. 178, datë 8.11.2017. Në seancën dëgjimore, Albgaz sh.a. shpjegoi që aktualisht shoqëria po negocion me Albpetrol sh.a. për një marrëveshje transmetimi e cila do të nënshkruhet me caktimin e tarifave të reja të transmetimit nga ERE. Për pasojë, aktualisht Albgaz sh.a. po i ofron shërbimet mbi baza të parregulluara, e cila nuk përputhet me ligjin e Komunitetit të Energjisë.

Në lidhje me këtë, Sekretariati e pranon që shoqëria Albgaz sh.a. sapo ka filluar të funksionojë dhe që tregu i gazit natyror në Shqipëri është shumë i kufizuar. Megjithatë, Sekretariati bie dakord me ECRB-në që aksesit i rregulluar i rrjetit dhe menaxhimi i tij nga OST-ja është një nga shtyllat qendrore të *acquis* (organ i të drejtave dhe detyrimeve të përbashkëta, i cili është detyrues për të gjitha shtetet anëtare të BE-së) të Komunitetit të Energjisë për gazin. Ai i kërkon ERE-s, si parakusht për nxjerrjen e vendimit përfundimtar, të sigurojë që metodologjia për transmetimin e gazit natyror të miratohet, si dhe të vendosen tarifatat për

shërbimet e Albgaz sh.a. (për të gjithë përdoruesit e mundshëm).

Lidhur me këtë shqetësim të Sekretariatit vërehet, se:

Bordi me vendimin nr. 82, datë 26.5.2017, ka vendosur për certifikimin paraprak të shoqërisë si operator i kombinuar i gazit natyror Albgaz sh.a., në mbështetje të neneve 37, 50, 59, 68 dhe 80 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe neneve 6, 7, 8, 9, 10, 11 të rregullave “Për certifikimin e operatorit të kombinuar për gazin natyror”, miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015, të bordit të ERE-s, dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016.

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), me vendim nr. 127, datë 16.8.2017, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a., në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.

Në vijim të seancës dëgjimore, në vijim të kërkesës me nr. 292 prot., datë 4.4.2017, për miratimin e draftkontratës së shërbimit të transmetimit të gazit natyror, shoqëria Albgaz sh.a. ka depozituar në ERE shkresën me nr. 81 prot., datë 24.8.2017, Protokolluar me tonën me nr. 167/16 prot., datë 24.8.2017 (informacion mbi kontratën e shërbimit të transmetimit të gazit natyror), e lidhur ndërmjet shoqërisë: Albgaz sh.a. dhe Albpetrol sh.a., përmes të cilës sqaron se:

Referuar vendimit ERE me nr. 90, datë 7.6.2017, “Për miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror”, shoqëria Albgaz sh.a. i ka faturuar shoqërisë: Albpetrol sh.a., për shërbimin e transmetimit të gazit natyror, nga muaji janar 2017 deri në muajin aktual, sasinë e gazit të transmetuar, sipas tarifës së përkohshme të miratuar me vendimin e mësipërcituar.

Marrëdhëniet financiare dhe faturimet përkatëse bazohen në kontratën e shërbimeve të transmetimit dhe të shpërndarjes të gazit natyror të dakordësuar ndërmjet dy shoqërive (kopje e kontratës me nr. 55/1 prot., datë 5.7.2017, për Albgaz sh.a. dhe me nr. 4608 prot., datë 6.7.2017, për Albpetrol sh.a. bashkëlidhur), si dhe në vendimin e bordit të ERE-s, me nr. 90, datë 7.6.2017, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a. për periudhën 5.1.2017 – 20.9.2017”, lënë në fuqi deri në 31.12.2017, me



vendimin e bordit të ERE-s me nr. 155, datë 28.9.2017, dhe do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të Albgaz sh.a.

Përditësimi dhe kompensimi i tyre do të bëhet në periudhën pasardhëse, bazuar në tarifën e përcaktuar nga ERE në pajtim me nenin 17, pika 1, germa “e” të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Të dyja shoqëritë kanë përgatitur kontratën për shërbimin e transmetimit të gazit natyror të lidhur ndërmjet palëve: Albgaz sh.a., me cilësinë e transmetuesit dhe shpërndarjes të gazit natyror dhe Albpetrol sh.a. me cilësinë e prodhuesit të gazit natyror, bazuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 9901, datë 1.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, ligjin nr. 7582, datë 13.7.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ligjin nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

Sasia e gazit shoqërues ose natyror do të livrohët nga prodhuesi te transmetuesi në pikat e livrimit në vendburimet prodhuese referuar infrastrukturës aktuale të transmetim-shpërndarjes së gazit, si më poshtë:

Delvinë, poligoni i matjes së gazit pranë pusit Del-4;

Cakran, poligoni i matjes së gazit në stacionin e kompresorëve Drenovë;

Frakull, poligoni i matjes së gazit pranë ish-stacionit të kompresorëve.

Sasia e gazit natyror, pas transmetimit, do të livrohët nga transmetuesi te prodhuesi në pikat e livrimit si më poshtë:

Për dekantimin *cash*, livrimi do të bëhet në poligonin e matjes pranë furrave;

Për dekantimin Visokë, livrimi do të bëhet në poligonin e matjes pranë furrave;

Për dekantimin konsumatorët privatë - Ballsh, livrimi do të bëhet në Stacionin e gazit Ballsh;

Për konsumatorët privatë - Fier, livrimi do të bëhet në stacionin e gazit Fier.

Duke marrë në konsideratë gjithë sa më sipër, bazuar në nenin 16 të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; seksioni I neni 35, 36, i ligjit 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; neni 8 i “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe

procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, ERE është në procesin e miratimit të kontratës së shërbimit të transmetimit të gazit natyror ndërmjet shoqërisë Albgaz sh.a. dhe Albpetrol sh.a.

Sa i takon metodologjisë së tarifave të transmetimit, siç ka rekomanduar edhe Sekretariati, tanimë ERE ka miratuar me vendimin e bordit të saj, nr. 178, datë 8.11.2017, metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror.

c) Ndarja e kontrollit mbi transmetimin nga gjenerimi/furnizimi

Vendimi paraprak vlerëson pajtueshmërinë e Albgaz sh.a. me modelin e ndarjes së pronësisë sipas nenit 36(5) të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, si dispozita për transpozimin e nenit 9(6) të direktivës së gazit. Neni 9(6) citon që dy organe të ndara publike mund të shihen si dy persona të veçantë sipas kuptimit të nenit 9(1) dhe (2) të direktivës së gazit, dhe mund të kontrollojnë aktivitetet e prodhimit dhe furnizimit, nga njëra anë, dhe aktivitetet e transmetimit nga ana tjetër. Koncepti i kontrollit përcaktohet më tej te rregullorja e BE-së dhe përfshin të drejtat e renditura në nenin 9(1)(b), (c) dhe (d) dhe (2) të direktivës së gazit, përfshirë kompetencat për të ushtruar të drejtat e votës, mbajtjen e shumicës dhe kompetencat për të emëruar anëtarët ose organet përgjegjëse të OST-së dhe ato që përfaqësojnë ligjërisht OST-në.

Sekretariati është dakord me ERE-n që MZHETTS-ja dhe MEI të përfaqësojnë aksionet e shtetit për respektivisht Albgaz sh.a. dhe Albpetrol sh.a., në përputhje me vendimin nr. 848, në parim të cilësohen si organe publike sipas nenit 9 (6) të direktivës së gazit.

Në mënyrë që të realizohet plotësisht qëllimi i nenit 9, direktiva e gazit - parandalimi i konfliktit të mundshëm dhe konfliktit aktual të interesit dhe sigurimi i ndarjes së kompanive që kontrollohen nga organet publike në mënyrë të barabartë me kompanitë private, neni 9(6) i direktivës së gazit nuk mund të interpretohet në mënyrë formale. Ndarja e kontrollit midis dy organeve publike në fjalë duhet të jetë efektiv në aspektin që ai siguron pavarësi të plotë të organit publik që kontrollon OST-në nga çdo shoqëri tjetër e cila kontrollon aktivitetet e gjenerimit dhe furnizimit.

Së pari, OST-ja dhe organet publike ose private



që e kontrollojnë atë, parimisht nuk mund të jenë të angazhuara në aktivitetet e gjenerimit dhe furnizimit.

Së dyti, autoritetit rregullator që i është dhënë detyra të certifikojë OST-në duhet të ushtrojë kontroll mbi kompanitë në fjalë në pronësi të shtetit, duke përfshirë këtu parandalimin e ndikimeve të zakonshme të ndërmarrjeve të treta publike ose private. Për këtë qëllim, organi publik që kontrollon OST-në duhet të ketë kompetenca të përcaktuara dhe paraqitura në mënyrë të qartë, duhet të ndjekë detyrat e caktuara nga Komuniteti i Energjisë dhe ligji në vend në pavarësi të plotë dhe nuk duhet të jetë i varur nga kompanitë publike ose private që kontrollojnë aktivitetin e gjenerimit ose furnizimit të energjisë elektrike.

Së treti, fakti që dy organet publike në fjalë mbeten pjesë e të njëjtës shoqëri të integruar vertikalisht, shteti mund të kërkojë masa të tjera mbrojtëse sipas organizimit të OST-së për të siguruar pavarësinë e plotë me vendimmarrjen e përditësuar. Në rastet kur një nga organet publike në fjalë po ashtu ushtron funksione vendimmarrëse, të cilat mund të ndikojnë ose kanë ndikuar në vendimmarrjen e OST-së, pavarësia e plotë mund të kërkojë futjen e masave organizuese shtesë tek organi publik i përfshirë.

Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk është i lidhur me aktivitetet e gjenerimit/furnizimit.

Dispozitat e ndarjes së pronësisë kërkojnë që OST-ja (ose organi që ushtron kontroll mbi të) të mos jetë i lidhur as me prodhimin, as me shitjen ose blerjen. Por janë të mundura edhe përjashtimet në rastet kur këto aktivitete janë “vërtet rastësore në aktivitetet thelbësore të një ndërmarrjeje ... dhe sasia e energjisë po ashtu është e parëndësishme.

Sekretariati nuk ka arsye të dyshojë që aktualisht Albgaz sh.a. nuk është i lidhur me ndonjë aktivitet tjetër që nuk ka lidhje me transmetimin dhe shpërndarjen e gazit natyror, dhe në mënyrë të veçantë në marrëdhëniet e prodhimit dhe ose furnizimit me gaz natyror, dhe që MZHETTS-ja nuk ushtron kontroll ose ndonjë të drejtë mbi një ndërmarrje e cila kryen funksionet e prodhimit ose furnizimit.

ii) Kompetencat dhe kontrolli janë të ndara në mënyrë efektive midis organeve publike të përfshira.

Sekretariati është dakord me ERE-n që në përgjithësi MZHETTS-ja dhe MEI të kenë

kompetencat dhe mjetet e nevojshme për të ushtruar kontroll mbi shoqëritë Albgaz sh.a. dhe Albpetrol sh.a. në mënyrë të pavarur juridikisht dhe faktikisht.

Ndarja e kompetencave midis ministrive

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 102(4), përmend që ministri “brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë”. Politika e shtetit përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, organi kolegjal që formon qeverinë. Kompetencat që i jepen ministrit, nga ana tjetër duket sikur bien në kompetencën ekskluzive të ministrisë.

Për më tepër, neni 3(5) i ligjit për administratën shtetërore përcakton që “sipas parimit të qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë, ndarja dhe caktimi i funksioneve dhe detyrave administrative midis organeve, institucioneve dhe njësisë administrative, duhet të jetë specifik, për të shmangur mbivendosjen, të jetë transparent dhe të bëhet publik në mënyrë të përshtatshme”. Sipas nenit 5 të të njëjtit ligj, Këshilli i Ministrave, bazuar në një propozim të Kryeministrit, përcakton fushën e veprimtarisë shtetërore në përgjegjësinë e çdo ministrie, ndërkohë që “ministri është përgjegjës para Këshillit të Ministrave dhe Parlamentit për tërësinë e veprimtarisë së ministrisë”. Sipas nenit 22 të ligjit “secili ministër është përgjegjës për mbikëqyrjen e veprimtarisë së ministrisë, të institucioneve në varësi dhe agjencive autonome brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë shtetërore”.

Me vendimin nr. 848, Këshilli i Ministrave caktoi kontrollin e MZHETTS-së si përfaqësuese ekskluzive e aksioneve të shtetit për shoqërinë Albgaz sh.a., ndërsa MEI u caktua organi që kontrollon asetet e shtetit për prodhimin e gazit natyror të menaxhuara nga Albpetrol sh.a. Vetë ministri përfaqëson ministrinë në takimet e asamblesë së përgjithshme të shoqërive. Siç është sqaruar te vendimi paraprak, si dhe gjatë seancës dëgjimore të datës 11 korrik 2017, kontrolli mbi kompanitë publike të shoqërive aksionare kryhet nga ministritë përgjegjëse që përfaqësojnë aksionet e shtetit sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, që do të thotë bazuar në ligjin e përgjithshëm të korporatave dhe jo te ligji publik. Për pasojë, të drejtat që rrjedhin nga aksionet e shtetit tek Albgaz sh.a., duke përfshirë të drejtat e





votës, ushtrohen *de jure*, nga MZHETTS-ja në mënyrë autonome dhe jo duke u influencuar nga MEI dhe anasjelltas, çka përputhet me nenin 9(1)(b) të direktivës së gazit.

Për më tepër, Sekretariati bie dakord që të dyja ministrinë janë *de jure* të pavarura në lidhje me emërimin e anëtarëve të organeve përkatëse të shoqërive të tyre respektive, siç kërkohet nga neni 9 (1) (c) i direktivës së gazit. Ndryshimet e ligjit për transformimin e ndërmarrjeve në pronësi të Shtetit, miratuar në datën 11 shkurt 2016, përcaktojnë se “ushtrimi i të drejtës së përfaqësuesve të pronës së shtetit, përfshirë të drejtën e emërimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës të kompanitë e sektorit të gazit natyror, duhet të bëhet sipas dispozitave të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”. Vendimi nr. 848 është miratuar sipas ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, duke urdhëruar MZHETTS-në dhe MEI-n që të emërojnë anëtarët e këshillave mbikëqyrës për ndërmarrjet në kontrollin e tyre. Për më tepër, sipas nenit 135 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, një nga të drejtat e asamblesë së përgjithshme (me MZHETTS-në aksionar i vetëm i Albgaz sh.a. dhe MEI-n e shoqërisë Albpetrol sh.a., dhe duke u përfaqësuar tek asambletë e përgjithshme nga ministrinë përkatëse) është emërimi dhe përjashtimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe këshillit administrativ. Si përfundim, statuti i Albgaz sh.a., po ashtu parashikon që asambleja e përgjithshme emëron anëtarët e këshillit mbikëqyrës. Duke pasur këto cilësi, të dyja ministrinë kanë miratuar vendime ku kanë emëruar anëtarët e këshillit mbikëqyrës për shoqëritë Albgaz sh.a. dhe Albpetrol sh.a. Sipas Statutit të shoqërisë Albgaz sh.a., Këshilli Mbikëqyrës duhet të emërojë administratorin (Drejtorin Ekzekutiv) të shoqërisë. Drejtori ekzekutiv i shoqërisë Albgaz sh.a. është emëruar nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë në datën 5 janar 2017. Sekretariati nuk ka arsye për të dyshuar që formimi i organeve mbikëqyrëse dhe administrative të shoqërive Albgaz sh.a. dhe Albpetrol sh.a. ka ndodhur ndryshe nga ajo që është parashikuar në ligjin e korporatës. Për më tepër, neni 9(1)(d) i direktivës së gazit ndalon që i njëjti person të jetë anëtar i të dy këshillave, i atij të furnizimit/gjenerimit dhe i OST-së të ketë konformuar përputhjen për rishikimin e vendimeve përkatëse për emërimin e këshillave mbikëqyrës dhe administratorëve të Albgaz sh.a. dhe Albpetrol

sh.a. Asnjë nga anëtarët e këshillave mbikëqyrës të Albgaz sh.a. dhe as drejtori ekzekutiv nuk vepron si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës dhe administrativ të shoqëria Albpetrol sh.a. dhe e kundërta.

Megjithatë, Sekretariati është në dijeni që të paktën dy anëtarë të këshillit mbikëqyrës së shoqërisë Albgaz sh.a. - zoti Tommy Kola dhe zoti Stavri Dhima - janë punësuar nga MEI në datën e emërimit të tyre si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës dhe akoma vazhdojnë të jenë të punësuar nga MEI deri në datën kur është nxjerrë ky opinion. Për më tepër, zoti Tommy Kola po ashtu është emëruar anëtar i këshillit mbikëqyrës të kompanisë OSHEE sh.a., një shoqëri e lidhur me aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

Sekretariati e konsideron këtë marrëveshje si pengesë për pavarësinë faktike dhe ndarjen e vërtetë të dy ministrive dhe shoqërive nën kontrollin e tyre, siç kërkohet nga neni 9(6) i direktivës së gazit. Veçanërisht faktin që MEI ushtron kontroll mbi kompanitë e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike, si dhe funksionet e politikëbërjes në sektorin e gazit natyror kanë nevojë për një ndarje strikte funksionale dhe personale të stafit të emëruar nga ministri nga strukturat drejtuese të korporatave që janë krijuar për të kontrolluar pavarësinë e operimit të sistemit të transmetimit.

Veçanërisht, emërimi i dy punonjësve të MEI-it nga MZHETTS-ja ngre dyshime për pavarësinë e MZHETTS-së në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Albgaz. Përfaqësimi i stafit të MEI-it të Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Albgaz, po ashtu krijon një rrezik të dukshëm të konfliktit të interesave, pasi këta anëtarë të stafit supozohet që të veprojnë në të njëjtën kohë, në interes të kompanisë OST, si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës dhe si një organ publik (MEI), e cila ushtron kontroll mbi kompaninë e prodhimit të gazit natyror (Albpetrol), si dhe në funksionet e politikëbërjes. Ky konflikt i interesit përfshin rrezikun e përdorimit të informacionit në secilin nga dy funksionet për funksionin tjetër. Duke marrë parasysh rëndësinë e rrezikut të konfliktit të interesit të këto funksione dyfishe, Sekretariati e konsideron deklaratën e ndarës së interesave të nënshkruar nga zoti Stavri Dhima si të pamjaftueshme.

Për më tepër, Sekretariati kujton që neni 9 (3) i direktivës së gazit kërkon që ndarja e pronësisë të



aplikohet edhe përmes tregjeve të gazit natyror dhe të energjisë elektrike, duke ndaluar influencat e përbashkëta mbi prodhuesin ose furnizuesin e energjisë elektrike dhe OST të gazit natyror. Në lidhje me këtë dhe në të njëjtën bazë, siç është përshtetur më sipër, Sekretariati e konsideron emërimin e zotit Tommy Kola te këshillat mbikëqyrës të OST-së për gazin natyror (Albgaz) dhe furnizuesit e energjisë elektrike (OSHEE) si një rast tjetër për rrezik të mundshëm të konfliktit të interesit.

Për pasojë, Sekretariati i kërkon ERE-s që të detyrojë Albgaz sh.a. dhe/ose MZHETTS-në që të zëvendësojë përfaqësuesit e MEI-it te Këshilli Mbikëqyrës i kompanisë me anëtarë të cilët nuk janë të punësuar te MEI ose te kompanitë e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike që kontrollohen nga ajo jo më vonë se një muaj pas miratimit të vendimit përfundimtar.

Lidhur me këtë kërkesë, ERE do të adresojë atë në dispozitivin e kësaj vendimmarrje.

Kompetencat e MEI-it në lidhje me shoqërinë Albgaz sh.a. sipas ligjit “Për sektorin e gazit natyror”

Te vendimi paraprak, ERE shpjegon kompetencat që ka MEI sipas ligjit për sektorin e gazit natyror, veçanërisht kompetencat që ndikojnë në vendimmarrjen nga Albgaz sh.a. që kanë lidhje me planifikimin dhe ndërtimin e rrjetit, të drejtën për t'i dhënë opinion ERE-s, kur kjo e fundit ushtron kompetencat e saj në lidhje me planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të OST-së (neni 46(10)) i ligjit “Për sektorin e gazit natyror”. Më tej, Sekretariati thekson që vendimi nr. 848, në mënyrë eksplicite përmend që MEI “ushtron të drejtat e saj te shoqëria Albgaz sh.a. sipas [ligji për sektorin e gazit natyror] dhe fushës përkatëse”. Direktiva e gazit, nga ana tjetër, kërkon që pronari i sistemit të transmetimit, që do të thotë OST-ja, është përgjegjës për të siguruar jetëgjatësinë afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme përmes planit të investimit, dhe e nxjerr këtë përgjegjësi në autonomi të plotë.

Të njëjtat çështje janë trajtuar nga Sekretariati tek opinioni 1/17 në lidhje me ndarjen e OST-së shqiptare për energjinë elektrike. Çështjet e Sekretariatit u diskutuan në seancë dëgjimore, të mbajtur në datën 11 korrik 2017.

Në lidhje me kompetencat e MEI-it sipas nenit 5 të ligjit për sektorin e gazit natyror, Sekretariati e

konsideron të një natyre të përgjithshme politike sesa një përfshirje specifike në aktivitetet dhe detyrat e OST-së.

Në lidhje me të drejtën e MEI-it për të propozuar miratimin (ose kundërshtimin) te Këshilli i Ministrave të ndonjë infrastrukture të re për energjinë që do të ndërtohet nga OST-ja përcaktuar në nenin 11 të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, MEI e shpjegoi te procedura për certifikimin e OST-së që rëndësia politike e këtij vendimi, veçanërisht në rastin e interkonektorëve që varen nga një marrëveshje midis dy shteteve sovraane. Sekretariati nuk ishte dhe akoma nuk është i bindur me këtë argumentim. Për të vazhduar akoma me tej influenca e MEI-it për ndërtimin e infrastrukturës në sektorin e energjisë elektrike, roli kryesor i MEI-it në procedurën e miratimit te Këshilli i Ministrave për sektorin e gazit natyror shtrihet deri te tubacionet për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit natyror, dhe jo vetëm ndërlidhësit, si dhe hapësirat e gazit natyror, pajisjet dhe instalimet. Kjo i jep MEI-it një ndikim gjithëpërfshirës mbi zhvillimin e infrastrukturës së gazit në vend, si dhe rëndësinë rajonale në dëm të pavarësisë së kompanisë OST mbi këto zhvillime si kërkohej nga *acquis* (organ i të drejtave dhe detyrimeve të përbashkëta, i cili është detyruar për të gjitha shtetet anëtare të BE-së) ligji evropian i energjisë i vendos detyrë vetëm OST-ja që të zhvillojë sisteme transmetimi të sigurt, të besueshme dhe eficiente, kjo nëpërmjet nenit 13(1)(a) të direktivës së gazit. Neni 2, nr. 4 i së njëjtës direktivë përcakton OST-në si “një person fizik ose juridik përgjegjës për [...] zhvillimin e sistemit të transmetimit në një zonë të caktuar dhe, kur është e aplikueshme, ndërlidhjet e saj me sistemet e tjera [...]”

Tek opinioni 1/17 për certifikimin e OST-së, Sekretariati shpjegon që ligji evropian në parim nuk e përjashton Këshillin e Ministrave dhe/ose Parlamentin që të përmbyllë marrëveshje ndërqeveritare me shtetet fqinje në fjalë për të drejtuar aspekte të caktuara, marrëdhënie dypalëshe të krijuara me zbatimin e këtij vendimi. Megjithatë, kompetenca e MEI-it dhe e Këshillit të Ministrave për të miratuar ndërtimin e tubacioneve të transmetimit të gazit natyror, ndërlidhësve dhe hapësirave të tjera të gazit natyror, pajisjeve dhe instalimeve prek pavarësinë e OST-së dhe organit që ushtron kontroll sipas ligjit përkatës,



MZHE'TTS-së. Për më tepër, Sekretariati kujton rastin e praktikës së Komisionit Evropian “kur një person që ka interesa në prodhimin dhe furnizimin me gaz, në të njëjtën kohë, ka një rol vendimtar nëse investimet e rëndësishme në infrastrukturën e gazit natyror mund të ecin përpara ose jo, nxitja e abuzimeve për kontrollin mbi investimet tek OST-ja për të favorizuar interesat e gjenerimit ose furnizimit, në këtë rast duke mbajtur konkurruesit e mundshëm jashtë tregut dhe duke ndaluar investimet”.

Sekretariati e konsideron që e drejta e MEI-it për të propozuar miratimin ose për të kundërshtuar zhvillimet në sistemet e transmetimit të gazit natyror të Këshilli i Ministrave nuk përputhet me direktivën, e cila e ndalon MEI-in që të ushtrojë “ndonjë të drejtë” mbi Albgaz sh.a. Kjo mospërputhje nuk është trajtuar nga ERE te vendimi paraprak dhe as nuk është dhënë ndonjë zgjidhje për masat përkatëse korigjuese. Në lidhje me këtë, Sekretariati vëren se te vendimi përfundimtar për procedurat e certifikimit të OST-së, datë 15 mars 2017, ERE konkludoi “që ky objektivi [për përputhjen] mund të arrihet përmes nxitjes së bashkëpunimit ndërinstitucional midis OST-së dhe Ministrisë së Ekonomisë, për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimin e kompetencave nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë tek aksionari i OST-së, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes. Sipas informacioneve të Sekretariatit, akoma nuk janë kryer këto ndryshime. Po ashtu Sekretariatit nuk i është dhënë asnjë provë që ky “bashkëpunimin ndërinstitucional” ka mundësi të sjellë një rezultat të dukshëm, i cili do të përmirësonte mospërputhjen e treguar më sipër pa miratimin, si një veprim parësor, për ndryshimet e nevojshme te legjislacioni primar, ligji “Për sektorin e gazit natyror”.

Për këtë arsye, Sekretariati i kërkon ERE-s, që në vendimin përfundimtar të kërkojë miratimin dhe hyrjen në fuqi të ndryshimeve të mundshme te neni 11 i ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, si kusht i cili pasohet me një periudhë të arsyeshme tranzitore në mënyrë që certifikimi të mbetet i vlefshëm.

Në lidhje me detyrimin e ERE-s për t'i kërkuar MEI-it opinionin në lidhje me planet dhjetëvjeçare të zhvillimit të rrjetit për shoqërinë Albgaz sh.a. para miratimit, si dhe ndonjë masë të marrë nga ERE në

kontekstin e monitorimit dhe për të siguruar përputhshmërinë me planin e miratuar (neni 46 (10) i ligjit “Për sektorin e gazit natyror”), MEI shpjegoi në seancën dëgjimore të datës 11 korrik 2017 që ajo ka njësi strukturore të veçanta që merren me politikën e funksionimit në lidhje me Albgaz sh.a. si OST dhe për të ushtruar të drejtat e aksionarit në lidhje me Albpetrolin dhe ndërmarrjet e prodhimit/furnizimit të energjisë elektrike, me drejtorë të ndryshëm të cilët varen nga Sekretari i Përgjithshëm i MEI-it. Me sa duket, çdo opinion sipas nenit 46 (10) të ligjit “Për sektorin e gazit natyror” duhet të përgatitet nga departamenti administrativ (për politikën e energjisë) brenda Ministrisë së Energjisë dhe jo nga departamenti që merret me të drejtat e aksioneve të MEI-it te ndërmarrjet shtetërore të energjisë. Megjithatë, Sekretariati mbetet i interesuar që MEI mund të jetë e njëanshme me kontrollin e saj mbi Albpetrol sh.a., si dhe ndërmarrjet e gjenerimit dhe furnizimit me energji elektrike kur jep një opinion të tillë dhe kjo njëanshmëri mund të ketë efekte negative në zhvillimin e rrjetit.

Për të siguruar pavarësinë e OST-së në planifikimin e transmetimit, Sekretariati në mënyrë të vazhdueshme propozon autorizimin e MZHE'TTS-së për t'i dhënë opinionin ERE-s në lidhje me planin e zhvillimit të rrjetit. Duhet të sqarohet përmes ndryshimeve të nevojshme legjislative që ministria përgjegjëse për energjinë nënkupton MZHE'TTS-në si “ministra pasardhëse përgjegjëse për sektorin e energjisë elektrike” sipas përkufizimit të bërë te ligji “Për sektorin e gazit natyror”.

Për më tepër, duhet të përcaktohet se MEI nuk ka të drejtë të ndërhyjë tek autonomia e OST-së mbi zhvillimin e rrjetit dhe planifikimin e investimit dhe që vendimet e nevojshme të aksionarëve merren në mënyrë ekskluzive nga MZHE'TTS-ja. Në lidhje me këtë, roli i MEI-it duhet të jetë i njëjtë me atë të çdo pale të interesuar në sektorin e gazit natyror dhe mund të shkojë përtej paraqitjes së propozimeve gjatë konsultimeve në lidhje me projektvendimet e ERE-s dhe/ose OST-së. Përveç kësaj do të ishte e nevojshme që ERE ta bëjë certifikimin e Albgaz sh.a. të varur nga ndryshimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 833 dhe 835, kështu që detyra që i është ngarkuar MEI-in në lidhje me Albgaz sh.a. t'i kalohet MZHE'TTS-së. Në këtë mënyrë, MZHE'TTS-ja, në cilësinë e



aksionarit të Albgaz sh.a., do të e autorizojë të ushtronte kompetencat për të marrë vendime mbi investimet sipas nenit 13(2)(a) dhe (b) të statutit të shoqërisë Albgaz sh.a.

Në lidhje me këtë, në mënyrë të përsëritur, Sekretariati thekson që nuk janë miratuar deri me tani ndryshimet sipas vendimit përfundimtar të ERE-s për procedurën e certifikimit të OST-së. Po ashtu Sekretariati nuk ka arsye që të presë për ndonjë rezultat të dukshëm, i cili do të përmirësojë mospërputhjen e treguar më sipër pa miratimin, si veprim parësor, për ndryshimet e nevojshme të legjislacionit primar, ligji për sektorin e gazit natyror, si dhe aktet sekondare që kanë lidhje me këtë.

Prandaj, Sekretariati përsëri i kërkon ERE-s që të vendimi përfundimtar të kërkojë transferim të plotë të detyrave në lidhje me aksionarin e vetëm të shoqërisë Albgaz sh.a., MZHE'TTS. Dhe për këtë qëllim, duhet të kërkojë miratimin dhe hyrjen në fuqi të ndryshimeve të nevojshme të ligji "Për sektorin e gazit natyror" dhe vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 833 dhe 835, si kusht i cili pasohet me një periudhë të arsyeshme tranzitore në mënyrë që certifikimi të mbetet i vlefshëm.

Lidhur me këtë kërkesë të Sekretariatit, ERE vëren se sikurse edhe në vendimin e certifikimit final të OST-së së energjisë për të shmangur konfliktin e mundshëm për shkak të ndikimit të MEI-it sipas përcaktimeve të ligjit të gazit, vendimi i certifikimit do të përfshijë, gjithashtu, detyrimin e Albgaz sh.a. për transferimin e plotë të detyrave që lidhen me OST-në, tek aksionari i saj i vetëm – pra të Ministria e Ekonomisë.

Lidhur me këtë opinion të Sekretariatit, vërehet se aktualisht kompetencat e Ministrit të Energjisë dhe Industrisë rregullohen në bazë të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", siç është specifikisht e shpjeguar edhe në paragrafët më lart në këtë vendim. Nga ana tjetër, duke qenë se Shqipëria ka ratifikuar Traktatin e Krijimit të Komunitetit të Energjisë dhe është palë kontraktuese e detyruar të ndërmarrë të gjitha hapat për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ky Traktat, është e tepër e rëndësishme marrja e masave për rregullimet e nevojshme në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë sektorin e energjisë në përputhje me direktivën 73/2009 të Parlamentit Evropian.

Duke marrë në konsideratë faktin se qëllimi kryesor i procesit të Traktatit të Komunitetit të

Energjisë është përgatitja e sektorit të energjisë të këtij rajoni për t'u integruar në tregun energjetik të BE-së nëpërmjet adoptimit dhe zbatimit të *Acquis Communautaire* në fushën e energjisë, si dhe duke konsideruar vendimin e Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë të datës 6.10.2011 në Chinsinau, Moldavi, sipas të cilit duke filluar prej 1 janarit 2015, paketa e tretë të energjisë është detyruese për të gjithë palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, ERE vlerëson nevojën e ndryshimeve në legjislacionin vendës mbi bazën e paketës së tretë legjislative të BE-së në fushën e energjisë (direktiva 2009/72/EC).

Roli i Kryeministrit

Neni 9(6) i direktivës së gazit natyror përjashton një organ të tretë publik, siç është Kryeministri ose, sipas rastit, Presidenti, në dhënien e udhëzimeve në lidhje me përgjegjësitë e dy organeve publike të caktuara për të kontrolluar kompanitë që kryejnë funksionet e OST-së dhe të gjenerimit/furnizimit. Në vendimi paraprak, ERE i trajton këto kompetenca, në mënyrë të veçantë kompetencën e Kryeministrit, si dhe limitet e tij në lidhje me secilën ministri, sipas parimeve kushtetuese të Shqipërisë, ndarjen e kompetencave të përcaktuara në legjislacionin në vend dhe çështjet ligjore të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë. Bazuar në shpjegimet e shumta dhënë nga ERE të vendimi paraprak dhe seanca dëgjimore e datës 11 korrik 2017, duke pasur parasysh opinionin 1/17 mbi certifikimin e OST-së, Sekretariati nuk ka arsye të dyshojë që konsiderimet e mësipërme jo vetëm do të përfshihen të ligji në vend, por po ashtu do të përfaqësojnë edhe realitetin kushtetues.

iii) Drejtimi i OST-së dhe organeve publike të përfshira në sektorin e energjisë elektrike lejojnë pavarësinë e plotë dhe vendimmarrjen e përditshme.

Neni 9(6) i direktivës së gazit nuk kërkon vetëm ndryshimet strukturore midis organeve publike të përfshira në sektorin e gazit, por edhe brenda vetë OST -ja dhe brenda organeve të veçanta publike për aq sa kjo kërkohet me arritjen e qëllimit të ndarjes së pronësisë, ndalimit të konfliktit aktual ose të mundshëm të interesit. Për ndarjen e kompanisë OST në pronësi të shtetit, pavarësia e plotë e funksionimit të rrjetit nga interesat e furnizimit dhe gjenerimit po ashtu kërkojnë masa që kanë të bëjnë mbi të gjitha me eliminimin e shkëmbimit të informacionit konfidencial gjatë



ditës. Duke pasur parasysh këtë, nenin 9(6) të direktivës së gazit, OST-ja vazhdon të funksionojë brenda shtetit si të ishte një kompani e integruar vertikalisht, kjo është shumë e rëndësishme. Prandaj, shteti duhet të marrë masa efektive për të parandaluar koordinimin e tepruar, sjelljet diskriminuese dhe shpërndarjen e panevojshme të informacionit konfidencial, duke përfshirë edhe stafin mbështetës dhe administratën. Deri në atë shkallë kur kërkohen masa më të detajuara kufizuese dhe duhet që, hap pas hapi, të vlerësohet mbikëqyrja në rritje e rregullatorit.

Masat mbrojtëse brenda OST-së

Vendimi paraparak bazohet shumë te rregullat e ERE-s për certifikimin, gjë që i bën të detyrueshme masa të caktuara, të cilat nënkuptojnë rritjen e pavarësisë funksionale të OST-së. Kjo përfshin nenin 8(1)(q) të rregullave të certifikimit, që kërkon ndalimin e shpërndarjes së informacionit konfidencial dhe informacionit të ndjeshëm tregtar që ka në zotërim OST-ja. Nenet 8(1)(p) (iii) të rregullave të ERE-s për certifikimin po ashtu kërkojnë që drejtuesit dhe përfaqësuesit e autorizuar të OST-së të deklarojnë interesat e tyre, duke deklaruar se këta persona nuk marrin pjesë të ndërmarrjet e energjisë elektrike të lidhura me prodhimin, shpërndarjen dhe/ose furnizimin me gaz natyror dhe/ose energji elektrike. Këto dy kërkesa u bënë një kusht eksplicit për vendimin paraparak të Albgaz sh.a. Për më tepër, Kodi i Etikës i shoqërisë Albgaz sh.a. shtjellon se si mbrohet informacioni konfidencial dhe informacioni i ndjeshëm tregtar (neni 16.3) dhe se si duhet të trajtohet konflikti i interesit (neni 16.8). Përveçse është i aplikueshëm për drejtuesit e Albgaz sh.a., Kodi i Etikës po ashtu aplikohet për të gjithë punonjësit e Albgaz sh.a., duke i detyruar ata që të respektojnë dispozitat për parandalimin e konfliktit të interesit dhe mbrojtjen e informacionit konfidencial.

Për më tepër, shtojca e rregullave të ERE-s për certifikimin, ndër të tjera kërkon që OST-ja të ketë një identitet tregtar të dallueshëm (markë) nga kompanitë e tjera, të jetë e regjistruar si një person juridik sipas ligjit në vend dhe ndalon përdorimin e IT-së, sistemeve të sigurisë dhe të aksesit, si dhe godinave të zëna nga OST-ja së bashku me kompanitë aktive të prodhimit dhe furnizimit. Ajo po ashtu ndalon që i njëjti ofrues të kontraktohet për t'u marrë me IT-në, shërbimet e aksesit dhe të

sigurisë. Pajtueshmëria e Albgaz sh.a. me këto kërkesa është vlerësuar te vendimi paraparak nga ERE.

Në përfundim, vendimi paraparak vlerëson pajtueshmërinë e Albgaz sh.a. në lidhje me kërkesën për auditim të pavarur të rezultateve financiare të kompanisë. Sipas ligjit për “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” audituesit financiarë të kompanive duhet të emërohen nga Asambleja e Përgjithshme që do të thotë MZHETTS në rastin e Albgaz sh.a. Kjo kërkesë është vendosur edhe në nenin 16.3(e) të statutit të Albgaz. Në seancën dëgjimore të datës 11 korrik 2017, MZHETTS-ja theksoi që Albgaz sh.a. është një shoqëri e pavarur nga ana financiare, pasi ajo nuk kërkon financim nga buxheti i shtetit. Sipas nenit 135, të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, MZHETTS-ja shpjegoi që, duke vepruar si aksionar i vetëm i shoqërisë Albgaz sh.a., ajo miraton planin financiar (të investimeve) për shoqërinë dhe pastaj bilancet auditohen nga auditues të pavarur.

Modeli i ndarjes së pronësisë nënkupton të sigurojë një situatë në të cilën diskriminimi mund të përjashtohet bazuar në strukturën e pronësisë së OST-së. Në rastet kur sipas nenit 9(6) të direktivës së gazit, ku kontrolli mbetet brenda strukturës së shtetit, mund të kërkohen masa të tjera të sjelljes për të siguruar funksionimin e pavarur të rrjetit. Ndërkohë që Sekretariati është dakord me vendimin paraparak të ERE-s që masat e përmendura më sipër janë mbështetëse për të ndaluar konfliktin e interesit dhe shpërndarjen e informacionit konfidencial, ai e konsideron atë të dobishëm përtej këtyre masave për t'i kërkuar Albgaz sh.a. që të zbatojë një program pajtueshmërie dhe të emërojë zyrtarin e pajtueshmërisë. Siç është theksuar nga Sekretariati dhe ECRB-ja në rastet e mëparshme “koncepti i [ndarjes së pronësisë në përputhje me nenin 9(6) të direktivës së gazit] duhet të shoqërohet me një pajtueshmëri strikte, duke paraqitur një monitorim rregullator raportues dhe të vazhdueshëm”. Sekretariati vë re që programi i pajtueshmërisë për OST-në është miratuar nga ERE sipas nenit 21 të direktivës së gazit dhe bie dakord me kërkesën shtesë të ERE-s për shoqërinë Albgaz sh.a. që ajo të emërojë zyrtarin e pajtueshmërisë sipas miratimit nga ERE brenda 3 muajsh pas vendimit përfundimtar dhe të hartojë dhe paraqesë në ERE raportin e kërkuar sipas programit të



pajtueshmërisë jo më vonë se 12 muaj pas nxjerrjes së vendimit përfundimtar.

Masat mbrojtëse brenda MEI-it

Fusha nën përgjegjësinë e MEI-it, Ministrisë së Energjisë përcaktohet te vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 833, ku përfshihet hartimi dhe zbatimi i politikave që kanë si qëllim fushën e përgjegjësisë shtetërore për sektorin e gazit natyror. Si një organ publik që ushtron kontroll në aktivitetet kryesore të prodhimit dhe furnizimit që kryhen nga Albغاز sh.a., si dhe ndërmarrjet e energjisë elektrike ekziston rreziku që MEI mund të jetë e njëanshme kur ushtron funksionet e saj të politikëbërjes.

Në seancën dëgjimore të datës 11 korrik 2017, MEI e ka shpjeguar edhe një herë ristrukturimin e saj të brendshëm, duke informuar që ajo ka njësi të veçanta strukturore (departamente) të cilat trajtojnë fushat e ndryshme që ato kanë në kompetencë, siç janë kompetencat administrative (siç është politikëbërja e gazit natyror në lidhje me Albغاز sh.a. si OST) dhe të drejtat aksionare (në lidhje me Albغاز sh.a. dhe shoqëritë e tjera të prodhimit/furnizimit) veçanërisht, drejtorë të ndryshëm që varen nga Sekretari i Përgjithshëm i MEI-it. Sikurse është shpjeguar edhe në opinionin 1/17 mbi certifikimin e OST-së, Sekretariati e shikon këtë të mjaftueshme me kushtin që Programi i Pajtueshmërisë të zbatohet nga shoqëria Albغاز sh.a. dhe po ashtu të mbulojë monitorimin e ndarjes së kompetencave brenda MEI.

Marrëdhëniet vertikale midis tregjeve të gazit natyror dhe energjisë elektrike

Sekretariati përsërit që neni 9(3) i direktivës së gazit, i cili kërkon që ndarja e pronësisë të aplikohet edhe në tregjet e gazit natyror dhe energjisë elektrike, në mënyrë që të ndalohen influencat e përbashkëta mbi gjeneruesin ose furnizuesin dhe OST-ja për gazin natyror ose prodhuesve, ose furnizuesve të gazit natyror dhe OST-ja për energjinë elektrike. Pajtueshmëria me këtë dispozitë nuk është trajtuar te vendimi paraprak. Kjo ka rëndësi për certifikimin e Albغاز sh.a., pasi shteti ka në pronësi të plotë OSHEE-në, një kompani e lidhur me shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë elektrike dhe KESH, gjeneruesin dhe tregtuesin e energjisë elektrike.

Duke marrë në konsideratë vendimin përfundimtar të ERE-s mbi certifikimin e OST-së dhe mënyrë të veçantë, duke parë që MZHETIS-ja, aksionarja e Albغاز sh.a., ushtron të drejtat e

korporatës së shtetit mbi OST-në për energjinë elektrike, ndërsa MEI, aksionarja e Albغاز sh.a., mbi kompanitë OSHEE dhe KESH, Sekretariati e konsideron këtë ndarje të mjaftueshme për të provuar mungesën parësore të marrëdhënieve vertikale midis tregjeve të gazit natyror dhe energjisë elektrike sipas kontekstit të procedurës aktuale të certifikimit.

Sekretariati e fton ERE-n që ta trajtojë te vendimi përfundimtar aplikimin e rregullave veçuese te sektorët e gazit natyror dhe energjisë elektrike, si dhe zbatimin e tyre në Shqipëri si më poshtë vijon.

A. Para se të marrë vendimin përfundimtar, të sigurojë që është miratuar metodologjia e tarifave për transmetimin e gazit natyror, si dhe që janë vendosur tarifat për shërbimet e Albغاز sh.a. (për të gjithë përdoruesit e mundshëm të sistemit).

Për këtë kërkesë janë dhënë shpjegimet më lart (faqe 57).

B. Të përfshijë te vendimi përfundimtar detyrimin e Albغاز sh.a. që të raportojë çdo muaj në ERE procedurën për regjistrimin e asetëve të transmetimit dhe ta përfundojë procedurën brenda gjashtë muajsh pas miratimit të vendimit përfundimtar.

Kjo kërkesë e Sekretariatit do të adresohet në dispozitivin e vendimit bazuar në të drejtën e ERE-s për të monitoruar kërkesat që lidhen me kompaninë e certifikuar.

C. Të përfshijë te vendimi përfundimtar detyrimin e Albغاز sh.a. dhe/ose MZHETIS-së për të zëvendësuar përfaqësuesit e MEI-it te këshillat mbikëqyrës të shoqërive me anëtarë të cilët nuk janë punësuar nga MEI ose kompani të prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike që kontrollohen nga ajo jo më vonë se një muaj pas miratimit të vendimit përfundimtar.

Për qëllime të sigurimit të shmangies së kontrollit nga MEI përmes anëtarëve të organeve drejtuese të OST-së, ERE vlerëson të drejtë kërkesën për të zëvendësuar përfaqësuesit e MEI-it te këshillat mbikëqyrës të shoqërive me anëtarë të cilët nuk janë punësuar nga MEI ose kompani të prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike që kontrollohen nga ajo jo më vonë se një muaj pas hyrjes në fuqi të miratimit të vendimit përfundimtar.

D. Të përfshijë te vendimi përfundimtar kërkesën për miratimin dhe hyrjen në fuqi të



ndryshimeve të nevojshme në nenin 11 të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, si një kusht i cili pasohet me një periudhë të arsyeshme tranzitore në mënyrë që certifikimi të jetë i vlefshëm.

Në lidhje me këtë kërkesë të Sekretariatit, siç edhe shpjeguar më lart, ERE konkludon se diçka e tillë mund të realizohet nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit ndërinstitucional të OST-së dhe të Ministrisë së Ekonomisë për realizimin e ndryshimeve ligjore dhe nënligjore që lidhen me transferimin e kompetencave të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë tek aksionari i OST-së, Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

E. Të përfshijë te vendimi përfundimtar kërkesën për të transferuar detyrat që i takojnë Albgaz sh.a., aksionarit të tij të vetëm MZHETIS-së dhe për këtë qëllim kërkesën për të miratuar dhe hyrë në fuqi të ndryshimeve të nevojshme të ligji për sektorin e gazit natyror dhe vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 833 dhe 835, si kusht i cili pasohet me një periudhë të arsyeshme tranzitore që certifikimi të mbetet i vlefshëm.

Siç shpjeguar edhe më lart, ERE vlerëson nevojën e ndryshimeve në legjislacionin vendës mbi bazën e paketës së tretë legjislative të BE-së në fushën e energjisë (direktiva 2009/72/EC). Sa kërkuar të përfshihet në dispozitivin e këtij vendimi.

F. Të trajtojë te vendimi përfundimtar aplikimin e rregullave të ndarjes të sektorit të gazit natyror dhe energjisë elektrike, si dhe zbatimin e tyre në Shqipëri.

Lidhur me këtë kërkesë të Sekretariatit, bordi i ERE-s konsideron se pavarësia ligjore dhe funksionale e Albgaz sh.a. dhe sigurimi i respektimit të gjithë kuadrit ligjor në fuqi për këtë qëllim, është i parashikuar në ligjin nr. 102 /2015, “Për sektorin e gazit natyror”. Konkretisht, referuar nenit 3 të këtij ligji, Operatori i Sistemit të Transmetimit është struktura përgjegjëse e licencuar për operimin, organizimin dhe menaxhimin e sistemit të transmetimit.

Pra, nga analiza e këtyre dispozitave rezulton se OST-ja është konsideruar si një strukturë e pavarur dhe e licencuar më vete për të kryer aktivitetin përkatës, pikërisht për të siguruar transparencë dhe për të evituar ndërvarësinë nga pjesëmarrësit tjerë të tregut. Në këtë kuadër, Operatori i Sistemit të Transmetimit është evidentuar si një prej pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, i cili

ashtu sikurse pjesëmarrësit e tjerë, merr pjesë në tregun e energjisë elektrike vetëm për qëllim të sigurimit të energjisë së nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet, balancimin dhe shërbimet ndihmëse.

Nga ana tjetër, funksionimi i tregut të gazit është parashikuar se do të kryhet në përputhje me rregullat e tregut objekt i miratimit nga ERE, proces ky gjatë të cilit ERE bashkëpunon me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të gazit natyror (megjithëse propozohen nga OST-ja).

Për më tej, ashtu sikurse parashikohet në nenin 54 të ligjit, por edhe në parashikimet e direktivës 2009/73/EC, ndarja dhe pavarësia e OST-së, me qëllim certifikimin e OST-së, kupton ushtrimin e veprimtarisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit i ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, si: prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike.

Në bazë të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, Albgaz sh.a. ushtron veprimtarinë e saj të ndarë nga veprimtaritë e tjera në sektorin e gazit, si: prodhimi, tregtimi dhe furnizimi me gaz natyror, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

Aktualisht, MEF-ja (Ministria e Ekonomisë dhe Financës) rezulton aksionar i vetëm i Albgaz sh.a. me kapital 100% shtetëror, siç është përcaktuar në VKM-në nr. 848, datë 7.12.2016. “Për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që për përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të Albpétrol sh.a. dhe Albgaz sh.a.”. Në këtë mënyrë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ushtron kontroll të drejtpërdrejtë, në cilësinë e pronarit për Albgaz sh.a.

Pra, nga sa më sipër, si dhe duke qenë se aktiviteti i operatorit të kombinuar zhvillohet nga Albgaz sh.a. në formën e shoqërisë tregtare (shoqëri aksionare shtetërore), konkludohet se autoriteti i përmendur më lart kryen funksionin e Asamblesë së Aksionarëve për shoqërinë Albgaz sh.a., duke marrë çdo vendim që ka në kompetencë Asambleja e Aksionarëve në një shoqëri aksionare, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

Në këtë kontekst, vlen të theksojmë edhe njëherë se Ministria e Energjisë dhe Ministria e



Ekonomisë dhe Financave janë dy institucione/organe të larta të administratës shtetërore të organizuara sipas ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”. Në bazë të ligjit nr. 90/2012, secila prej këtyre ministrive kryen të gjitha funksionet administrative brenda fushës përkatëse të përgjegjesisë shtetërore. Konkretisht, fusha përkatëse e përgjegjesisë për Ministrinë e Industrisë dhe e Energjisë është përcaktuar në vendimin nr. 504, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, ndërsa për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë fusha e përgjegjesisë është përcaktuar nga vendimi nr. 503, datë 13.9.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”.

Për më tepër, për sa i përket Albgaz sh.a., sipas VKM-së 848, datë 7.12.2016, Ministria e Energjisë ushtron të drejtat mbi Albgaz sh.a. në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe në përputhje me fushën e saj të përgjegjesisë shtetërore.

Ndërkohë, në bazë të nenit 36, në pikën 2 të ligjit, përcaktohet se për të siguruar pavarësinë e Albgaz sh.a., i njëjti person ose të njëjtët persona nuk kanë të drejtën, që njëkohësisht:

a) të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një të licencuar, që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo të furnizimit të gazit natyror e të energjisë elektrike, dhe të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen ose ndonjë të drejtë tjetër ndaj Operatorit të Sistemit të Transmetimit apo rrjetit të transmetimit;

b) të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen apo të ushtrojnë ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo të furnizimit të gazit natyror dhe të energjisë elektrike;

c) të emërojnë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht Operatorin e Sistemit të Transmetimit apo rrjetin e transmetimit dhe, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen apo ndonjë të drejtë mbi një të

licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo të furnizimit të gazit natyror dhe të energjisë elektrike;

ç) të jenë anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose të furnizimit të energjisë elektrike e të gazit natyror dhe veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të transmetimit.

Po kështu, në dispozitat vijuese të po këtij këtij neni, përcaktohet se:

4. Ndalimet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të paragrafit me sipër do të zbatohen në mënyrë të veçantë për:

a) kompetencën për të ushtruar të drejtën e votës;

b) kompetencën për të emëruar anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë të licencuarin;

c) të drejtën e mbajtjes së një pjese të shumicës së aksioneve.

5. Detyrimi i parashikuar më sipër, konsiderohet se është përmbushur nëse dy ose më shumë shoqëri, të cilat kanë rrjetet e tyre të transmetimit, kanë krijuar një sipërmarrje të përbashkët, e cila vepron si një Operator i Sistemit të Transmetimit në dy ose më shumë shtete. Asnjë shoqëri tjetër nuk mund të jetë pjesë e kësaj sipërmarrjeje të përbashkët, përveç rastit kur shoqëria është përcaktuar si operator i pavarur i sistemit të transmetimit dhe është certifikuar sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

6. Kur personi i përmendur në paragrafin më sipër është një organ publik që kontrollohet nga shteti, atëherë dy organe të veçanta publike që ushtrojnë kontroll, njëri mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe tjetri mbi të licencuarin që kryen funksionin e prodhimit ose të furnizimit të energjisë elektrike, do të konsiderohen sikur nuk janë i njëjti person.

Pra, konkretisht, ashtu siç evidentohet më lart, në bazë të VKM-së nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a.” dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të Albpetrol sh.a. dhe Albgaz sh.a., rezulton se Ministria e Ekonomisë është mbajtëse e 100% të aksioneve të Albgaz sh.a., ndërkohë që MIE është 100% aksionare e Albpetrol sh.a. të cilat ushtrojnë përkatësisht





aktivitetin e operatorit të kombinuar të gazit natyror dhe prodhimit të gazit natyror.

Në këtë mënyrë, për qëllime të ndarjes së pronësisë së Albgaz sh.a. sipas rekomandimit të Sekretariatit, ERE konsideron se kjo ndarje rezulton se është kryer sipas parashikimeve të nenit 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe në përputhje me rregulloren e certifikimit, ku përcaktohet se, ndër kriteret që duhet të përmbushen nga aplikuesi për të mundësuar vendimmarrjen dhe certifikimin, është detyrimi që personi juridik që ka pronësinë mbi operatorin e kombinuar të gazit natyror nuk duhet të ketë të drejta kontrolli të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në aktivitetet e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit apo anasjelltas.

Përpos nevojës për të shtjelluar dhe për të monitoruar më tej çështjet e renditura më sipër, për qëllim të certifikimit të OST-së, Sekretariati në opinionin e tij ka gjetur me vend t’i rekomandojë ERE-s që t’i imponojë disa kushte shtesë OST-së.

Në përfundim, Sekretariati mbështet certifikimin e Albgaz sh.a. në përputhje me vendimin paraprak të ERE-s, duke iu nënshtruar vërejtjeve të mësipërme të cilat janë adresuar në paragrafët më sipër në këtë vendim.

Sipas nenit 11, pika 5, të rregullores për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror, në referencë të sa më sipër parashtruar, ERE duke marrë në konsideratë edhe opinionet e mësipërme të Sekretariatit, ka vendosur adresimin e tyre në vendimin përfundimtar në lidhje me certifikimin e Albgaz sh.a.

Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 242/1, datë 13.7.2017, në lidhje me certifikimin paraprak të shoqërisë Albgaz sh.a. është shprehur me vendimin nr. 469, datë 11.7.2017, si më poshtë:

T’i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë të dizenojë dhe të çojë për miratim pranë Këshillit të ministrave, modelin dhe rregullat e tregut të gazit natyror.

Të parashikojë ndarjen e llogarive për secilën veprimtari.

Në lidhje me këtë vendim të Autoritetit të Konkurrencës, ERE sqaroi këtë të fundit si më poshtë:

Neni 88, pika 1, e ligjit 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ka parashikuar se:

Ministri përgjegjës për energjinë, në bashkëpunim me palët e interesuara në sektorin e

gazit, ERE-n dhe Autoritetin e Konkurrencës, harton modelin e tregut të gazit, i cili miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Në zbatim të kërkesave të ligjit sa më sipër, MEI në bashkëpunim me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, kanë përgatitur projektvendimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modelit të tregut të gazit natyror”. Me shkresë nr. 3667 prot, datë 3.5.2017, depozituar në ERE me nr. 368 prot., datë 4.5.2017, ky projektvendim i është dërguar ERE-s në cilësinë e palës së interesit për të shprehur opinion. Bashkëlidhur është dërguar një kopje e këtij dokumenti mbi të cilin janë ftuar të japin opinion si ERE ashtu edhe Autoriteti i Konkurrencës, në cilësinë e palëve të interesit dhe jo hartuesve të modelit të tregut.

Në lidhje me rekomandimin e dytë sqarojmë se:

Në nenin 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, parashikohet se parashikimet e neneve 36 e 50, pika 2, të këtij ligji, nuk përjashtojnë operimin e kombinuar të sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes, të impianteve të GNL-ve dhe të impianteve të depozitimit nga një operator i vetëm, i cili duhet të jetë i pavarur nga pikëpamja ligjore, organizative dhe e vendimmarrjes, nga veprimtari të tjera, që nuk lidhen me operimin e sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes, të impianteve të GNL-së dhe impianteve të depozitimit. Sistemi i transmetimit të operatorit të kombinuar duhet të certifikohet në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Sqarojmë se shoqëria Albgaz sh.a. ka kryer këtë aplikim në ERE mbështetur në VKM-në nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a.” dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Albpetrol sh.a. dhe Albgaz sh.a., e cila përcakton se: “Me regjistrimin në QKB, shoqëria Albgaz sh.a., të aplikojë pranë Entit Rregullator të Energjisë për certifikim, si operator transmetimi, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 37, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe për pajisjen me licencë për transmetimin e shpërndarjen e gazit natyror, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet 22, 23 dhe 24, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Shoqëria Albgaz sh.a. ka plotësuar formularin e ndarjes së pronësisë (*Ownership Unbundling*). Në bazë të neneve 37, 50, 59, 68, dhe 80, të ligjit nr.



102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, operatori i kombinuar ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga veprimtaritë e tjera në sektorin e gazit natyror, që nuk lidhen me operimin e sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes së impianteve të GNL-së dhe impianteve të depozitimit. Për sa përcahtuar në pikën 3, të VKM-së nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a. dhe përcahtimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të shoqërive të sektorit të gazit natyror”, si dhe VKM-së nr. 503 datë 13.9.2017, tanimë rezulton aksionar i vetëm i Albgaz sh.a. me kapital 100% shtetëror MFE (Ministria e Financave dhe Ekonomisë).

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.11.2017,

#### VENDOSI:

1. Miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të kombinuar të gazit natyror Albgaz sh.a., në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68, dhe 80 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 73/2009 EC.

2. Brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Albgaz sh.a. të zëvendësojë përfaqësuesit e MIE te Këshilli Mbikëqyrës i kompanisë me anëtarë të cilët nuk janë të punësuar te MIE ose te kompanitë e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike që kontrollohen nga ajo.

3. Albgaz sh.a. të raportojë çdo muaj në ERE procedurën për regjistrimin e asetëve të transmetimit dhe ta përfundojë procedurën brenda gjashtë muajve pas miratimit të vendimit përfundimtar.

4. Brenda 3 muajve pas miratimit të vendimit të certifikimit, Albgaz sh.a. të caktojë zyrtarin e përputhshmërisë subjekt i miratimit nga ERE, si dhe duhet që të hartojë dhe t'i dorëzojë ERE-s, raportin e përcahtuar sipas programit të përputhshmërisë, rregullatore jo më vonë se 12 muaj nga miratimi i vendimit të certifikimit të Albgaz sh.a., konform përcahtimeve të nenit 21 të direktivës nr. 73/2009, të Komisionit Evropian, “Mbi rregullat për tregun e gazit natyror” dhe nenit 47, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

5. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për qëllime të implementimit të rekomandimeve në opinionin e Sekretariatit, Albgaz sh.a., të paraqesë në ERE dëshmi që

tregon garancinë, në lidhje me:

5.1 Pavarësinë e audituesve financiarë. Audituesi financiar i Albgaz sh.a. duhet të jetë i pavarur, në kuptimin që audituesi financiar nuk mund të jetë i njëjti subjekt që kryen detyra ose kryen auditimin e ndërmarrjeve/sipërmarrjeve që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo të furnizimit të gazit natyror. Në lidhje me këtë çështje, Albgaz sh.a. duhet t'i kërkojë Asamblesë së Përgjithshme (MEF) sigurimin e shmangies së emërimeve të audituesve financiarë të njëjtë.

5.2 Bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe 46(10) i ligjit “Për sektorin e gazit natyror” dhe transferimi i kompetencave te Ministria e Ekonomisë. Për përmbushjen e këtij detyrimit, Albgaz sh.a. do t'i paraqesë ERE-s provat dokumentare që ndryshimet ligjore dhe nënligjore të nevojshme që lidhen me transferimin e kompetencave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë tek aksionari i Albgaz sh.a., Ministria e Ekonomisë dhe Financave, kanë ndodhur, janë efektive.

6. Mospërmbushja e detyrimeve të përshkuara në pikat 2, 3, 4 me sipër nga ana e Albgaz sh.a. sjell si pasojë rihapjen e procedurës së certifikimit në përputhje me nenin 14 të “Rregullave për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror”.

7. Albgaz sh.a., do të raportojë çdo 3 muaj tek ERE dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të pikave 2, 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi, si dhe me ecurinë e procesit të transferimit të kompetencave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë te Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

8. T’ia përcjellë këtë vendim Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

9. T’ia përcjellë këtë vendim OST sh.a., Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetit të Konkurrencës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**

Nr. 180, datë 8.11.2017

**MBI MIRATIMIN E “METODOLOGJISË  
SË LLOGARITJES SË TARIFAVE TË  
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16; 19, germa “b”; 20, germa “a”; 108 dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë. 17.6.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, për miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të Energjisë Elektrike”,

konstatoi se:

- Drejtoritë teknike në bashkëpunim me konsulencën e USAID-it përgatitën dhe paraqitën në bord, në muajin shtator 2017, draftin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 157, datë 28.9.2017, miratoi fillimin e procedurave për miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”.

- Me shkresën nr. 100/49 prot., datë 2.10.2017, ERE ka publikuar me median e shkruar, njoftimin për fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”.

- Me shkresën nr. 651 prot., datë 4.10.2017, ERE njoftoi OST sh.a., OSHEE sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës, Avokatin e Popullit, Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorëve, Shoqatën e Mbrojtjes së Konsumatorit Shqiptar, Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Konfederatën e Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, Konfindustrian, AAES, AREA, FIAA, ACERC dhe Shoqatën e Prodhuesve të Vegjël të Energjisë Elektrike për fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike dhe u kërkoi të paraqesin opinionet apo komentet e tyre në lidhje me këtë metodologji.

- OST sh.a., me shkresën nr. 5316/1 prot., datë 13.10.2017, paraqiti në ERE komentet lidhur me

draftin e propozuar të metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike, të cilat u diskutuan edhe në seancën dëgjimore të zhvilluar në ERE, në datën 20.10.2017. Komenti i OST-së për përjashtimin e faturimit të energjisë reaktive, u pranua duke u hequr edhe nga metodologjia e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të miratojë “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI  
Petrit Ahmeti**

**METODOLOGJIA  
E LLOGARITJES SË TARIFAVE TË  
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Neni 1

**Baza ligjore**

Kjo metodologji hartohet në zbatim të neneve 7, 19, 20, 21, 22, 35, 45, 46, 53, 54, 56, 60, 62, 65, 66 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, VKM-në nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, nenet 21 dhe 22 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Rregullave të Tregut (të përkohshme), Kodit të Matjes, Kodit të Transmetimit, si dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga ERE.

Neni 2

**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj metodologjie është përcaktimi parimeve, kushteve dhe procedurave të tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit mbi bazën e



parimeve të llogaritjes së këtyre tarifave, duke vlerësuar të dhënat e domosdoshme për një tarifë të drejtë.

### Neni 3 Objektivi

Kjo metodologji ka për objektivi përcaktimin e tarifave të përdorimit të sistemit të transmetimit në zbatim të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

### Neni 4 Përkufizime

Termat e përdorur në këtë metodologji kanë të njëjtin kuptim si ai i përshtuar në nenin 3 e në vazhdim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe çdo akt tjetër nënligjor të miratuar nga ERE. Termat e tjerë të përdorur në këtë metodologji kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. “Faktori i axhustimit vjetor”, një përqindje e barabartë me faktorin e inflacionit minus faktorin e përmirësimit të eficiencës.

2. “Tarifa mesatare e transmetimit”, e ardhura mesatare për kwh e reflektuar në faturat e përdoruesve të sistemit të transmetimit për një periudhë 12-mujore, e llogaritur si e ardhura totale nga pagesat që lidhen me kapacitetin, pagesat që lidhen me energjinë dhe pagesat mujore fikse, pjesëtuar me kwh total të livruara nga sistemi i transmetimit në kompanitë e shpërndarjes dhe përdoruesit e tjerë të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike që ndodhen në Shqipëri.

3. “Tarifa mesatare tavan e transmetimit”, niveli maksimal i lejueshëm i tarifës mesatare të transmetimit për një periudhë specifike 12-mujore.

4. “Tarifa bazë”, vlera e tarifës së shërbimit të transmetimit e përcaktuar në përputhje me kostot në vitin bazë.

5. “Viti bazë”, viti i parë i periudhës rregullatore

6. “Viti i testimit”, një periudhë 12-mujore përpara periudhës rregullatore, e cila përdoret si bazë e përcaktimit të të ardhurave të kërkuara për vitin bazë për Operatorin e Sistemit të Transmetimit.

7. “Tarifat e diferencuara”, tarifat për shërbimet e përdoruesve të rrjetit të transmetimit që përfshijnë pagesat që lidhen me kapacitetin, pagesat që lidhen me energjinë, pagesat mujore fikse dhe pagesat për energjinë reaktive të lidhura në nivelet respektive të tensionit.

8. “Faktori i përmirësimit të eficiencës (faktori X)”, përqindja vjetore e reduktimit në koston e shërbimit të transmetimit që rezulton nga përmirësimet në eficiencën e prodhimit dhe përmirësimet në teknologji.

9. “Baza e rregulluar e aseteve (RAB)”, vlera e aseteve fikse në pronësi të OST-së që përdoren për të siguruar shërbim për klientët e transmetimit dhe për të plotësuar detyrimin e OST-së për të siguruar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e sistemit elektrik. Baza e rregulluar e aseteve nuk përfshin investimet financiare, letrat me vlerë, llogaritë për t’u marrë ose paratë *cash*.

10. “Periudha rregullatore”, periudha për të cilën tarifat e reja hyjnë në fuqi dhe rregullohen sipas vendimit të marrë nga Enti Rregullator i Energjisë, pas një shqyrtimi të plotë dhe të detajuar të aplikimit të tarifave të paraqitura nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.

11. “Sistemi i shpërndarjes”, sistemi i shpërndarjes është sistemi i linjave, strukturave mbështetëse, pajisjeve transformuese dhe kyçëse/shkyçëse, të përdorura për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe livrimin e saj te klientët, pa përfshirë furnizimin.

12. “Konsumi i energjisë elektrike për qëllime teknologjike”, konsumi i forcës reaktore, konsumi i kompensatorit sinkronizues, konsumi i baterisë së kondensimit dhe energjia që konsumohet nga OST-ja për përdorimin e vet dhe që merret direkt nga nënstacionet e transformimit dhe facilitetet në pronësi të sistemit të transmetimit. Humbjet në rrjet përjashtohen. Energjia e konsumuar nga stacionet gjeneruese përjashtohet.

13. “Matësi i energjisë elektrike”, një mekanizëm për matjen e fluksit të energjisë aktive dhe reaktive dhe energjisë brenda rrjetit të transmetimit ose matja e fluksit të energjisë elektrike aktive dhe reaktive dhe energjisë përmes kufijve ndërkombëtarë ose matja e energjisë elektrike aktive dhe energjisë elektrike të livruar te klientët e sistemit të transmetimit.

14. “Klienti” është një klient shumice ose fundor i energjisë elektrike.

15. “Klienti fundorë” është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak.

16. “Enti Rregullator i Energjisë” është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015 dhe ligjin nr.



102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

17. “Kodi i transmetimit”, Kodi i Sistemit të Transmetimit është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë operimin e sistemit të transmetimit, si dhe përcaktojnë kushtet e shërbimit që ofrohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit, në përputhje me rregullat e ENTSO-E.

18. “Humbjet në rrjet”, diferenca mes sasisë së energjisë elektrike të livruar në rrjetin e energjisë elektrike dhe sasisë së energjisë elektrike të tërhequr nga rrjeti i energjisë elektrike gjatë periudhës kohore respektive.

19. “Sistemi i transmetimit”, sistemi i transmetimit të energjisë elektrike është sistemi i përdorur për transmetimin e energjisë elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur në paralel me sistemet e vendeve të tjera, që përfshin midis të tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/shkyçëse për livrimin e energjisë elektrike te klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshirë furnizimin.

20. “Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) ose “OST”” është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.

21. “Përdoruesit e sistemit” janë personat fizikë ose juridikë, të cilët i furnizon ose furnizohen me energji elektrike nëpërmjet sistemit të transmetimit ose të shpërndarjes.

#### Neni 5

#### Rregullat e përgjithshme dhe parimet bazë

1. Kjo metodologji është hartuar në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të akteve të tjera ligjore që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2. Të gjitha burimet e të ardhurave të OST-së të përcaktuara në këtë metodologji tarifash paguhen nga përdoruesit e sistemit të transmetimit.

3. Pagesat e lidhjes me sistemin e transmetimit për përdoruesit e sistemit të transmetimit nuk janë objekt i kësaj metodologjie. Pagesat e lidhjes do të caktohen në bazë të rregullores së lidhjeve të reja e cila përmban edhe metodologjinë e llogaritjes së kostove të tyre dhe janë jashtë objektit të kësaj metodologjie tarifash. Asetet e financuara

nëpërmjet pagesave të lidhjes nuk përfshihen në asetet bazë të rregulluar të OST-së dhe amortizimi i këtyre asetëve fikse mund të mos mbulohet nga tarifa e transmetimit.

4. Tarifa e transmetimit duhet të shlyejë koston e aktivitetëve të mëposhtme:

a) Pronësinë, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjave, kabllove, nënstacioneve të transformatorëve, qendrave dispecer dhe ndërtesave që lidhen me to, si dhe facilitetet e komunikimit

b) Kostoja e shërbimeve ndihmëse të OST-së, përfshirë pagesat e bëra OST-ve fqinje për të siguruar energji elektrike emergjente dhe rezerva të çastit dhe pagesat (nëse ka) për frekuencën dhe rregullimin e tensionit.

c) Kostot e kompensimit të energjisë reaktive, që mund të alokohen në një pagesë për energjinë reaktive

d) Kosto të tjera operimi që i përkasin operimit të tregut deri në ndarjen ligjore të OT-së nga OST-ja e më pas, pagesat mujore përkatëse.

5. Tarifa e transmetimit nuk duhet përdorur për të shlyer koston e importeve të energjisë elektrike ose pagesat e kapacitetit që shoqërohen me energjinë e importuar ose çdo kosto tjetër të furnizuesit dhe përdoruesit sipas marrëveshjeve dypalëshe. Tarifa e transmetimit do të mbulojë kostot e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike në sistemin e transmetimit, si dhe sigurimin e shërbimeve ndihmëse e të balancimit të prokuruar në treg.

6. Rregullimi i *price cap* aplikohet për të ardhurat mesatare të lejuara të shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike. Rregullatori aprovon tarifën mesatare të transmetimit. Nëse tarifa mesatare tavan e transmetimit, e përcaktuar në bazë të të dhënave historike për një nga vitet në ciklin e vlerësimit të tarifave e tejkalon tavanin e tarifës mesatare të lejuar të transmetimit të vendosur nga ERE, OST-ja duhet të ulë tarifën mesatare të transmetimit në vitin vijues, në mënyrë që klientët dhe përdoruesit e sistemit të transmetimit të marrin një rimbursim të shumës së të ardhurave të tepërta të mbledhura (shuma e mbishlyerjes).

7. Metoda “RPI - X” përdoret për t'i dhënë OST-së nxitje për reduktimin e kostove të veta gjatë ciklit të vlerësimit të tarifave. Kohëzgjatja e ciklit të shqyrtimit të tarifave të transmetimit është tre vjet. Nëse te tarifat mesatare tavan të



transmetimit për ciklin pasues të tarifës së shqyrtuar nuk janë aprovuar ende para përfundimit të periudhës trevjeçare, rregullatori mund të miratojë një vendim për zgjatjen e ciklit të shqyrtimit të tarifave deri në katër vjet.

8. Caktimi i tarifave përfshin dy aktivitete të ndërlidhura: vendosjen e tarifës mesatare tavan ekonomikisht të justifikuar për vitin bazë të ciklit të shqyrtimit të tarifave dhe vendosjen e tarifës mesatare tavan të transmetimit për vitin 2 dhe 3 të ciklit të shqyrtimit të tarifave.

9. Cikli i shqyrtimit të tarifës së shpërndarjes dhe cikli i shqyrtimit të tarifës së transmetimit duhet të fillojnë në të njëjtën ditë të vitit (për shembull, 1 janar ose 1 korrik).

10. Financimi afatgjatë i borxhit duhet përdorur për të financuar shpenzimet e reja kapitale për aq sa është e mundur, por nuk duhet përdorur për të mbuluar kostot e operimit.

11. Aplikimi, krahas informacionit dhe dokumentacionit argumentues të nevojshëm për llogaritjen e tarifës mesatare tavan të shërbimeve të rregulluara të transmetimit duhet të përmbajë dhe një informacion të plotë mbi treguesit teknikë, ekonomikë dhe financiarë, si dhe llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve për të gjithë shoqërinë.

12. Kompania e rregulluar do të raportojë qartë dhe pa dyshime kostot e çdo shërbimi të rregulluar, përfshirë vetëm asetet dhe aktivitetet që lidhen me shërbimet e rregulluara. Metoda e shpërndarjes (alokimit) së kostove do të jetë e qartë dhe e kuptueshme.

13. Tarifa duhet të reflektojë kostot aktuale të shërbimit për çdo përdorues të sistemit të transmetimit dhe duhet të japë sinjale për përdorimin eficient të rrjetit të transmetimit.

14. Kostot e përfshira në tarifë duhet të jenë transparente për palët e interesuara.

15. Tarifa duhet t'i lejojë OST-së mundësinë e një kthimi të arsyeshëm mbi bazën e rregulluar të aseteve.

16. Tarifat duhet të jenë relativisht të qëndrueshme në kohë.

17. Tarifat do t'u korrespondojnë kostove që do të krijohen nga një kompani transmetimi e mirëmenaxhuar që mundohet të bëjë investime të kujdesshme, të minimizojë humbjet në rrjet dhe të shmangë shpenzimet e kota. Kur vendoset tarifa bazë, rregullatori ka të drejtë të hetojë nivelet e kostos, të raportuara nga OST-ja dhe të krahasojë

kostot e saj për njësi me të OST-ve të tjera.

18. Në përgatitjen e aplikimit për tarifa OST-ja do të përpiqet të paraqesë gjithë kostot me saktësi deri në 100,000 lekë. Rregullatori nuk duhet t'i diskutojë shifrat me të vogla se 100,000 lekë përveç kur ka një mosmarrëveshje mbi kompensimin ose pagesën për persona të veçantë fizike.

19. Mospërputhja me secilën pjesë të kësaj metodologjie mund të çojë në refuzim nga ana e ERE-s të aplikimit për tarifë të kompanisë së transmetimit.

20. Periudha e parë rregulatore sipas kësaj metodologjie fillon në janar 2018.

21. ERE do të miratojë formatet e tabelave për aplikimet për tarifa. OST-ja do të përdorë formatet e tabelave të miratuara nga ERE kur përgatit aplikimin për çmim për një periudhë rregullimi. Formatit i tabelave mund të modifikohet për sa kohë që informacioni është organizuar në mënyrë të ngjashme dhe detajimi i informacionit nuk është më i vogël se ai i tabelave standarde të miratuara. Tabelat do të tregojnë rezultatet e vitit të testimit, rregullimet e bëra për vitin e testimit dhe për vitin bazë, duke përfshirë, por jo vetëm, shpenzimet e kompanisë, shpenzimet kapitale dhe bazën e aseteve të rregulluara për shërbimin e rregulluar.

#### Neni 6

### **Energjia elektrike dhe bilancet e energjisë elektrike**

1. Bilanci i energjisë elektrike të OST-së për vitin bazë do të përgatitet nëpërmjet përlllogaritjes së shumës totale të energjisë në GWh të marrë nga rrjeti i transmetimit gjatë vitit bazë. Ky total është i barabartë me energjinë e marrë nga centralet gjeneruese shqiptare që livrojnë energji në rrjetin e transmetimit plus energjinë neto të marrë nga rrjetet e transmetimit të vendeve fqinje. Energjia totale e marrë duhet të ndahet në:

a) energji elektrike e livruar në rrjetet shqiptare të shpërndarjes;

b) energji elektrike e livruar te përdoruesit e lidhur me sistemin e transmetimit;

c) humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit;

d) konsumi i energjisë elektrike nga OST-ja për qëllime teknologjike;

e) energji neto e dhënë në rrjetet e transmetimit të vendeve fqinje.



2. Bilanci koinçidues i pikut të fluksit të ngarkesës së OST-së do të përgatitet duke përlogaritur energjinë elektrike totale në mw të marrë nga rrjeti i transmetimit në orën e pikut. Ky total është i barabartë me energjinë elektrike të marrë nga centralët shqiptarë të gjenerimit që livrojnë energji në rrjetin e transmetimit plus energjinë neto elektrike të marrë nga rrjetet e transmetimit të vendeve fqinje. Energjia totale e marrë duhet ndarë në:

- a) energjia elektrike e livruar në rrjetet shqiptare të shpërndarjes;
- b) energji elektrike e livruar te përdoruesit e lidhur me sistemin e transmetimit;
- c) humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit;
- d) konsumi i energjisë elektrike nga OST-ja për qëllime teknologjike;
- e) energji neto e dhënë në rrjetet e transmetimit të vendeve fqinje.

3. Për secilin nga dhjetë vitet e fundit, humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit duhen treguar si një përqindje e energjisë së marrë nga rrjeti i transmetimit.

4. Energjia elektrike e konsumuar nga facilitetet e OST-së me tension të ulët ose mesatar dhe të livruar nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes duhet përfshirë në shumën totale të energjisë së livruar në rrjetin e shpërndarjes.

#### Neni 7

#### Kërkesa për të ardhura për vitin bazë

1. Shpenzimet e vitit të testimit për përcaktimin e kostove për vitin bazë do të bazohet në informacionin kontabël në përputhje me sistemin uniform të llogarive të aprovuara nga ERE ose Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit. Viti i testimit do të jetë një periudhë historike 12-mujore përfaqësuese e kostove operative të shoqërisë. ERE, gjatë shqyrtimit të aplikimit për tarifë, ka të drejtë të kryejë ose të kontraktojë për të kryer, një auditim rregullator të informacionit kontabël të vitit testues të OST-së.

2. OST-ja mund të propozojë ndryshime të rezultateve të shpenzimeve të vitit të testimit për përcaktimin e tarifave për vitin bazë të periudhës së ardhshme rregulatore. Çdo ndryshim i tillë duhet të jetë i njohur (një artikull i veçantë) dhe i matshëm nga ana sasiore. Fondet e planifikuara për mbulimin e kostove të ngjarjeve të pasigurta apo të

pa parashikuara, nuk do të miratohen nga ERE.

ERE do të marrë në konsideratë rregullime në vitin e testimit, të tilla si:

1. ndryshimi i kërkesës;
2. inflacioni;
3. ndryshime në çmimin e kontraktuar;
4. ndryshime në taksa dhe sigurime;
5. rritje e nivelit të aseteve bazë të rregulluara;
6. kosto e kapitalit;
7. niveli i shpenzimit të amortizimit; dhe
8. faktori i eficiencës;
9. të ardhura të tjera.

3. OST-ja duhet të paraqesë justifikime për çdo rregullim/korrigjim të parashikuar të rezultateve të vitit të testimit. Rregullimet duhet të specifikohen në tabelat e paraqitura nga OST-ja në aplikimin për tarifë, si dhe dëshmi me shkrim duke dhënë prova për arsyet dhe nivelin e çdo korrigjimi/rregullimi.

4. Kërkesat për të ardhura për vitin bazë do të llogariten si vijon:

$$C = C \text{ kapital} + C \text{ operuese}$$

4.1 TVSH-ja nuk është përfshirë në formulën e treguar me lart sepse është llogaritur nga OST-ja për çdo faturë mujore të klientit të sistemit të transmetimit për shërbimin e transmetimit dhe është treguar si një zë i veçantë në faturën mujore.

4.2 Kostoja kapitale është e barabartë me kthimin e kapitalit, plus amortizimin.

$$C \text{ kapital} = R + D$$

C kapital - komponenti i lidhur me kapitalin e të ardhurave të synuara për vitin bazë

R - kthimi mbi bazën e rregulluar të aseteve

D - amortizimi i aseteve fikse dhe amortizimi i aseteve të tjera

4.2.1 Kthimi mbi bazën e rregulluar të aseteve llogaritet me formulën:

$$R = B * WACC$$

B - aset bazë i rregulluar në fillim të vitit bazë të ciklit të vlerësimit të tarifave

WACC - norma e lejueshme e kthimit të asetit bazë të rregulluar

4.2.2 Vlera e asetit bazë të rregulluar duhet të jetë e barabartë me koston historike të aseteve fikse të përdorura për të siguruar shërbim transmetimi, minus amortizimin, minus një rregullim për vjetërimin ekonomik.

4.2.3 Trualli dhe e drejta e kalimit të përdorura nga OST-ja vlerësohet me koston fillestare të blerjes.



4.2.4 Amortizimi i kategorive të ndryshme të aseteve do të bazohet mbi jetën operuese të pritshme të këtyre aseteve. Nëse të dhënat financiare janë shtrembëruar nga përdorimi i shifrave shumë të larta për jetëgjatësinë e amortizimit, atëherë OST-ja paraqet një studim për amortizimin e aseteve i cili duhet të tregojë jetën e aseteve për çdo kategori.

4.2.5 Asnjë nga asetet e OST-së nuk duhet konsideruar si aset “stranded” (me vlerë të regjistruar më të lartë se vlera e tregut).

4.2.6 Vetëm investime në nivele të kujdesshme të aprovuara nga ERE mund të përfshihen në bazën e rregulluar të aseteve. OST-ja duhet të paraqesë në ERE me shkrim programin e ndarjes së investimeve të propozuara për periudhën rregullatore në përputhje me rregulloren e procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve.

4.2.7 ERE do të rishikojë investimet e realizuara kundrejt atyre të planifikuara/miratuara çdo fundviti dhe të korrigojë tarifën në rast se OST -ja dështon në zbatimin e planit të investimeve.

4.3 Norma e lejuar e kthimit në asetin bazë të rregulluar llogaritet nga një normë e lejueshme kthimi e kapitalit në vitin bazë, një normë mesatare e përllogaritur e interesit mbi borxhin afatgjatë gjatë vitit bazë dhe një raport borxh/kapital i vet. Të trija këto vlera duhen dhënë në vendimin për tarifën të miratuar nga rregullatori në mënyrë që supozimet e përdorura për të llogaritur normën e lejueshme të kthimit të paraqiten qartë. Norma e lejuar e kthimit mbi asetin bazë të rregulluar është mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit para taksave, e llogaritur si vijon:

$$WACC = [ES * ARoE / (1-T)] + (DS * CoD)$$

$$ES + DS = 1,$$

ku:

ES - objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB

T - norma e taksës së korporatës

ARoE - norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas taksë

DS - objektivi për raportin e borxhit në RAB

CoD - kostoja e borxhit

4.4 Norma e lejueshme e kthimit mbi kapitalin duhet të vendoset nga rregullatori mbi bazën e nevojës së OST-së për të marrë fluksin e parave për shpenzime kapitale dhe shërbimin e borxhit afatgjatë, duke gjykuar nga pasqyra e burimeve dhe

përdorimit të fondeve në vitin bazë. Gjithë fitimet duhen përdorur për të mbështetur programin e shpenzimeve kapitale të OST-së dhe për të rritur vlerën e kontabilizuar të pjesës së kapitalit.

4.5 Nëse OST-ja mund të demonstrojë se ka një nevojë urgjente për shpenzime kapitale specifike dhe se financimi i borxhit afatgjatë për këto asete apo fluksi i parave nuk është i mjaftueshëm për t'u shërbyer borxheve të arsyeshme/të justifikuara, ERE-ja mund të vendosë të caktojë një normë të lartë të lejueshme të kthimit të kapitalit dhe ta mundësojë në këtë mënyrë OST-në që të gjenerojë fluksin shtesë të parave që nevojiten.

4.6 Norma mesatare e ponderuar e interesit mbi borxhin afatgjatë duhet përcaktuar, si: a) shumën e pagesave të interesit të borxhit afatgjatë gjatë vitit bazë, pjesëtuar me principalin total të borxhit afatgjatë (shuma totale e marrë borxh) në fillim të vitit bazë; ose b) shumën e pagesave të interesit të borxhit afatgjatë gjatë ciklit 3-vjeçar të shqyrtimit të tarifave pjesëtuar me shumën e sasisë së marrë borxh në fillim të vitit bazë, shumën e marrë borxh në fillim të vitit 2 dhe shumën e marrë borxh në fillim të vitit 3. OST-ja duhet të tregojë që normat e interesit për borxhin janë në përputhje me normat tregtare të interesit për borxhin të pranuar nga kompanitë e tjera me risk të ngjashëm krediti. Çdo borxh i përfshirë në llogaritjen e normës mesatare të interesit të borxhit, që ka një normë interesi më të lartë se niveli aktual i tregut, do të rregullohet në zbritje deri në nivelin e tregut.

4.7 Gjithë përbërësit kryesorë të sistemit të transmetimit duhet të jenë pronësi e OST-së dhe jo të merren me qira. Pagesat që shoqërohen për qira (për shembull, marrja me qira e mjeteve të motorizuara) do të përfshihen në shpenzimet operuese.

5. Kostot operuese të OST-së përfshijnë:

C operuese = C matjes + C mirëmbajtje + C paga + C humbjet + C shërb. ndihmëse + C shërb. të trete + C takse

C matjes - kostoja e matjes së energjisë elektrike dhe energjisë së livruar te klientët e sistemit të transmetimit dhe kosto e faturimit dhe e likuidimeve të llogarive me përdoruesit e sistemit të transmetimit. Kjo kategori mat kostot që lidhen me klientët dhe nuk përfshin koston e matjes së humbjeve të energjisë elektrike, konsumin e energjisë elektrike për qëllime teknologjike dhe eksportin, importin dhe fluksin e transitit. Qëllimi i





matjes së C matëse është llogaritja e pagesës mujore fikse për çdo klient të sistemit të transmetimit të bazuar në numrin e pikave ku klienti është i lidhur me sistemin e transmetimit.

C mirëmbajtje - pjesë zëvendësimi, furnizime, mjete, lëndë djegëse dhe kosto të tjera mirëmbajtje;

C paga - pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe kostot (të ndryshme nga taksat) të lidhura me programet në përfitim të të punësuarve;

C humbjet - kostot për mbulimin dhe prokurimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit

Në llogaritjen e tarifës së transmetimit, kostoja për humbjet do të llogaritet bazuar në çmimet e tregut:

$$C \text{ humbje} = E \text{ humbje} * P \text{ h}$$

E humbje - humbjet e energjisë në rrjetin e transmetimit gjatë vitit bazë

Ph - çmimi mesatar i energjisë elektrike që do të blihet në treg për mbulimin e humbjeve gjatë vitit bazë

C shërb. ndihmëse - një pagesë për blerjen e shërbimeve ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sistemit

OST-ja duhet të paraqesë një vlerësim në lidhje me shpenzimet për shërbimet ndihmëse gjatë vitit bazë. Ky vlerësim duhet të përmbajë argumente në lidhje me parashikimin e nevojave për shërbime ndihmëse dhe çmimet përkatëse (në zbatim të nenit 62, të ligjit 43/2015).

C takse – Komponenti që mundëson që rregullatori të tregojë qartë pjesën e tarifës që u atribuohet taksave dhe prandaj është përtej kontrollit të rregullatorit. Komponenti taksë i të ardhurave të synuara të OST-së për vitin bazë, nuk përfshin TVSH-në dhe tatimin mbi fitimin

Neni 8

### **Ndarja e kostove për kapacitet, energji dhe pagesa fikse mujore**

1. Çdo klient i sistemit të transmetimit duhet të paguajë një pagesë kapaciteti në lekë/kw/muaj, të bazuar në ngarkesën pik të klientit gjatë periudhës 12-mujore që mbaron në muajin e faturimit. Nëse klienti ka nënshkruar një marrëveshje me OST-në ku klienti duhet të paguajë për një shumë specifike të kapacitetit të garantuar nga marrëveshja, atëherë aplikohet pagesa e kapacitetit për atë që është më e lartë – kapaciteti kontraktual i garantuar ose

ngarkesa pik e klientit gjatë periudhës 12-mujore që mbaron me muajin e faturimit.

2. Çdo klient i sistemit të transmetimit duhet të paguajë një pagesë për energjinë në lekë/kwh, bazuar në sasinë e kwh të livruar nga sistemi i transmetimit të klientit i sistemit të transmetimit gjatë atij muaji.

3. Çdo klient i sistemit të transmetimit duhet të paguajë një pagesë mujore fikse që synon të mbulojë matjen, faturimin dhe kostot e likuidimit të OST-së për të siguruar shërbim për atë klient gjatë vitit bazë.

4. Në aplikimin për tarifa OST-ja duhet të sigurojë një parashikim, të:

a) kapacitetit total në kw që do të tregohet në faturën e klientit të sistemit të transmetimit në çdo muaj të vitit bazë dhe shumën e këtyre totaleve mujore

b) energjinë totale në kwh që do të tregohet në faturat e klientit të sistemit të transmetimit në çdo muaj të vitit bazë dhe shumën e këtyre totaleve mujore

c) numrin e pikave të livrimit të klientët e sistemit të transmetimit në fillim të vitit bazë dhe numrin e pikave të livrimit në fund të vitit bazë dhe mesataren e këtyre dy shifrave

5. Të ardhurat totale të mbledhura nëpërmjet pagesave të kapacitetit në vitin bazë janë të barabarta me:

$$C \text{ kapacitet} = C \text{ kapital}$$

6. Pagesa e kapacitetit në lekë për kwh në muaj është e barabartë me:

$$P \text{ kapacitet} = C \text{ kapacitet} / L$$

L - shuma e kapacitetit total mujor e treguar në faturat e klientit të sistemit të transmetimit, gjatë 12 muajve të vitit bazë

7. Të ardhurat totale të mbledhura nëpërmjet pagesave të energjisë në vitin bazë janë të barabarta me:

$$C \text{ energji} = C \text{ operuese} - C \text{ matjes}$$

8. Pagesa e energjisë në lekë për kwh është e barabarte me:

$$P \text{ energji} = C \text{ energji} / E$$

E - energjia totale në kwh që do të tregohet në faturat e klientit të sistemit të transmetimit gjatë vitit bazë

9. Të ardhurat totale që do të mbliidhen nëpërmjet pagesave fikse mujore në vitin bazë janë të barabarta me C matjes.



Pagesa mujore fikse në lekë për pikë livrimi është e barabartë me:

$$P \text{ mujore} = C \text{ matjes} / N$$

N - mesatarja e numrit të pikave të livrimit të klientët e sistemit të transmetimit në fillim të vitit bazë dhe të pikave të livrimit në fund të vitit bazë

Neni 9

### Llogaritja e tarifës mesatare të transmetimit

1. Në çdo vit të ciklit të shqyrtimit të tarifës, tarifa mesatare e transmetimit është e barabartë me:

$$P \text{ mesatare} = (C \text{ kapacitetit} + C \text{ operuese}) / E$$

P mesatare - tarifa mesatare e transmetimit

2. Tarifa mesatare e transmetimit reflekton koston e pronësisë, ndërtimit, operimit dhe të mirëmbajtjes së linjave, kabllave, nënstacioneve të transformatorëve, qendrave dispeçer dhe ndërtesave që lidhen me to dhe facilitetet e komunikimit. Kjo tarifë nuk do të reflektojë koston e aktiviteteve të renditura në germën “c” dhe “d” në pikën 4, të nenit 5, si dhe çdo kosto tjetër që nuk lidhet me aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike, sepse ato kosto duhen shlyer nga OST-ja nëpërmjet pagesave shtesë. Për shembull, koston që lidhen me pagesat e energjisë elektrike reaktive përjashtohen nga tarifa mesatare e transmetimit.

3. Tarifa mesatare e transmetimit mund të llogaritet për një periudhë 12-mujore. Të dhënat mujore mund të jenë parashikim apo historik ose kombinim i të dhënave të parashikuara për muajt e ardhshëm dhe të dhëna të vlerësuara për muajt e fundit.

Neni 10

### Komponenti i transmetimit të tarifave të klientëve fundorë

1. Në aplikimin e tarifave OST-ja duhet të paraqesë për çdo furnizues të kompanisë së shpërndarjes, një përlllogaritje të të ardhurave totale të OST-së që duhen mbledhur nga ai furnizues gjatë vitit bazë nëpërmjet pagesave të kapacitetit, pagesave të energjisë dhe pagesave të matjes.

2. Është përgjegjësi e DSO-së e cila kryen shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike për FSHU-në dhe çdo furnizuesi tjetër të licencuar apo klient tjetër që të përgatisë një aplikim tarife në të cilën të ardhurat totale të OST-së për atë kompani shpërndarjeje të mbledhen nga klientët fundorë në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese. Grupet e krahasueshme të klientëve fundorë, të lidhura me

sistemin e shpërndarjes duhet të paguajnë, direkt ose indirekt, të njëjtat pagesa transmetimi.

3. Në metodologjinë e tarifave të klientëve fundorë dhe në metodologjinë e tarifave të përdorimit të rrjetit të sistemit shpërndarës, pagesat e kapacitetit për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes që OSSH-ja i paguan OST-së duhen ndarë mes grupeve të klientëve të lidhur me sistemin e shpërndarjes, sipas kontributit të çdo grupi në ngarkesën koinçiduese pik të kompanisë shpërndarëse. Kjo llogaritje duhet të marrë në konsideratë humbjet teknike në nivele të ndryshme tensioni, si dhe faktorin e ngarkesës vjetore dhe ngarkesën vjetore pik në kw të çdo grupi klientësh.

4. Nëse aplikohet pagesa e energjisë së OST-së për konsumin e energjisë elektrike në kwh të treguar në faturat e klientëve me tension të mesëm dhe të ulët, të ardhurat totale do të jenë më pak se shumica e pagesave të energjisë elektrike të paguara nga kompania e shpërndarjes OST, që përfshin pagesat e energjisë të shoqëruara me humbjet në rrjetin e shpërndarjes. Nëse pagesa e kapacitetit të OST-së aplikohet për ngarkesën pik në kw të treguar në faturat e klientëve ose të vlerësuara për grupet e klientëve, të ardhurat totale ka të ngjarë të jenë më të mëdha se sa shumica e pagesave të kapacitetit të paguara nga kompania e shpërndarjes OST, sepse do të ketë një farë diversiteti mes ngarkesave pik. Prandaj, mund të përfshihet pagesa e energjisë së OST-së dhe pagesa e kapacitetit të OST-së në tarifën e klientëve fundorë dhe të arkëtohet shumica “korrekte” e të ardhurave. Kjo është një mënyrë shumë e thjeshtë për të vendosur komponentin e transmetimit të tarifave të klientëve fundorë, dhe do të ishte e pranueshme për ERE-n me kusht që kompania e shpërndarjes të shlyejë, as më shumë dhe as më pak se koston e vet totale të shërbimit të transmetimit, nëpërmjet këtyre komponentëve të energjisë dhe kapacitetit të tarifës së saj.

5. OST-ja duhet të shqyrtojë aplikimet për tarifa të paraqitura nga furnizuesit e kompanisë së shpërndarjes, për të siguruar se të ardhurat totale të OST-së për atë kompani shpërndarjeje janë arkëtuara nga klientët e kompanisë së shpërndarjes në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese. OST-ja duhet të informojë ERE-n, nëse koston e sistemit të transmetimit u janë ngarkuar klientëve fundorë në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese. Opinioni i OST-së do të merret në konsideratë nga



ERE në shqyrtimin e tarifave të propozuara për klientët tariforë.

Neni 11

### Vendosja e tarifave mesatare tavan të transmetimit

1. Për vitin bazë, tarifa mesatare e transmetimit është e barabartë me tarifën mesatare të transmetimit të llogaritur sipas kostos në vitin bazë.

2. Për vitin e dytë të ciklit të vlerësimit të tarifave (viti 2), tarifa mesatare e transmetimit për vitin bazë shumëzohet me faktorin vjetor të rregullimit:

$$A = (1 + RPI - X)$$

A - faktori i axhustimit vjetor

RPI - norma e inflacionit për çmimet e konsumit e parashikuar për vitin e 2-të nga Banka e Shqipërisë ose INSTAT

X - faktori i përmirësimit të eficiencës

3. Vlera e X-it duhet përcaktuar në bazë të studimit të standardeve të operatorëve të sistemit të transmetimit, në përputhje me “Rregullat e cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit”. Në mungesë të këtyre rregullave, faktori X do të konsiderohet zero.

4. Nëse aktiviteti aktual financiar i OST-së në çdo vit të ciklit të vlerësimit të tarifave është më i mirë nga sa tregojnë parashikimet financiare të aplikimit të tarifave ose më mirë nga miratimi i ERE-s, mund të jepen bonuse për shoqërinë pa ngritur tarifën mesatare të transmetimit mbi tarifën mesatare tavan të transmetimit.

5. Për vitin e tretë të ciklit të shqyrtimit të tarifave (viti 3), tarifa mesatare e transmetimit për vitin e dytë shumëzohet me faktorin vjetor të axhustimit duke përdorur vlerën RPI që i korrespondon vitit 3.

6. Për vitin e katërt të ciklit të shqyrtimit të tarifave (viti 4), e ardhura e transmetimit për vitin e tretë shumëzohet me faktorin vjetor të axhustimit, duke përdorur një vlerë RPI që i korrespondon vitit 4. Nëse tarifat e transmetimit për ciklin tjetër të

korrigjimit të tarifave janë miratuar para mbarimit të periudhës trevjeçare atëherë nuk do të jetë nevoja të llogaritet e ardhura mesatare e transmetimit për vitin 4.

7. Sipas kësaj metodologjie kryhet axhustim/korrigjim në tarifën mesatare tavan në vitin e ardhshëm, pavarësisht se axhustimet bëhen në periudhën rregullatore pasardhëse.

8. OST-ja nuk duhet “ndëshkuar” kurrë për mbikthimin e të ardhurave, nëpërmjet rregullimit të normës se lejueshme të kthimit të kapitalit ose nëpërmjet rregullimit të çmimit Ph që është caktuar për humbjet në rrjet dhe për konsumin e energjisë elektrike për qëllime teknologjike. Mbikthimi i të ardhurave mund të rezultojë nga gabime në parashikim dhe nga ngjarje dhe prirje të papritura në sektorin e energjisë elektrike.

9. Mbikthimi i të ardhurave gjatë vitit të fundit të ciklit të shqyrtimit të tarifave u duhet rimbursuar klientëve të sistemit të transmetimit nëpërmjet axhustimit në nivelin e pagesës së energjisë në vitin bazë të ciklit pasues të axhustimit të tarifave.

10. Në rast se një ngjarje e “forcës madhore” çrregullon sistemin e transmetimit, OST-ja mund t’i paraqesë në çdo kohë ERE-s një kërkesë për leje për të axhustuar pagesën e energjisë në tarifën e transmetimit në mënyrë që OST-ja të arkëtojë një shumë specifike shtesë të ardhurash. Megjithatë, rritja e tarifës së transmetimit nuk do të sigurojë të ardhura të rëndësishme për sektorin e energjisë elektrike nëse nuk rritet tarifa për klientët tariforë. OST-ja duhet të synojë të arrijë tarifa transmetimi të qëndrueshme dhe të parashikueshme.

Neni 12

### Dispozita të fundit

“Metodologjia e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike” u miratua nga bordi i ERE-s, me vendimin nr. 180, datë 8.11.2017. Metodologjia e miratuar me vendimin nr. 59, datë 29.12.2005, shfuqizohet.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa: Rr "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 504 lekë